REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 5699/5 Prot.

Tiranë, më 13.01.2026

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Plani i veprimit me rekomandimet.

INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

TIRANË

Mbështetur në Ligjin nr.114/15, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Proçedurave të Auditimit të Brendshëm" i ndryshuar, Programit të Angazhimit të Auditimit nr.5699/2, datë 15.09.2025, u krye auditim përputhshmërie pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë, për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 deri më 31.12.2024.

Për evidentimet dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së tyre, grupi i auditimit, në përfundim të procedurave, pas marrjes së Projekt Raportit, me observacione, përgatiti Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për të metat e konstatuara, në mbështetje të nenit 14, gërma "a", të Ligjit nr.114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar dhe pika 4.1.12 "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar" të Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, për përmirësimin e punës në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë, janë dhënë rekomandime, të cilat janë paraqitur dhe përfshirë në një Plan Veprimi të sugjeruar.

1. Në zbatim të nenit 12, germa "d" të ligjit nr.114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë, të marrë masa për hartimin, miratimin dhe ndjekjen e planit të veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga DAB në MIE.
2. Kryeinspektori, pas miratimit, një kopje e planit të veprimit të dërgohet zyrtarisht në DAB në MIE në zbatim të pikës 4.1.13.1 "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit", brenda 20 ditë pune nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar.

3. Kryeinspektori, në zbatim të pikës 4.1.13.3 "Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB", të informojë në mënyrë periodike për progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.
4. Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar dhe të pikës 4.1.13.1 "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit", të Manualit të Auditimit të Brendshëm, dërgohet bashkëlidhur Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Plani i Veprimit të rekomandimeve mbi auditimin e kryer në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

DREJTORI

Lirim SULAJ

INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL
Nr. 531 Prot.
Datë 15.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 5699/1 Prot.

Tiranë, më 13.01.2026

Lënda: Reagim mbi misionin e auditimit të brendshëm.

INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

TIRANË

Mbështetur në Ligjin nr.114/15 datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Procedurave të Auditimit të Brendshëm", i ndryshuar, Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm të vitit 2025, miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhërin Nr. 220, datë 18.10.2024 dhe Programit të Auditimit të miratuar me nr.5699/2, datë 15.09.2025, u krye auditim përputhshmërie në ISHTI.

Pas përfundimit të rishikimit të auditimit në subjektin tuaj, në respektim të pikës 7.1 *"Programi i sigurimit të cilësisë"*, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, date 25.10.2016 "Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, për të na ndihmuar të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do të ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë, do t'ju isha mirënjohës nëse plotësoni formularin bashkëlidhur për reagimet për auditimin.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR

Lirim SYLAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË · TIRANË

PYETËSOR PËR REAGIMIN NDAJ MISIONIT TË AUDITIMIT

SUBJEKTI I AUDITUAR: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Tiranë.
ANGAZHIMI I AUDITIMIT: Programit të Auditimit nr.5699/2, datë 15.09.2025.
DATA E RAPORTIMIT: 25.11.2025.

Njësia e auditimit të brendshëm është përgjegjëse për t'i dhënë siguri të arsyeshme subjektit të audituar dhe opinion në lidhje me menaxhimin e riskut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes përmes matjes dhe vlerësimit të efektivitetit të tyre, për të ndihmuar në arritjen e objektivave të njësisë publike. Pas përfundimit të rishikimit të auditimit në subjektin tuaj, mirëpresim rekomandimet tuaja, për të na ndihmuar të vlerësojmë performancën tonë personale dhe për të identifikuar fushat ku përmirësimi në qasjen tonë do të ishte i dobishëm për ju dhe të tjerë. Duke përdorur shkallën e vlerësimit si më poshtë, ju lutem rrethoni numrin në kolonën e djathtë që reflekton pikëpamjet tuaja në punën tonë në secilën nga fushat e përmendura. Në qoftë se jepet një vlerësim 3 ose 4, ju lutem jepni më shumë hollësi në seksionin "Komente" në mënyrë që ne të mund të marrim parasysh si mund të përmirësohemi.

Shkalla e vlerësimit **1 -Shumë të kënaqur 2 – Të kënaqur 3 – Të pakënaqur 4 – Shumë të pakënaqur**					
KOMPONENTËT E PERFORMANCËS	*1*	*2*	*3*	*4*	***Komente***
PLANIFIKIMI I AUDITIMIT					
Sa të kënaqur jeni që:					
1. Ju janë dhënë mundësi të përshtatshme për të rënë dakord në fushë veprimin e auditimit para se të fillonte?					
2. Ju është dhënë njoftimi i duhur për kohën dhe kohëzgjatjen e auditimit?					
KRYERJA E AUDITIMIT					
Deri në çfarë mase jeni të kënaqur që:					
3. Audituesit e brendshëm kanë qenë profesionalë dhe të sjellshëm gjatë kryerjes të auditimit ?					
4. Audituesit e brendshëm kishin njohuri të mjaftueshme në fushën e veprimtarisë tuaj?					

5. A ju është komunikuar në mënyrën e duhur progresi i angazhim auditimit, duke përfshirë detajet e çështjeve kryesore që u shqyrtuan?						
RAPORTIMI I REZULTATEVE TË AUDITIMIT						
Sa të kënaqur jeni që:						
6. Projekt-raporti është marrë brenda një kohe të pranueshme të parashikuar ? *Data e përfundimit të punës në terren:* *10.10.2025.* *Data e lëshimit të projekt raportit:* *25.11.2025.*						
7. Projekt raporti është prezantuar në mënyrë të qartë në lidhje me formatin dhe qartësinë e gjuhës së përdorur?						
8. Pas përgjigjeve të menaxhimit për komentet, raporti përfundimtar është marrë?						
9. Rekomandimet ofruan zgjidhje praktike dhe konstruktive për çështjet e identifikuar?						
10. Argumentimi për gjetjet dhe përfundimet e auditimit a janë shpjeguar në mënyrë të kënaqshme, komentet/ pikëpamjet tuaja a janë marrë parasysh?						
CILËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM						
Sa të kënaqur jeni që:						
11. Zbatimi i rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të risqeve, të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes?						
12. Auditimi ju ofroi informacionin që do t'ju ndihmojë për të përmbushur përgjegjësitë e raportimit tuaj të sigurimit të cilësisë?						

13. Auditimi i brendshëm a kontribuon në përmirësimin organizativ për arritjen e objektivave strategjike në njësinë tuaj publike?						
SHËRBIME TË TJERA TË OFRUARA NGA AUDITIMI I BRENDSHËM						
14. A jeni të vetëdijshëm se njësia e auditimit të brendshëm ofron shërbime këshillimi?						
15. Nëse ju keni përdorur shërbimet e këshillimit të ofruara nga auditimi i brendshëm, a jeni të kënaqur me kontributin e dhënë?						

ANEKS I

PLAN VEPRIMI I SUGJERUAR MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

INSPEKTORIATI SHTETËROR TEKNIK INDUSTRIAL, TIRANË.

Nr. Rek.	Rekomandimet	Renditja sipas niveleve	Ref.në Rap.Përfundimtar	Reagimi i menaxh.	Afati	Personat pergjegjës
1	Të ndërmerren veprimet e nevojshme për rishikimin dhe harmonizimin e akteve nënligjore që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet e punës në ISHTI me dispozitat e Ligjit nr.99/2024, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", me qëllim sigurimin e përputhshmërisë ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në veprimtarinë e ISHTI,	I lartë	Fq.26-28	I pranuar nga subjekti	Menjeherë	
2	Në kuadër të miratimit të programit vjetor të inspektimeve të merren masa që të sigurohet dhe autorizimi apo miratimi përkatës në MIE për dërgimin me shërbim të punonësve për distanca mbi 100 km larg nga qendra e punës, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar.	I lartë.	Fq. 14-15	I observuar nga subjekti	Brenda muajit Janar 2026.	
3	Nga Kryeinspektori të ndërmarren masat e menjëhershme për ndërprerjen e procesit të rekrutimit pa procedurë. Të rivlerësohen të gjitha emërimet në përputhje me kriteret e miratuara të punësimit. për të siguruar kompletimin e strukturës me staf profesional dhe të kualifikuar.	I lartë	Fq.18-20	I observuar nga subjekti	Brenda muajit Mars 2026.	

4	Kryeinspektori të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin e punës për dokumentimin e veprimeve për menaxhimin e lëvizjeve të brendshme dhe largimeve nga puna, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të brendshëm, si dhe të forcojë kontrollin e brendshëm përmes ndjekjes së rregullt të praktikave të burimeve njerëzore, për të siguruar transparencë dhe shmangie të risqeve të niveli të lartë për ekspozimin e ISHTI ndaj proceseve gjyqësore, si dhe pasigurise se krijuar në përbushjen e objektivave, nga lëvizja e shpeshtë dhe e padokumentuar e personelit.	I lartë	Fq.20-25	I observuar nga subjekti	Brenda muajit Mars 2026.	
5	Të merren masa për përmirësimin e punës në drejtim të analizës së hollësishme të gjendjes së debitorëve të ndryshëm për gjoba dhe shërbime, analizë e cila të përqendrohet në klasifikimin e tyre sipas afatit të krijimit, ndjekjes në proces gjyqësor apo zyrë përmbarimi, si dhe vlerësimin e mundësive të arkëtimit të tyre, bazuar në kriteret përkatëse ligjore. Gjithashtu, të merren masa për vlerësimin e funksionimit të mekanizmave detyrues për arkëtimin, si të gjobave ashtu edhe të vlerave të shërbimeve, si dhe të hartohen propozime për përmirësimin dhe forcimin e funksionimit të këtyre mekanizmave.	I lartë	Fq.42-45	I observuar nga subjekti	Brenda muajit Mars 2026.	
6	Të ndërpritet dhënia e autorizime për inspektimeve të njëpasnjështe në të njëjtin subjekt ndërkohë kur nuk ka përfunduar afati i zbatimit të detyra të lëna, apo pa vlerësuar cështjet e patrajtuara nga inspektimi i mëparshëm.	I lartë	Fq.57-60	I pranuar nga subjekti	Menjëherë dhe në vijimësi	
7	Nga Kryeinspektori të merren masa për përmirësimin e punës në drejtim të forcimit të kontrollit të brendshëm në kryerjen e inspektimeve, vencanërisht në cilësinë e dokumentimit të ketij procesi, bazuar ne analizën e	I lartë	Fq.54-56	I pranuar nga subjekti	Brenda muajit Janar 2026.	

	faktorëve ndikues dhe riskut përkatës, me qëllim përmbushjen e objektivave në drejtim të rritjes së cilësisë së inspektimeve dhe eleminimin e te metave të veprimtarisë së trupave inspektuese të dokumentuara gjatë shqyrtimit të ankimimeve.					
8	Të merren masat e duhura për përmirësimin e punës nga Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve te Brendshme, në drejtim të dokumentimit të kontrollit të listëpagesave, në respektim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, Paragrafi III, pika 69.	I Mesëm	Fq.25-26	I pranuar nga subjekti	Menjëherë dhe në vijimësi	
9	Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa konkrete për vendosjen në funksion të programit financiar, i cili është blerë nga institucioni me fonde publike. Përdorimi i këtij programi të certifikuar duhet të shërbejë si bazë zyrtare për regjistrimet kontabël dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, ndërsa përdorimi i "Microsoft Excel" mund të vijojë si mjet ndihmës për analiza dhe përpunim të brendshëm të të dhënave. Po ashtu, kjo drejtori duhet të sigurojë që të gjithë ditarët dhe regjistrat kontabël të printohen, protokollohen dhe ruhen në përputhje me nenin 8 të Ligjit nr. 25/2018, për të garantuar gjurmueshmërinë, transparencën dhe integritetin e informacionit financiar.	I Mesëm	Fq.38-41	I observuar nga subjekti	Brenda muajit Mars 2026.	
10	Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të bëhet rishikimi dhe përditësimi i pasqyrave të flukseve monetare në përputhje me akt-rakordimet dhe regjistrat kontabël, si dhe të forcohen kontrollet e brendshme për garantimin e raportimit financiar të saktë dhe të plotë.	I Mesëm	Fq.41-42	I observuar nga subjekti	Brenda muajit Mars 2026.	
11	Aktivet e njësisë të cilat në fund të vitit 2023 dhe 2024 janë në ngarkim të personave të larguar nuk janë inventarizuar duke vepruar në kundërshtim me pikën 74	I Mesëm	Fq.45-46	I observuar nga subjekti	Brenda muajit Mars 2026.	

	të Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar. Ky veprim ndikon në krijimin e pasigurisë për ekzistencën fizike dhe gjendjen cilësore të disa aktiveve të njësisë.					
12	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) duhet të dërgojë programin e inspektimit për miratim pranë MIE në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 32, pika 4, për të siguruar vlefshmërinë ligjore të veprimtarisë inspektuese si dhe të ruajë dokumentacionin zyrtar të dërgimit dhe miratimit për efekt gjurmueshmërie dhe transparence në rast auditimi apo shqyrtimi institucional.	I Mesëm	Fq.53-54	I pranuar nga subjekti	Menjëherë dhe në vijimësi	
13	Të merren masa nga nëpunësi autorizues dhe struktura përgjegjëse për MFK-në për përgatitjen dhe dorëzimin brenda afateve ligjore të deklaratës së cilësisë dhe raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me nenin 18 të Ligjit nr. 10296/2010 dhe Manualin e MFK-së.	I Mesëm	Fq.62-63	I observuar nga subjekti	Brenda muajit Shkurt 2026.	

GRUPI I AUDITIMIT

Merita Gjoka

Ardiana Alimeri

Shkurte Halili

Kristina Deliu

Drejtori i DAB

Lirim Sulaj

Aneksi 2

OBSERVACIONET

Shqyrtimi dhe trajtimi i qëndrimeve të paraqitura nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial lidhur me gjetjet e parashtruara në projekt raportin e auditimit.

Lidhur me shkresën Tuaj nr.11796/1, datë 11.12.2024, protokolluar pranë MIE me nr.5699/4, datë 15.12.2024 me lëndë "Dërgohen Observacionet në lidhje me gjetjet e auditimit sipas Projektraportit të Auditimit nga Auditi i Brendshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë", po ju paraqesim qëndrimin përfundimtar të grupit të auditimit, lidhur me sqarimet e paraqitura, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, si më poshtë vijon:

Titulli i Gjetjes 1: *Parregullsi në pagesat e shpenzimeve për udhëtime – dieta brenda vendit.*

Observacioni i Gjetjes nr. 1	*Observacioni nga DBF-DÇJPP – ISHTI:* "Grupi i auditimit në rubrikën "Përmbledhje Ekzekutive" shprehet se ka konstatuar se, Nëpunësi Autorizues i ISHTI ka miratuar dhe likujduar shpenzime për udhëtime dhe dieta brenda vendit, për punonjësit që kanë kryer shërbime mbi 100 km larg nga qendra e punës pa pasur miratimin e Titullarit të Institucionit qendror apo të deleguarit të tij. Në lidhje me këtë gjetje sqarojmë se: 1. Lidhur me kompetencën për autorizimin e lëvizjeve me shërbim të punonjësve të ISHTI-t në largësi mbi 100 km nga qendra e punës, në VKM nr. 410, datë 13.05.2015 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", përcaktohet qartë se: ISHTI është institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë. Ministria mbështet funksionimin efektiv të ISHTI-së, por nuk ushtron drejtim operacional mbi veprimtarinë e inspektimit. Kjo dispozitë e aktit special përcakton se organizimi, drejtimi administrativ dhe operacional i ISHTI-t i takon Kryeinspektorit, si drejtues ekzekutiv i institucionit. 2. VKM Nr.997 datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar, parashikon se, shërbimet mbi 100 km miratohen nga "titullari i institucionit qendror", dhe në mënyrë të përgjithshme, për institucionet në varësi të ministrive, titullari mund të jetë ministri ose i deleguari i tij, por VKM nr. 410/2015 është akt më i ri (lex posterior) dhe akt special për ISHTI-n (lex specialis). Ky akt përcakton qartë se, ministria nuk ka drejtim operacional mbi ISHTI-n. Si rrjedhojë, ministri nuk mund të cilësohet "titullar operativ" për vendime administrative dhe operacionale që lidhen me inspektimin, përfshirë lëvizjet me shërbim. 3. Për efekt dhe në interpretim të VKM nr. 997/2010, në opinionin tonë dhe jo vetëm "titullari i institucionit qendror" për ISHTI-n është drejtuesi ekzekutiv i institucionit, pra: Kryeinspektori i ISHTI-t është titullari i institucionit qendror publik, në këtë kuptim

	ministria ushtron vetëm funksion mbështetës dhe politik, jo drejtim operacional. 4. Për forcimin e argumentimit të mësipërm, sqarojmë se: a. Që nga krijimi i ISHTI-t në vitin 2015, të gjitha autorizimet për shërbimet mbi 100 km janë miratuar nga Kryeinspektori. Kjo praktikë ka qenë e pandryshuar dhe e miratuar në mënyrë të vazhdueshme. Të gjitha auditimet e brendshme të kryera ndër vite nga grupet audituese të MIE, si dhe auditimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), nuk kanë ngritur asnjëherë pretendimin dhe konsideruar gjetje apo shkelje lidhur me interpretimin e titullarit të ISHTI-t apo miratimin e shërbimeve mbi 100 km në zbatimin e VKM nr. 997/2010 në këtë pikë. KLSH, si organi më i lartë i kontrollit financiar publik, ka kryer auditime të përsëritura në ISHTI dhe asnjëherë nuk e ka vlerësuar si të gabuar këtë praktikë. b. Nëse praktika do të ishte në kundërshtim me ligjin, ajo do të ishte evidentuar nga audituesit e brendshëm dhe audituesit e KLSH-së, të cilët i kontrollojnë me detaje procedurat e shpenzimeve, udhëtimeve dhe dietave. Prandaj ekziston një precedent administrativ i qëndrueshëm që konfirmon ligjshmërinë e praktikës së ISHTI-t për 10 vite rresht, precedent i cili nuk mund të injorohet në procesin e auditimit aktual. 5. Theksojmë se, i njëjti grup auditimi i brendshëm nga MIE, i cili ka audituar periudhën 2023 - 2024, ka qenë edhe më parë për auditim në ISHTI për periudhat 2019 – 2020 dhe 2021 – 2022, dhe në asnjë rast nuk ka konstatuar gjetjen e lartpërmendur. Sa më sipër bazuar në: VKM nr. 410/2015 (akt special dhe më i ri), VKM nr. 997/2010, Ligjin nr. 9000/2003, si dhe praktikën e qëndrueshme të miratuar nga auditimet e mëparshme, përfshirë KLSH, prapsojmë se: Kryeinspektori është titullari i ISHTI-t, i cili është organi kompetent për miratimin e shërbimeve mbi 100 km. Ministri nuk ushtron drejtim operacional dhe për rrjedhojë nuk është titullar për qëllimet e VKM nr. 997/2010. Praktika e ISHTI-t është ligjore, e qëndrueshme dhe e miratuar nga të gjitha auditimet e mëparshme. Në mbështetje të argumenteve të mësipërme, kërkojmë: reflektimin në raportin përfundimtar të kompetencës ligjore të Kryeinspektorit si titullar i ISHTI-t, heqjen e konstatimit që kërkon miratim të ministrit, pasi bie ndesh me VKM nr. 410/2015 dhe praktikën institucionale. Nëse, pavarësisht argumentimit tonë juridik dhe praktikës së konsoliduar, mendoni se duhet ndjekur një interpretim tjetër, ju lutemi të na orientoni qartë se si duhet të vijojmë për zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi."
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 1	Referuar observacionit të paraqitur, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Konstatimet e grupit të auditimit lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi, konkretisht me Kreun V, pika 2, shkronja "a", nënshkronja "i" të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i

	ndryshuar, dispozitë e cila është trajtuar në mënyrë të detajuar në projekt-raportin e auditimit. Në VKM nr. 997, datë 10.12.2010, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se, për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, titullari i institucionit qendror, në kuptim të këtij vendimi, është ministri përkatës ose i deleguari i tij, për ministrinë dhe çdo institucion në varësi të saj. Gjithashtu, në VKM nr. 410, datë 13.05.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", Kreu I, pika 1, përcaktohet se: "*Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (në vijim ISHTI) është institucioni qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë, me kompetenca inspektimi*". Kjo dispozitë specifikon qartë se ISHTI është institucion qendror në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë. Për sa më sipër, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin e paraqitur nga ISHTI. Gjetja mbetet në fuqi dhe do të pasqyrohet edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
Rishikimi i statusit të gjetjes.	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes 2: *Mosrespektimi i procedurave gjatë punësimit të punonjësve të rinj.*

Observacioni i Gjetjes nr. 2	Observacioni nga DBNJSHM – ISHTI. "Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial gjatë periudhës objekt auditimi (01.01.2023 - 31.12.2024), përsa i përket rekrutimeve dhe punësimeve ka respektuar përcaktimet ligjore të Kodit të Punës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi në fushën e punësimit. Deri më datë 24.11.2024, ISHTI ka zbatuar përcaktimet e Rregullores së Brendshme të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288, datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", ku në nenin 22 të saj përcaktohej se: "Rekrutimi i punonjësve të ISHTI-t bëhet bazuar në legjislacionin përkatës. Kriteret e rekrutimit për çdo vend pune bazohen në karakteristikat e vendit të punës. Vlerësimi i përmbushjes së kritereve dhe të aftësisë së punëmarrësit bëhet duke marrë në konsideratë legjislacionin mbi punësimin në Republikën e Shqipërisë.". Si pasojë e ristrukturimit të organikës së institucionit lindi nevoja për ndryshimin e Rregullores së Brendshme të ISHTI-t. Për këtë arsye është propozuar Rregullorja e re, e cila është miratuar më datë 25.11.2024, me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 297, datë 25.11.2024 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", urdhër i cili ka shfuqizuar Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288,

datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".

Në Rregulloren e re të ISHTI-t, Neni 20, pikat 1 - 4 përcaktojnë mënyrën e rekrutimit, punësimit të punonjësve në ISHTI:

1. Rekrutimi, punësimi dhe largimi nga detyra i punonjësve të ISHTI-t bëhet bazuar në përcaktimet e legjislacionit sektorial në fuqi, në fushën e rregullimit të marrëdhënieve të punës, sipas procedurës së miratuar nga Kryeinspektori me urdhër të brendshëm.
2. Kriteret e rekrutimit dhe punësimit për çdo vend pune bazohen në Përshkrimet e Punës dhe karakteristikat specifike për secilin pozicion vakant.
3. Vlerësimi i përmbushjes së kritereve dhe të aftësisë së punëmarrësit bëhet sipas procedurës së miratuar nga Kryeinspektori.
4. Lidhja e marrëdhënieve të punës realizohet në përputhje me kriteret e punësimit sipas procedurës së miratuar nga Kryeinspektori dhe përcaktimeve ligjore në fushën e rregullimit të marrëdhënieve të punës.

Për një proces sa më transparent, si dhe referuar rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit të brendshëm, (Raporti Përfundimtar Auditimit, dërguar pranë ISHTI-t më datë 03.03.2022, për periudhën e audituar 01.01.2019 – 31.12.2020), përkatësisht Rekomandimi Nr. 3: Nivel Risku: i mesëm:"Nga ISHTI të merren masa për hartimin dhe miratimin e procedurave të rekrutimit të punonjësve, për kompletimin e strukturës me staf sa më profesional.", nga titullari i institucionit është miratuar Urdhri Nr. 2, datë 23.02.2022 "Për miratimin e procedurës së rekrutimit, punësimit dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI".

Nga shqyrtimi i Gjetjes nr. 2, vlerësojmë se:

1. Rekrutimet në ISHTI nuk kanë kundërshti me referencat ligjore të cituara nga grupi i auditimit, përkatësisht, pika 9, neni 5, i Rregullores së Brendshme të ISHTI-t, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288, datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", dhe pika 1, neni 20, i Rregullores së Brendshme të ISHTI-t, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 297, datë 25.11.2024 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial".

Këtë vlerësim e mbështesim në faktin se:

a. ISHTI i rregullon marrëdhëniet e punës me punonjësit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohet se, Punëdhënësi punëson në mënyrë të drejtpërdrejtë punëmarrësin dhe se Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve.
b. Procedura e rekrutimit, punësimit dhe largimit nga detyra për punonjësit e ISHTI-t është një procedurë e hartuar mbështetur në

dispozitat e Kodit të Punës, si dhe në një gamë të gjerë përcaktimesh ligjore e nënligjore, dhe qëllimi i saj ka qenë transparenca, rritja e cilësisë së punës së ISHTI-t, rritja e nivelit profesional të stafit dhe mundësi të barabarta punësimi për të gjithë.

c. Pika 9, neni 5, i Rregullores së Brendshme të ISHTI-t, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288, datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", ku përcaktohet se: "Bashkëpunon për përgatitjen e strukturës e të organikës, si dhe për ndryshimet përkatëse të tyre, që i propozohet ministrit për tu miratuar nga Kryeministri. Emëron dhe shkarkon personelin në përputhje me ligjin e zbatuar për rekrutimin në ISHTI.", nuk përcakton në asnjë rast zbatimin e procedurave të brendshme të rekrutimit dhe punësimit.

2. Grupi i auditimit nuk ka pasqyruar qartë të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Këtë vlerësim e mbështesim në faktin se:

a. Sipas grupit të auditimit gjatë vitit 2023 janë realizuar 29 punësime të reja, ku 28 punësime janë kryer me procedurë rekrutimi dhe një punësim është kryer pa procedurë rekrutimi. Ndërsa për vitin 2024 janë realizuar 40 punësime të reja, ku 18 punësime janë kryer me procedurë rekrutimi dhe 22 punësime janë kryer pa procedurë rekrutimi.

b. Ndërkohë nga DBNJSHM, grupit të auditimit i është dhënë informacion zyrtar në hard copy se, gjatë vitit 2023 janë realizuar 29 punësime të reja, ku 28 punësime janë kryer me procedurë rekrutimi dhe një punësim është kryer me procedurë të thjeshtuar. Ndërsa për vitin 2024 janë realizuar 40 punësime të reja, ku 18 punësime janë kryer me procedurë rekrutimi dhe 22 punësime janë kryer me procedurë të thjeshtuar.

Informojmë grupin e auditimit se, të gjitha emërimet në detyrë janë kryer në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës dhe Procedurën e rekrutimit, punësimit të miratuar nga titullari i ISHTI-t. Procedura e përdorur kryesisht ka qenë Procedura e rekrutimit, punësimit e plotë dhe e thelluar dhe Procedura e Thjeshtuar për rastet e konsideruara si:

i. Emergjente;
ii. Me rëndësi delikate, referuar parimit të mirëbesimit në kushtet e marrëdhënies direkte punëdhënës – punëmarrës;
ii. Ristrukturimi i institucionit.

c. Sipas kërkesës së tyre verbale, grupit të auditimit i është komunikuar verbalisht se, për rastet e punësimit me procedurë të thjeshtuar, kryesisht janë punësimet e kryera gjatë periudhës së implementimit të strukturës së re të ISHTI-t, miratuar me anë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 62, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", për të cilat për efekt kohe janë marrë në konsideratë kërkesat për punësim të ardhura më parë, si dhe rikthimet në detyrë

	të punonjësve, që i'u ishte shkurtuar vendi i punës sipas strukturës së mëparshme. Më konkretisht, për vitin 2024 nga 22 punësime me procedurë të thjeshtuar: i. 8 punësime janë rikthime në punë të punonjësve të mëparshëm; ii. 14 punësime janë realizuar nga përzgjedhja e aplikimeve të mëparshme për punësim, të cilat administrohen vazhdimisht nga zyra e Burimeve Njerëzore dhe merren në konsideratë në çdo rast kur krijohen vende vakante. d. Rasti i vetëm i punësimit me procedurë të thjeshtuar për vitin 2023 ka qenë punësim me rëndësi delikate, në kushtet e marrëdhënies direkte punëdhënës – punëmarrës, pasi pozicioni i punës (Specialist Kodifikimi, në Laboratorin Qendror) kishte ndjeshmëri të lartë përsa i përket ruajtjes së konfidencialitetit dhe respektimit të parimit të mirëbesimit. e. Procedura e thjeshtuar konsiston në: i. Vlerësimin paraprak të kërkesave të mëparshme për punësim të administruara nga DBNJSHM; ii. Komunikimin telefonik në lidhje me disponueshmërinë e aplikantëve; iii. Plotësimin e formularit të vlerësimit për kandidatin/ kandidatët e mundshëm të cilët plotësojnë kriteret e nevojshme, (shkollim, nivel diplome, eksperiencë nga grupi i vlerësimit). iv. Propozimin e kandidatit potencial, titullarit të institucionit; v. Vlerësimin e kandidatit nga Titullari i institucionit; vi. Miratimi i Urdhrit të Emërimit në detyrë dhe nënshkrimin e Kontratës Individuale të Punës (3-mujore, periudhë prove) për kandidatin e përzgjedhur. Pra, krahasuar me Procedurën e plotë të rekrutimit dhe punësimit në ISHTI, për efekt kohe është reduktuar vetëm periudha e publikimit të vendit/ vendeve vakante në faqen zyrtare të ISHTI-t, si dhe intervistat me kandidatin/ kandidatët, pasi duke qenë aplikime të mëparshme apo rikthime në punë, intervistat ishin të ezaururara. Në këto kushte, grupi i auditimit 23 punësimet me procedurë të thjeshtuar, nuk mund t'i referojë si punësime pa procedurë, dhe nuk mund të mos marrë në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion të tyre. f. Grupi i auditimit citon ndër të tjera se: "Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument që të argumentojë arsyet përse në këto 23 raste nuk është zbatuar procedura e miratuar me Urdhër të Kryeinspektorit nr. 2, datë 23.02.2022, si dhe Rregullores së Brendshme të ISHTI të miratuar me Urdhër të Ministrit MIE-s nr. 288, datë 13.10.2020, neni 5 "Kryeinspektori", pika 9, ku citohet se: "Bashkëpunon për përgatitjen e strukturës e të organikës, si dhe për ndryshimet përkatëse të tyre, që i propozohet ministrit për tu miratuar nga Kryeministri. Emëron dhe shkarkon personelin nëpërputhje me ligjin e zbatuar për rekrutimin në ISHTI, të ndryshuar me Rregulloren e Brendshme të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s, nr. 297, datë 25.11.2024, neni 20, pika 1, ku

citohet: "Rekrutimi, punësimi dhe largimi nga detyra i punonjësve të ISHTI-t bëhet bazuar në përcaktimet e legjislacionit sektorial në fuqi, në fushën e rregullimit të marrëdhënieve të punës, sipas procedurës së miratuar nga Kryeinspektori me urdhër të brendshëm."".

Prapësojmë pretendimin e mësipërm të grupit të auditimit, pasi:

i. Nga DBNJSHM janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet që disponon dhe janë dhënë të gjitha shpjegimet e nevojshme në formën e kërkuar nga grupi auditimit (komunikim verbal dhe telefonik). Nuk mund të jetë përgjegjësi e DBNJSHM, nëse shpjegimet dhe argumentet janë kërkuar verbalisht nga grupi i auditimit dhe nuk janë marrë në konsideratë;

ii. Si pasojë e ristrukturimit të organikës së institucionit lindi nevoja për ndryshimin e Rregullores së Brendshme të ISHTI-t, për këtë arsye është propozuar Rregullorja e re, e cila është miratuar, më datë 25.11.2024 me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 297, datë 25.11.2024 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", urdhër i cili ka shfuqizuar Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288, datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial". Për këtë arsye përcaktimet e Rregullores së re gjejnë zbatim vetëm për një rast punësimi me procedurë rekrutimi të thjeshtuar në pozicionin Shofer;

iii. Mbi ç'bazë ligjore mbështetet konstatimi i grupit të auditimit se, nuk janë argumentuar arsyet se përse nuk është zbatuar procedura e rekrutimit në 23 raste, kur ndërkohë pjesë e dosjes së punësimit të çdo punonjësi është minimalisht kërkesa për punësim dhe formulari i vlerësimit;

iv. Vihet re se, grupi i auditimit nuk ka marrë në konsideratë dokumentacionin e vënë në dispozicion të tij në rastet e punësimeve me procedurë rekrutimi të thjeshtuar, apo rikthimet në punë, por i konsideron si punësime pa procedurë.

g. Gjithsesi sqarojmë edhe njëherë, ashtu sikurse i'u është shpjeguar edhe më parë verbalisht grupit të auditimit (në formën e kërkuar nga vetë ata) se: Nga 23 raste të konstatuara nga grupi i auditimit si punësime pa procedurë:

i. 15 janë punësime nga përzgjedhja e aplikimeve të mëparshme për punësim, pasi si pasojë e hyrjes në fuqi të strukturës së re të miratuar me anë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 62, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", lindi nevoja për implementimin e menjëhershëm të saj. Për këtë arsye u shkurtuan procedurat e rekrutimit, duke tejkaluar fazën e njoftimit dhe publikimit të vendeve vakante në faqen zyrtare të ISHTI-t, duke përdorur aplikimet e mëparshme për punësim, të administruara nga DBNJSHM, si dhe duke eleminuar njoftimet për intervistë, pasi ishin ezauruar më parë;

ii. 8 punësime janë rikthime në punë të punonjësve të mëparshëm, pas ristrukturimit. Këta punonjës janë liruar nga detyra si pasojë e shkurtimit të vendit të punës nga ristrukturimi, por në momentin e parë që është krijuar mundësia janë rikthyer menjëherë në punë, pa procedura rekrutimi, pasi nuk përbën sens dhe logjikë të vlerësosh dhe intervistosh punonjës të cilët kanë qenë pjesë e stafit dhe janë larguar vetëm për një periudhë të shkurtër kohe si pasojë e ristrukturimit.

3. Grupi i auditimit nuk është koherent në gjykimin dhe vlerësimin e nivelit të riskut, si dhe në rekomandimin e lënë.

a. Referuar rekomandimeve të lëna nga grupet e mëparshme të auditimit, përkatësisht në auditimin e periudhës 01.01.2019 – 31.12.2020, grupi i auditimit i përbërë nga Z. Josif Lubonja (përgjegjës grupi), Znj. Merita Gjoka dhe Znj. Ardiana Alimeri ka konstatuar se, në ISHTI nuk ka pasur procedura të përcaktuara dhe të miratuara për rekrutimin dhe punësimin e punonjësve. Punësimi është realizuar sipas urdhrit të titullarit dhe lidhjes së kontratës individuale të punës, duke e cilësuar si një proces jotransparent. Niveli i Riskut të kësaj gjetje është vlerësuar I mesëm dhe në vijim është lënë rekomandimi:"Nga ISHTI të merren masa për hartimin dhe miratimin e procedurave të rekrutimit të punonjësve, për kompletimin e strukturës me staf sa më profesional.", rekomandim i cili është pranuar dhe zbatuar nga ISHTI;

b.Nga pothuajse i njëjti grup auditimi, në projektraportin e dërguar për periudhën e auditimit 01.01.2023 – 31.12.2024 është konstatuar sipas tyre se, ISHTI ka miratuar dhe ka zbatuar një procedurë rekrutimi dhe punësimi, ku gjatë vitit 2023 janë realizuar 29 punësime të reja, nga të cilat 28 punësime janë kryer me procedurë rekrutimi dhe 1 punësim është kryer pa procedurë rekrutimi, ndërsa për vitin 2024 janë realizuar 40 punësime të reja, ku 18 punësime janë kryer me procedurë rekrutimi dhe 22 punësime janë kryer pa procedurë rekrutimi. Nivelin e riskut të kësaj gjetje grupi i auditimit e ka vlerësuar si Risk i Nivelit të Lartë, duke sjellë pasiguri dhe mungesë transparence në rekrutim;

c.E gjykojmë konstatimin dhe vlerësimin e grupit të auditimit si jokoherent dhe të padrejtë. Ky gjykim rrjedh nga fakti:

i. Kur institucioni nuk ka procedurë rekrutimi, nga grupi i auditimit risku vlerësohet i nivelit të Mesëm, dhe ndërkohë kur në institucion praktikohet një procedurë rekrutimi (e plotë apo e thjeshtuar), nga i njëjti grup auditimi risku vlerësohet i nivelit të Lartë;

ii. Edhe pse në periudhat e audituara më parë nga i njëjti grup auditimi ka pasur punësime me shkollim jo në përputhje me kriteret e lejuara të arsimit (Art Dizajn, Gjeografi, mësuesi e të tjera të ngajshme me to), në asnjë rast nuk janë konsideruar si shkelje.

d.)Në rekomandim, grupi i auditimit ka kërkuar të rivlerësohen të gjitha emërimet në përputhje me kriteret e miratuara të punësimit, për të siguruar kompletimin e strukturës me staf profesional dhe të kualifikuar, por ndërkohë në faqen 26 të projektraportit citohet:

	"Nga auditimi mbi emërimet dhe përputhjen e nivelit të diplomave me kërkesat e vendit të punës, pagës së miratuar konstatohet se, janë respektuar kërkesat e VKM Nr. 187, datë 8.03.2017, i ndryshuar me VKM 325, datë 31.05.2023 në lidhje me llogaritjen e të gjitha elementëve të pagës së miratuar, duke përfshirë edhe nivelin e diplomës.". Prapësojmë se, grupi i auditimit nuk mund të kërkojë rivlerësim të emërimeve, kur ai vetë është shprehur se, emërimet janë në përputhje me kërkesat ligjore mbi kualifikimin, transparente dhe në mbështetje të rritjes së kapaciteteve e aftësive profesionale. Për sa më sipër kërkojmë që, në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ndryshohet Niveli i Riskut, Konkluzioni dhe Rekomandimi i Gjetjes nr. 2 i Projektraportit të Auditimit, duke e cilësuar si të zbatuar Rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit të mëparshëm. Këtë kërkesë e mbështesim në faktin se është e papranueshme të cilësohet si pasiguri dhe mungesë transparence, përdorimi në disa raste punësimi, i procedurës së thjeshtuar apo rasteve përjashtimore. ISHTI në vijim do të rishikojë Procedurën e Rekrutimit, Punësimit dhe Largimit nga detyra të punonjësve duke përditësuar bazën ligjore, përmirësuar procedurën hap pas hapi, si dhe duke përfshirë dhe procedurën e thjeshtuar dhe rastet përjashtimore".
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr.2	Referuar observacionit të paraqitur, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Konstatimet e grupit të auditimit janë mbështetur në aktet ligjore përkatëse, të cituara shprehimisht në gjetjet e raportit. Pretendimet e subjektit të audituar vlerësohen si të karakterit justifikues dhe nuk shoqërohen me dokumentacion provues apo justifikues. Në lidhje me saktësinë e të dhënave, grupi i auditimit thekson se evidenca mbi të cilën është hartuar projekt-raporti është marrë nga Drejtoria e B.Nj.SH.M dhe është e nënshkruar nga punonjësi i drejtorisë. Të njëjtat të dhëna janë raportuar edhe në analizën vjetore të ISHTI për vitin 2023, me shkresën nr.1573 prot., datë 31.01.2024, si dhe për vitin 2024, me shkresën nr.719 prot., datë 30.01.2025. Sa sipër, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin e paraqitur nga ISHTI. Gjetja qëndron dhe do të paraqitet dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
Rishikimi i statusit të gjetjes.	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes 3: *Rregullshmëria e lëvizjeve të brendshme dhe largimi i punonjësve.*

Observacioni i Gjetjes nr. 3	Observacioni nga DBNJSHM - ISHTI "1.Përgjatë periudhës objekt auditimi (01.01.2023 - 31.12.2024), në lidhje me lëvizjet dhe largimet nga detyra, ISHTI ka vepruar referuar përcaktimeve ligjore për marrëdhëniet të cilat rregullohen me anë të

	Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. a. Deri më datë 24.11.2024, ISHTI ka zbatuar përcaktimet e Rregullores së Brendshme e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288, datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial". b. Më datë 25.11.2024 është miratuar Rregullorja e re, me anë të Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 297, datë 25.11.2024 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", urdhër i cili ka shfuqizuar Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288, datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial". c. Urdhri Nr. 2, datë 23.02.2022 "Për miratimin e procedurës së rekrutimit, punësimit dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI", për sa i përket procedurës së largimit nga detyra, bazohet në dispozitat e Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohen qartë rastet dhe procedurat e shkëputjes së marrëdhënieve të punës. 2.Rregullorja e Brendshme e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288, datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", (e shfuqizuar) nuk ka pasur asnjë përcaktim mbi procedurat për lëvizjet dhe largimet nga detyra të punonjësve. Ndërkohë, Rregullorja e re e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 297, datë 25.11.2024 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", në nenin 20 "Rekrutimi, punësimi dhe largimi nga detyra i punonjësve të ISHTI-t", ndër të tjera përcakton se: 4.Rekrutimi, punësimi dhe largimi nga detyra i punonjësve të ISHTI-t bëhet bazuar në përcaktimet e legjislacionit sektorial në fuqi, në fushën e rregullimit të marrëdhënieve të punës, sipas procedurës së miratuar nga Kryeinspektori me urdhër të brendshëm. 5. Shkëputja e marrëdhënieve të punës për punonjësit e ISHTI-t realizohet në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi, si dhe në zbatim të procedurave të miratuara nga Kryeinspektori. Nga shqyrtimi i Gjetjes nr. 3, shprehemi se: 1.Lëvizjet dhe largimet nga detyra të punonjësve në ISHTI nuk janë në kundërshtim me referencat ligjore të cituara nga grupi i auditimit, përkatësisht pikat 1 dhe 3 të nenit 20, të Rregullores së Brendshme të ISHTI-t, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 297, datë 25.11.2024 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", si dhe Urdhrit Nr. 2, datë 23.02.2022 "Për miratimin e procedurës së rekrutimit, punësimit dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI". Këtë vlerësim e mbështesim në faktin se:

a. ISHTI marrëdhëniet e punës me punonjësit, i rregullon sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohet se, Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuara. Vlerësohen si shkaqe të justifikuara të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

b. Pikat 1 dhe 3 të nenit 20, të Rregullores së Brendshme të ISHTI-t, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 297, datë 25.11.2024 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", nuk mund të gjejnë zbatim për lëvizjet dhe largimet nga detyra të kryera gjatë vitit 2023 deri më datë 24.11.2024, në të cilën ka qenë ende në fuqi Rregullorja e Brendshme e ISHTI-t, e miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 288, datë 13.10.2020 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", e cila nuk kishte asnjë përcaktim mbi procedurat e lëvizjeve dhe largimeve nga detyra të punonjësve të ISHTI-t.

c. Procedura e rekrutimit, punësimit dhe largimit nga detyra për punonjësit e ISHTI-t, është një procedurë e hartuar mbështetur në një gamë të gjerë përcaktimesh ligjore, dhe veçanërisht, në lidhje me largimet nga detyra bazohet në përcaktimet e Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, me qëllim respektimin e procedurave të nevojshme.

2. Grupi i auditimit nuk ka pasqyruar qartë të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

a. Sipas grupit të auditimit gjatë vitit 2023 janë kryer 56 lëvizje të brendshme. Ndërsa për vitin 2024 janë kryer 92 lëvizje të brendshme, ku 52 janë lëvizje brenda institucionit dhe 40 janë lëvizje brenda institucionit nga ristrukturimi. Nga grupi i auditimit janë marrë në shqyrtim dy raste të veçuara të lëvizjeve në detyrë gjatë vitit 2024 (para ristrukturimit), dhe në bazë të tyre kanë dalë në përfundimin përgjithësues se: "E njëjta procedurë është ndjekur edhe në rastet e tjera të lëvizjeve të brendshme. Për këto ndryshime grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokument që justifikon arsyet dhe nevojën për lëvizje. Gjithashtu, mungon një vlerësim i strukturuar mbi përputhsmërinë e punonjësve me pozicionet e reja të punës, duke mos u marrë në konsideratë përgatitja profesionale dhe kualifikimet e tyre."

b. Dy raste të veçuara nuk mund të përfaqësojnë të gjitha lëvizjet në detyrë të kryera përgjatë viteve 2023 – 2024. Në këto kushte sqarojmë se:

i. Në rastin e punonjëses E.J, kjo punonjëse fillimisht është punësuar, në përputhje me procedurën e plotë të rekrutimit dhe punësimit, si dhe në përputhje me kriteret e shkollimit dhe nivelit të diplomës për pozicionin përkatës, por për arsye të mbarëvajtjes së punës, si dhe

	me dëshirën e punonjëses është bërë lëvizja e brendshme, nga Inspektore në Rajonin Jugor – DINGN, në Specialiste – DLQ; ii. Për rastin e lëvizjes së punonjësit E. SH sqarojmë se, në kushtet e nevojave imediate për shtimin e numrit të inspektorëve me shkollim në fushën e inxhinierisë, duke qenë se Z. E.SH është i diplomuar Inxhinier Mekanik, Master Shkencor, punonjësi u emërua në pozicionin Inspektor në Rajonin Verior-DINGN. Në vijimësi u vu re një mospërshtatje e punonjësit me pozicionin e ri, për këtë arsye me dëshirën e tij u bë rikthimi në pozicionin e mëparshëm. Në asnjë rast grupi i auditimit nuk ka kërkuar informacion shtesë mbi lëvizjet e lartpërmendura. DBNJSHM, në çdo rast ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit informacionin e kërkuar, në formën e kërkuar. c. Dinamikat specifike të punës së punonjësve të ISHTI-t, sipas fushave përkatëse të veprimtarisë shpeshherë çojnë në vendimmarrje të cilat kërkojnë edhe lëvizje të brendshme të punonjësve (nga një drejtori në një drejtori tjetër, ose edhe brenda drejtorisë, nga një sektor në një sektor tjetër) d. Referuar legjislacionit sektorial në fuqi, në fushën e rregullimit të marrëdhënieve të punës sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, nuk ekziston asnjë detyrim ligjor që detyron titullarin e institucionit, apo personat e autorizuar prej tij, për hartimin e dokumenteve justifikuese apo argumentuese mbi lëvizjen e brendshme të punonjësve. e. Në lidhje me pretendimin e grupit të auditimit se, mungon një vlerësim i strukturuar mbi përputhshmërinë e punonjësve me pozicionet e reja të punës, duke mos u marrë në konsideratë përgatitja profesionale dhe kualifikimet e tyre, informojmë grupin e auditimit se: i. Ndryshimi i strukturës organizative të ISHTI-t është realizuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Pjesë e dokumentacionit për ndryshimin e strukturës është edhe Relacioni Shpjegues, ku detajohet edhe nevoja për ndryshim, si dhe përputhshmëria me kapacitetet profesionale të punonjësve; ii. Në asnjë rast nga grupi i auditimit nuk është kërkuar informacion shtesë mbi mënyrën e implementimit të strukturës së re të miratuar me anë të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 62, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"; ii. Implementimi i strukturës është realizuar pasi janë marrë në shqyrtim, si dhe janë organizuar takime dhe diskutime në nivele drejtuese brenda ISHTI-t, duke bërë shpërndarjen e punonjësve në pozicione, në përputhje të plotë të kritereve të kërkuara mbi arsimin, nivelin e diplomës, eksperiencës dhe përformancës në punë. f. Sipas grupit të auditimit gjatë vitit 2023 janë larguar nga detyra 39 punonjës (8 punonjës janë liruar nga detyra, 23 punonjës kanë dhënë dorëheqjen, 7 punonjës kanë plotësuar moshën e daljes në pension dhe 1 punonjës është ndarë nga jeta). Ndërsa gjatë vitit 2024 janë larguar nga detyra 45 punonjës (16 punonjës janë liruar nga detyra,

	18 punonjës kanë dhënë dorëheqjen, 4 punonjës kanë plotësuar moshën e daljes në pension dhe 7 punonjës janë larguar nga ristrukturimi). Grupi i auditimit referon se, 24 lirime nga detyra (8 lirime për vitin 2023 dhe 16 lirime për vitin 2024) janë bërë pa procedurë, thjeshtë me urdhër të Kryeinspektorit. Gjithashtu, pas studimit të rastit të lirimit nga detyra të punonjësit I.V, grupi i auditimit ka dalë në përfundimin përgjithësues se: "E njëjta procedurë është ndjekur edhe në rastet e tjera të lirimit nga detyra. Edhe për këtë punonjës grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument që të argumentojë arsyen e lëvizjes apo largimit nga puna të këtij punonjësi," Edhe në këtë rast e gjykojmë qëndrimin e grupit të auditimit si interpretim të gabuar dhe i padrejtë. Kjo për faktin se: i. Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion nga DBNJSHM informacion i detajuar mbi largimet nga detyra dhe arsyet e largimit; ii. Informacioni i dhënë verbalisht sipas kërkesës së tyre, me takim apo komunikim telefonik, nuk është marrë parasysh nga grupi i auditimit; ii. Për çdo rast të lirimit nga detyra janë marrë masa dhe janë ndjekur procedurat e nevojshme ligjore. g.Prapësojmë pretendimin se është ndjekur e njejta procedurë në të gjitha rastet e largimit nga detyra, dhe se lirimet janë bërë drejtpërdrejtë me urdhër të titullarit pa ndjekur asnjë procedurë ligjore. Qartësojmë edhe njëherë se, për vitin 2023 janë 8 lirime nga detyra, për të cilat janë ndjekur procedurat ligjore sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, më konkretisht: i. 2 raste janë braktisje e vendit të punës; ii. 1 rast është mospërputhje e llojit të diplomës me kriteret e kërkuara; iii. 5 raste janë shkëputje e menjëherëshme të marrëdhënieve të punës për arsye të justifikuara si shkelje të rënda dhe shkelje e parimit të mirëbesimit. Për secilin rast ekziston në dosjen personale të punonjësit dokumentacioni justifikues. Për vitin 2024 janë 16 lirime nga detyra, për të cilat janë ndjekur procedurat ligjore sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, më konkretisht: i. 1 rast është performancë e dobët në punë ii. 4 raste janë braktisje e vendit të punës; iii. 3 raste janë mospërputhje e llojit të diplomës me kriteret e kërkuara; iv. 6 raste janë shkëputje e menjëherëshme të marrëdhënieve të punës për arsye të justifikuara si shkelje të rënda dhe shkelje e parimit të mirëbesimit; v. 1 rast është refuzim i pozicionit të ri të punës; vi.1 rast është masa arrest me burg. Për secilin rast ekziston në dosjen personale të punonjësit dokumentacioni justifikues. h. Në lidhje me rastin e lirimit nga detyra të Z.I.V, sqarojmë edhe njëherë se ky punonjës ka refuzuar pozicionin e punës së propozuar,

nuk paraqitej në punë dhe vetëm më pas është proceduar me urdhrin për lirimin e tij nga detyra.

i. Për sa i përket pretendimit të grupit të auditimit se, "Në lidhje me largimet e stafit për shkak të ristrukturimit, nuk janë paraqitur dokumente që të argumentojnë arsyet e ndryshimeve dhe nuk është evidentuar një proces transparent i përshtatjes së stafit me pozicionet e reja", shprehemi se e prapësojmë këtë pretendim për faktin se ashtu sikurse e kemi shpjeguar edhe më lart:

i. Arsyet e nevojës së ndryshimeve të strukturës janë të shprehura qartë në Relacionin Shpjegues që shoqëron projektaktin për ndryshimin e strukturës;

ii. Në më shumë se një rast grupit të auditimit i'u është bërë e ditur verbalisht se, cila ka qenë procedura e ndjekur për përshtatjen e stafit me pozicionet e reja.

Megjithatë shohim të nevojshme të shpjegojmë edhe njëherë procedurën e ndjekur nga ISHTI. Me miratimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr. 62, datë 19.04.2024 "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", me urdhër të Kryeinspektorit Nr. 69, datë 23.04.2024 "Për Implementimin e Strukturës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", DBNJSHM ka vijuar punën për përshtatjen e stafit me pozicionet e reja.

i. Çdo punonjës i cili, për efekt të ristrukturimit ka ndryshuar pozicion, është njoftuar me e-mail zyrtar mbi ndryshimin e propozuar.

ii. Në çdo rast, emërimi në pozicionin e ri, është bërë pas marrjes së konfirmimit nga ana e punonjësit për pranimin e pozicionit të ri të punës.

iii. Punonjësit të cilëve i'u është shkurtuar vendi i punës si pasojë e ristrukturimit, janë njoftuar më parë me shkresë zyrtare, dhe më pas është lëshuar urdhri i lirimit nga detyra.

j. Në rastin e lirimit nga detyra të Z.F.K, ky punonjës ka refuzuar pozicionin e punës së propozuar sipas strukturës së re organizative të ISHTI-t, vërtetuar kjo nëpërmjet e-mailit zyrtar, dhe më pas është proceduar me urdhrin për lirimin e tij nga detyra.

k. Për sa i përket çështjes së proceseve gjyqësore, të trajtuar nga grupi i auditimit, informojmë grupin e auditimit se, referuar përcaktimeve të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës." është e drejtë e çdo punonjësi të liruar nga detyra për kërkuar mendim dhe për t'iu drejtuar gjykatës. Më pas trajtimi i çështjeve gjyqësore dhe vlerësimi i vendimeve të gjykatës është jashtë kompetencës së DBNJSHM.

Për të gjitha sa më sipër kërkojmë që, në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ndryshohet Niveli i Riskut, Konkluzioni dhe Rekomandimi i Gjetjes Nr. 3 i Projektraportit të Auditimit, pasi ashtu sikurse është paraqitur edhe më lart, ndikimi/ efekti i parashtuar nga grupi i auditimit nuk qëndron, në kushtet kur në asnjë rast, lëvizjet dhe largimet nga detyra të punonjësve, nuk janë të paargumentuara dhe në

	asnjë rast nuk krijojnë pasiguri, frikë për vendin e punës dhe demotivim të punonjësve. ISHTI në vijim do të rishikojë Procedurën e Rekrutimit, punësimit dhe largimit nga detyra të punonjësve duke përditësuar bazën ligjore, përmirësuar procedurën hap pas hapi, si dhe duke përfshirë lëvizjet e brendshme dhe rastet përjashtimore, si ristrukturimi."
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 3	Referuar observacionit të paraqitur, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Konstatimet e grupit të auditimit janë mbështetur në aktet ligjore përkatëse, të cituara shprehimisht në gjetjet e raportit. Pretendimet e subjektit të audituar vlerësohen si të karakterit justifikues dhe nuk shoqërohen me dokumentacion provues apo justifikues. Sa sipër, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin e paraqitur nga ISHTI. Gjetja qëndron dhe do të paraqitet dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes 4: *Rregullshmëria e nënshkrimit të listëpagesave*

Observacioni i Gjetjes nr. 4	Observacioni nga DBNJSHM - ISHTI "Referuar përcaktimeve të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, Listëpagesa plotësohet nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listeprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Listëpagesa është dokument zyrtar, i cili hartohet, prodhohet dhe administrohet nga njësia përgjegjëse për financat, si struktura përgjegjëse për procesin e përllogaritjes dhe ekzekutimit të pagave, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor që rregullon menaxhimin financiar në institucionet publike. Nga shqyrtimi i Gjetjes nr. 4, shprehemi se: 1. Përgjegjësia për respektimin e kërkesave të formës, përmbajtjes dhe dokumentimit të plotë të elementeve të kontrollit të brendshëm nuk mund të jetë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, për aq kohë sa, kjo drejtori nuk ka asnjë mundësi të aksesojë Listëpagesat. Ndërkohë, në projektraport Gjetja nr.4, për rregullshmërinë e nënshkrimit të listëpagesës është cilësuar si përgjegjësi e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, ndonëse kjo drejtori nuk është përgjegjëse për hartimin, prodhimin dhe finalizimin e këtij dokumenti. Në funksion të kompetencave të saj të miratuara, kjo drejtori ushtron kontroll dhe nënshkruan vetëm mbi listëprezencat, të cilat përfaqësojnë dokumentin themelor mbi të cilin mbështetet përllogaritja e pagave nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës.

	2. Grupi i auditimit ka konstatuar në projektraport se: "Listëpagesat janë mbështetur në listëprezencat mujore dhe në asnjë rast nuk rezulton të ketë mos përputhje", por në asnjë rast grupi i auditimit nuk referon se, të gjitha listëprezencat mujore janë të nënshkruara nga përgjegjësit e sektorëve dhe drejtorisë përkatëse, si dhe nga DBNJSHM. Këto konstatime tregojnë se, kontrolli i ushtruar nga DBNJSHM mbi dokumentacionin e prezencës në punë të punonjësve ka qenë korrekt dhe ka garantuar saktësinë e të dhënave hyrëse në procesin e përllogaritjes së pagave dhe se, grupi i auditimit akoma edhe njëherë nuk ka pasqyruar qartë të dhënat e vëna në dispozicion dhe nuk ka qenë koherent në konstatimin e tij kur vlerëson se: Nuk ka funksionuar kontrolli i brendshëm për procesin e dokumentimit të punës së pagave. Kjo për faktin se listëpagesat nuk janë kontrolluar dhe nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore". Për sa më sipër kërkojmë që, në Raportin Përfundimtar të Auditimit të ndryshohet përgjegjësia, Niveli i Riskut, Konkluzioni, si dhe Rekomandimi i Gjetjes Nr. 4 i Projektraportit të Auditimit, pasi ashtu sikurse është paraqitur edhe më lart, ndikimi/ efekti i parashtuar nga grupi i auditimit nuk qëndron, në kushtet kur listëpagesa nuk hartohet dhe nuk administrohet nga DBNJSHM, si dhe kur në asnjë rast, mungesa e nënshkrimit të listëpagesës nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore, nuk ka krijuar risk për realizimin e një pagese të parregullt për aq kohë sa, hartimi i listëpagesës është bazuar mbi listëprezencën, dokument i cili është kontrolluar dhe nënshkruar nga DBNJSHM. Në vijim, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse angazhohet të marrë menjëherë masat e nevojshme për rritjen e bashkëpunimit me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës për zbatimin rigoroz të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, Paragrafi III, pika 69, duke përmirësuar funksionimin e kontrollit të brendshëm për procesin e dokumentimit të punës së pagave". Referuar observacionit të paraqitur, gjetja është pranuar nga subjekti i audituar.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 4	Konkluzioni i auditimit mbetet i pandryshuar.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes 5: *Mospërputhje në harmonizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon funksionimin e ISHTI-t.*

Observacioni i Gjetjes nr. 5	*Observacioni nga DBNJSHM - ISHTI* "Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk është përgjegjëse për harmonizimin e legjislacionit me të cilin funksionon dhe operon ISHTI, pasi kjo detyrë nuk përfshihet në detyrat e saj funksionale dhe organizative. Ndërkohë, në projektraport Gjetja nr. 5, për harmonizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon funksionimin e ISHTI-t është cilësuar si përgjegjësi e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 192, më datë 13.11.2024, është shfuqizuar Ligji Nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë". VKM Nr. 584, datë 28.8.2003 "Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave" e ndryshuar, përcakton se: "Kryeministri dhe çdo ministër kanë të drejtën e propozimit të projektakteve për shqyrtim në Këshillin e Ministrave". Nga shqyrtimi i Gjetjes nr. 5, shprehemi se: 1. DBNJSHM, me kërkesë të grupit të auditimit nëpërmjet komunikimit telefonik, (pas përfundimit të periudhës së angazhimit të tij pranë ISHTI-t) ka dhënë informacion të detajuar, duke paraqitur tablonë e plotë dhe të qartë mbi situatën ekzistuese ndër vite, për sa i përket mënyrës së rregullimit të marrëdhënieve të punës së punonjësve të ISHTI-t. Më konkretisht, në komunikimin telefonik, Znj. Merita Gjoka i është bërë e ditur se: a. Ligji Nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Neni 20 përcakton se: "Marrëdhëniet e punësimit të inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësit civilë për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Kryeinspektori i inspektoratit përkatës është "eprori i drejtpërdrejtë" i inspektorëve, në kuptimin e këtyre dispozitave. Ky përcaktim zbatohet edhe për nëpunësit e tjerë të inspektoratit shtetëror, që nuk janë inspektorë, me përjashtim të punonjësve që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, të cilët u nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.". b. VKM Nr. 410, datë 13.05.2015 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial", Kreu III, pika 7, përcakton se: "Struktura dhe organika e ISHTI-së miratohen me urdhër të Kryeministrit. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të ISHTI-së rregullohen sipas ligjit të nëpunësit civil". c. Për arsye të cilat nuk mund të konsiderohen përgjegjësi e DBNJSHM, për punonjësit e ISHTI-t marrëdhëniet e punës janë rregulluar sipas dispozitave të Kodit të Punës. Edhe pse nga ISHTI janë bërë disa tentativa për sistemimin e situatës, duke kërkuar edhe

asistencë nga organet kompetente (Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Departamenti i Administratës Publike) kjo situatë ka vijuar ndër vite. Në këtë kontekst, ISHTI ka kërkuar asistencën e tyre për realizimin e procesit të kalimit të punonjësve të këtij institucioni, nga punonjës me Kod Pune, në punonjës me statusin e Nëpunësit Civil, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, por këto nisma nuk kanë rezultuar të suksesshme.

d. Gjithashtu, Znj. Gjoka i'u bë e ditur se, me miratimin e Ligjit Nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ka ndryshuar mënyra e rregullimit të marrëdhënieve të punës për punonjësit e inspektorateve qendrore. Përkatësisht neni 20 i këtij ligji përcakton se: Marrëdhëniet e punësimit për punonjësit e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe të inspektorateve qendrore rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, si dhe rastet dhe procedurat për shkarkimin dhe lirimin nga detyra të inspektorit të inspektoratit qendror dhe Inspektoratit të Përgjithshëm miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në këto kushte, ashtu sikurse i'u sqarua edhe Znj. Gjoka në komunikimin telefonik, ISHTI mbetet në pritje të përfundimit të fazës së hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në mënyrë që të mund të vijojë me inicimin e kërkesës për përshtatjen e VKM Nr. 410 datë 13. 05. 2015 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial", sipas ndryshimeve të reja ligjore.

2. Referuar Projektraportit të Auditimit, vëmë re se sërish grupi auditimit, në mënyrë të padrejtë dhe të njëanëshme jo vetëm nuk ka marrë parasysh shpjegimet dhe argumentat lidhur me aspektet ligjore dhe procedurale të dhëna nga DBNJSHM mbi çështjen, por i ka përdorur ato për t'i trajtuar si gjetje, duke e vlerësuar si Nivel Risku të Lartë.

Sipas grupit të auditimit, kjo situatë krijon rrezik për interpretim të gabuar të statusit të punonjësve të ISHTI-t, nëse janë nëpunës civil apo punonjës sipas Kodit të Punës, gjë e cila nuk qëndron, pasi në çdo rast në momentin e punësimit punonjësit e ISHTI-t njihen me Urdhrin e Emërimit, situatën dhe nënshkruajnë Kontratën Individuale të Punës, e cila është e hartuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fushën e punësimit sipas dispozitave të Kodit të Punës dhe Kodit Civil. Duke qenë se, grupi i auditimit është i paqartë shohim të nevojshme të sqarojmë se:

i. ISHTI është institucion në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe referuar veprimtarisë së tij funksionale nuk ka kompetencë të ndërmarrë nisma për rishikimin/ ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore.

ii. Ligji Nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", referuar Nenit 129 të tij ku përcaktohet se: "Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.", ka hyrë në

	fuqi më datë 13.05.2025, pasi është botuar në Fletoren Zyrtare më datë 13.11.2024. Pra, për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2024 ka qenë ende në fuqi Ligji Nr. 10433 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", gjë e cila nënkupton se, miratimi i ligjit të ri të inspektimit nuk ka ndikuar në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ISHTI-t. iii. Në kushtet kur Ligji Nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në dispozitat kalimtare dhe të fundit përcakton detyrimin ligjor për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të tij, gjatë kësaj periudhe tranzitore është e pamundur të ndërmerren nisma për harmonizimin e legjislacionit, pasi ende janë të paqarta dhe të papërcaktuara fushat dhe niveli i ndikimit të këtyre akteve. Për këtë arsye, vetëm pas përfundimit të fazës së hartimit dhe miratimit të të gjitha akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ISHTI do të fillojë procesin e analizimit të tyre, për të vlerësuar nivelin e ndikimit dhe nevojën për ndryshime të VKM Nr. 410 datë 13. 05. 2015 "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial", për të vijuar më pas me dërgimin në MIE të propozimeve dhe kërkesës për ndryshime ligjore. Për të gjitha sa më sipër kërkojmë që, Gjetja Nr. 5 e Projektraportit të Auditimit të mos përfshihet në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pasi ashtu sikurse është paraqitur edhe më lart, ndikimi/ efekti i parashtuar nga grupi i auditimit nuk qëndron, në kushtet kur Ligji Nr. 99, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili ka hyrë në fuqi gjatë vitit 2025, nuk i shtrin efektet e tij për periudhën objekt auditimi (01.01.2023 – 31.12.2024), pasi ligji nuk ka fuqi prapavepruese. Në vijim, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial do të angazhohet të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me Inspektoratin e Përgjithshëm për të realizuar sa më shpejt këtë proces" . Referuar observacionit të paraqitur, gjetja është pranuar nga subjekti i audituar.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 5	Konkluzioni i auditimit mbetet i pandryshuar.
Rishikimi i statusit të gjetjes.	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes 6: *Mos mbajtja e regjistrimeve kontabël me bartës informatik dhe mos administrimi si duhet i të dhënave kontabile.*

Observacion i Gjetjes nr.6	ISHTI ka observuar se: "Në lidhje me konstatimin e auditit mbi përdorimin e programeve financiare dhe mjeteve ndihmëse, sqarojmë se ISHTI ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale për sigurimin dhe implementimin e një sistemi të plotë financiar, duke respektuar në mënyrë rigoroze kuadrin ligjor për prokurimet dhe menaxhimin financiar publik. 1.Fillimisht, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka përcaktuar kërkesat funksionale për një program të integruar kontabël. Më pas, janë kryer procedurat e prokurimit dhe është lidhur një kontratë një vjeçare për implementimin e programit "Bilanc", me qëllim dixhitalizimin e procesit kontabël dhe standardizimin e raportimit financiar. 2.Gjatë periudhës së implementimit, ndonëse janë realizuar trajnime dhe testime të moduleve të programit, rezultoi se sistemi mundësonte vetëm përdorimin e disa moduleve bazë dhe nuk përshtatej me nevojat specifike të ISHTI-t si institucion që gjeneron të ardhura. Konkretisht, sistemi nuk ofronte module funksionale për: a.menaxhimin e të ardhurave sipas klasifikimit të Thesarit (veçanërisht klasa 7), b.rakordimin automatik me sistemin e Thesarit, c.përpunimin e pagave (sistemi mundësonte vetëm regjistrimin kontabël dhe jo llogaritjen e tyre) etj. 3.Për shkak të këtyre kufizimeve teknike, programi nuk arriti të përdorej në mënyrë të plotë e funksionale për të gjitha proceset financiare, pavarësisht përpjekjeve të stafit dhe ofruesit të shërbimit për ta përshtatur atë me kërkesat e institucionit. 4.Pas përfundimit të kontratës, ISHTI rifilloi procedurat për sigurimin e një sistemi tjetër financiar më të avancuar. Pas një procesi të gjatë teknik e procedural, është kontraktuar programi financiar "Parid Smart Solution", i cili aktualisht ndodhet në fazën e implementimit të moduleve përkatëse, me përshtatje graduale sipas nevojave të institucionit. Ky proces vijon ende, pasi disa module kërkojnë konfigurime shtesë për t'u përputhur me specifikat e mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar. 5.Së bashku me këtë proces, ISHTI është pjesë e një projekti të përbashkët me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për ndërtimin e një Sistemi të Përgjithshëm të Menaxhimit institucional (Sistemi i Menaxhimit të proceseve të punës), i cili do të integrojë proceset administrative, financiare dhe teknike të institucionit. Ky projekt, në momentin që implementohet, pritet të zgjidhë përfundimisht mospërputhjet ekzistuese, të standardizojë regjistrimet financiare dhe të krijojë një platformë të unifikuar për administrimin e të gjitha proceseve të institucionit. 6.Derisa implementimi i plotë i sistemit të ri dhe projekti me AKSHI të finalizohen, Drejtoria e Financës ka garantuar vazhdimësinë dhe cilësinë e proceseve kontabël përmes ndërtimit të moduleve të brendshme në Excel, të strukturuara me formula të automatizuara për:

	a.mbajtjen e ditarëve financiarë, b.rakordimet periodike, c.kontrollin e saktësisë së të dhënave, d.uljen e mundësisë së gabimeve manuale, e.rritjen e gjurmueshmërisë dhe transparencës financiare. f.Raporte analitike dhe sintetike per shpenzimet dhe te ardhurat sipas struktures gjeneruese te tyre dhe periudhave raportuese (mujore, dhe progresiv deri ne ate vjetor). Theksojmë se përdorimi i Excel-it ka qenë ekskluzivisht mjet ndihmës teknik, pa cënuar në asnjë rast parimet e kontabilitetit buxhetor dhe pa zëvendësuar regjistrimet zyrtare kontabël, të cilat janë kryer gjithmonë sipas kërkesave ligjore dhe standardeve të menaxhimit financiar publik."
Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen	Observacioni i paraqitur nuk e rrëzon thelbin e gjetjes, pasi subjekti pranon faktin thelbësor se sistemi financiar i dedikuar nuk ka qenë funksional gjatë periudhës së auditimit dhe se proceset kontabël janë realizuar përmes përdorimit të Excel-it. Pavarësisht vështirësive teknike dhe procedurale të paraqitura si argument, mospërdorimi i një sistemi financiar të certifikuar dhe mbështetja në mjete manuale mbetet në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 25/2018. Nënshkrimi i kontratës dhe nisja e procedurave për sigurimin e një sistemi financiar te ri nuk e përjashton përgjegjësinë e institucionit për të garantuar funksionimin praktik të tij, dokumentimin zyrtar dhe gjurmueshmërinë e plotë të regjistrimeve kontabël. Gjithashtu, subjekti nuk paraqet prova që ditarët kontabël janë printuar dhe protokolluar në përputhje me nenin 8 të ligjit apo që sistemi financiar i dedikuar ka qenë në përdorim zyrtar. Excel-i nuk përmbush kriteret ligjore për bartës informatik dhe nuk garanton siguri teknike, kontroll, audit trail apo pamanipulueshmëri të dhënash.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes 7: *Pasaktësi në pasqyrimin e flukseve monetare në pasqyrën "Cash Floë"*

Observacion i Gjetjes nr.7	ISHTI ka observuar se: "Në raportin e auditit janë identifikuar pasaktësi në pasqyrimin e flukseve monetare në pasqyrën Cash Floë. Të gjitha pagesat janë të rregjistruara në mënyrë të rregullt në ditarin e shpenzimeve dhe janë të rakoduara edhe me degën e Thesarit Tiranë. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës angazhohet në përditësimin e pasqyrave të flukseve monetare në përputhje me akt rakordimet dhe rregjistrat kontabël dhe pasqyrat Financiare Vjetore."
Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen	Observacioni i ISHTI-së pranon ekzistencën e pasaktësive në pasqyrimin e flukseve monetare, duke sqaruar se regjistrimet janë kryer saktë në ditarë dhe janë rakorduar me Thesarin, por nuk janë reflektuar plotësisht në pasqyrën "Cash Floë". Ky fakt konfirmon

	mospërputhjen ndërmjet regjistrave kontabël dhe pasqyrës financiare, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018. Angazhimi për përditësim të pasqyrave është masë korrigjuese pozitive, por nuk ndryshon vlerësimin e auditit, pasi pasqyrat vjetore janë paraqitur fillimisht me pasaktësi. Për rrjedhojë, gjetja mbetet e vlefshme dhe rekomandimi vijon të konsiderohet i domosdoshëm.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes 8: *Mungesë efektiviteti në ndjekjen dhe arkëtimin e debitorëve*

Observacion i Gjetjes nr.8	ISHTI ka observuar se: "1. Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN), është strukturë përgjegjëse e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), për: a.Kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e saj në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre. b.Kontrollin e zbatimit të normave dhe kushteve teknike në përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse nga personat juridik. c.Kontrollin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në Licencat përkatëse që u janë dhënë personave juridikë, përfshirë dhe kushtet teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe ruajtjen e mjedisit. d.Kontrollin e respektimit të standardeve për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj për t'u siguruar konsumatorëve produkte cilësore sipas standardeve në fuqi. 2.Arkëtimet nga shërbimet e kontrollit cilësor, ku ka subjekte që nuk kanë shlyer detyrimet. 3.Kontrolli për respektimin e standardeve shtetërore per cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj kryhet në zbatim të pikës 2 të nenit 23 të ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 " Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar. Në ligj përcaktohet se "Shpenzimet për kontrollin e cilësisë të naftës e nënprodukteve të saj përballohen nga vete subjektet". 4.Në urdhërin e ministrit Nr. 6, datë 09.01.2015 përcaktohen tarifat përkatëse për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj. 5.Me daljen e VKM Nr. 491, datë 19.07.2017 dhe në vijim të Urdhërit Nr. 315, datë 24.08.2017, u përcaktua se lëshimi i vërtetimeve për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet teknologjike do të kryhet nga organet e miratuara të vlerësimit të konformitetit, të akredituara, duke shfuqizuar në ketë mënyrë urdhërin Nr. 76, datë 18.03.2015 "Për proçedurat dhe tarifat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushen e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj", i cili në gërmën "h" të kreut të III përcaktonte

	se ISHP-ja nuk lëshon vërtetime teknike për subjektet të cilat janë debitorë ndaj saj. 6.Shfuqizimi i këtij urdhëri na ka vënë në vështirësi serioze si institucion. 7.Në këtë kuptim, ky institucion nuk ka të përcaktuar mekanizmat detyrues ligjore për vjeljen e tarifave për kontrollin periodik cilësor të naftës dhe nënprodukteve te saj."
Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen	Observacioni i ISHTI nuk paraqet argumente që të ndryshojnë përmbajtjen dhe konkluzionin e gjetjes. Problemi themelor vazhdon të qëndrojë në mungesën e një procedure të strukturuar dhe mekanizmave efektivë për ndjekjen, arkëtimin dhe monitorimin e detyrimeve nga gjobat dhe shërbimet. Pavarësisht ndryshimeve në kuadrin rregullator apo vështirësive të hasura në zbatim, institucioni mbetet përgjegjës për organizimin e një sistemi funksional të menaxhimit të debitorëve, duke përfshirë analizimin e tyre sipas afateve të krijimit, ndërmarrjen e procedurave administrative, gjyqësore ose përmbarimore, si dhe vlerësimin e detyrimeve të vjetra për efekt parashkrimi. Mungesa e këtyre proceseve ka sjellë akumulim të detyrimeve të pambledhura dhe rritje të riskut për mosarkëtim të fondeve publike, si dhe pasqyrim jo të saktë të gjendjes reale financiare. Për rrjedhojë, gjetja mbetet e vlefshme dhe rekomandimi për forcimin e procedurave institucionale në administrimin e debitorëve vlerësohet i domosdoshëm.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes 9: *Parregullsi në procesin e inventarizimit të pasurisë*

Observacion i Gjetjes nr.9	ISHTI ka observuar se: "Referuar Gjetjes Nr. 9 mbi gjetjen e parregullsive në procesin e inventarizimit të pasurisë, ku grupi i auditimit konkludon se, nuk është bërë verifikimi sasior dhe cilësor i të gjitha aktiveve pasi një pjesë e aktiveve vazhdon të jetë në ngarkim të personave të larguar nga institucioni. Vlen të theksojmë, sikurse kemi argumentuar dhe përpara grupit të auditit dhe me dokumentacion fizik,: 1.Pas çdo procesi të inventarizimit fizik të aktiveve që kryhet çdo fundviti pranë institucionit, janë njoftuar strukturat përgjegjëse për të ndjekur rrugën ligjore dhe konkretisht janë dërguar listat emërore bashkë me kartelën përkatëse të personave të larguar, Drejtorisë së Çështjeve Juridike për të vazhduar procedurat e mëtejshme për sistemimin e situatës. Kjo ka bërë që vetëm për këto aktive të jetë e pamundur inventarizimi fizik i tyre, pjesa tjetër është realizuar konform legjislacionit në fuqi. 2.Gjatë vitit 2025 është mbajtur në vëmendje në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse që çdo punonjës të larguar të bëhet verifikimi dhe dorëzimi i inventarëve

	personale përpara se të tërheqin dokumentacionin e tyre të largimit. 3.Institucioni dhe në veçanti Drejtoria e Buxhetit dhe Financës vlerëson maksimalisht konstatimet e paraqitura nga grupi i auditimit dhe angazhohet që të gjitha rekomandimet e dhëna të trajtohen me seriozitet të plotë. Për çdo gjetje do të ndërmerren masa konkrete korrigjuese dhe përmirësuese, në përputhje me kuadrin ligjor dhe afatet përkatëse, me qëllim garantimin e rritjes së efektivitetit, transparencës dhe funksionimit të qëndrueshëm të proceseve financiare dhe administrative të institucionit."
Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen	Observacioni i ISHTI nuk paraqet argumente që të ndryshojnë përmbajtjen dhe konkluzionin e gjetjes. Thelbi i konstatuar nga auditimi mbetet fakti që një pjesë e aktiveve ka vijuar të figurojë në ngarkim të personave të larguar nga institucioni dhe për këto aktiva nuk është kryer verifikim sasior dhe cilësor nga komisioni i inventarizimit, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Pavarësisht njoftimeve të strukturave përgjegjëse apo masave të ndërmarra më pas, inventarizimi fizik i aktiveve për periudhën e auditimit duhej të ishte realizuar i plotë dhe i dokumentuar për të gjitha asetet, përfshirë edhe ato në ngarkim të ish-punonjësve. Mungesa e këtij procesi krijon pasiguri mbi ekzistencën fizike dhe gjendjen cilësore të aktiveve dhe cënon besueshmërinë e të dhënave kontabël. Për rrjedhojë, gjetja mbetet e vlefshme dhe rekomandimi për inventarizimin e plotë të aktiveve vlerësohet i domosdoshëm.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar

Titulli i Gjetjes: *Mospërputhje në dokumentimin dhe dërgimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2024 pranë Ministrisë Përgjegjëse (MIE).*

Observacioni i Gjetjes nr. 10	Në observacionin e paraqitur, për gjetjen nr.10, "*Mospërputhje në dokumentimin dhe dërgimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2024 pranë Ministrisë Përgjegjëse*"; ndërmjet të tjerash shënohet se: "Në lidhje me dërgimin e Programit Vjetor të Inspektimeve për miratim në MIE, ju bëjmë me dije se, nga ISHTI është hartuar draft-shkresa, por për arsye gabimi njerëzor nuk është dërguar në MIE. Vlen të theksohet se, nuk kemi të bëjmë me neglizhencë, apo rast të përsëritur, por është vetëm një rast sporadik si shkak i pakujdesisë. Në vijim, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial do të ndjekë me seriozitet zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me miratimin e Programit Vjetor të inspektimeve nga Inspektorati i Përgjithshëm dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë". Sa sipër, nga ISHTI është pranuar konstatimi i grupit të auditimit. Gjetja qëndron dhe do të paraqitet dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 10	Konkluzioni mbetet i pandryshuar.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pa ndryshuar
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pa ndryshuar.

Titulli i Gjetjes: *Pasaktësi në referimet ligjore në aktet e inspektimit që ndikojnë në procesin e ankimit*

Observacioni i Gjetjes nr. 11	Në observacionin e paraqitur, për gjetjen nr.11, *"Pasaktësi në referimet ligjore në aktet e inspektimit që ndikojnë në procesin e ankimit"*; ndërmjet të tjerash shënohet se: "Në çdo rast të konstatuar Inspektorëve që kanë kryer inspektimet ju është tërhequr vëmendje për respektimin e përcaktimeve ligjore, si dhe është vijuar me trajnimin për zbatimin me rigorozitet të kuadrit ligjor në fuqi gjatë procedurave inspektuese. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqiperisë" dhe VKM Nr.407, datë 16.7.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit", komisioni i gjobave mblidhet në Inspektoratin e Përgjithshëm". Referuar observacionit të paraqitur, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Nga ISHTI është pranuar konstatimi i grupit të auditmit, megjithatë në observacion janë shprehur se: inspektorëve që kanë kryer inspektimet ju është tërhequr vëmendje, pa vënë në dispozicion asnjë dokument bashkëlidhur observacioneve. Sa sipër grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin e paraqitur nga ISHTU. Gjetja qëndron dhe do të paraqitet dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 11	Konkluzioni i auditimit mbetet i pandryshuar.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pandryshuar.
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pandryshuar

Titulli i Gjetjes 12: *Kryerje disa inspektimeve jashtë programit në të njëjtin subjekt, të pa argumentuar për domosdoshmërinë e tyre, brenda një periudhe shumë të shkurtër, me trupë inspektuese me përbërje më shumë se gjysma e tyre të njëjtët persona, me përfundim inspektimi me të njëjtën shkelje por me masa administrative të ndryshme, duke ekspozuar institucionin ndaj*

risqeve të integritetit dhe atyre etike – profesionale. Kjo dhe për faktin se Inspektimi i mëvonshën nga i pari është kryer brenda afatit të lënë nga inspektimi i parë për rregullimin e situatës.

Observacioni i Gjetjes nr. 12	Në observacionin e paraqitur, për gjetjen nr.12, "*Kryerje disa inspektimeve jashtë programit në të njëjtin subjekt, të pa argumetuar për domosdoshmërinë e tyre, brenda një periudhe shumë të shkurtër, me trupë inspektuese me përbërje më shumë se gjysma e tyre të njëjtët persona, me përfundim inspektimi me të njëjtën shkelje por masa administrative të ndryshme, duke ekspozuar institucionin ndaj risqeve të integritetit dhe atyre etike-profesionale. Kjo dhe për faktin se Inspektimi i mëvonshëm nga i pari është kryer brenda afatit të lënë nga inspektimi i parë për rregullimin e situatës;* ndërmjet të tjerash shënohet se: "Inspektimi për subjektin "Bujari Group" shpk NUIS L71907003O me vendndodhje Bulevardi Blu, Tiranë që ka shkelje të kërkesave ligjore dhe në komentin është përshkruar që u morën masa urgjente të bllokimit të pistoletave, heqjes së rezervuarit dhe revokim i vërtetimit teknik. Stacioni i shitjes me pakicë të karburanteve "Bujari Group" shpk NUIS L71907003O me vendndodhje Bulevardi Blu, Tiranë është inspektuar me datë 14.11.2023 në zbatim të Autorizim Inspektimi Jashtë Programit me Nr. 9384/1 prot., datë 14.11.2023. Nga inspektimi i mbajtur rezulton se ka shkelje të kërkesave ligjore. Në bazë të check listës së DIPNP është vendosur sanksion me gjobë për shkelje të ligjit nr. 32/2016, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion". U morën masa për bllokimin e pistoletave dhe detyra për heqje e rezervuarit të GLN-së dhe revokim të Vërtetimit Teknik. Për shkelje të nenit 15, pika 1 të ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar është vendosur sanksion me gjobë në vlerën 700000 lekë sipas Nenit 25, pika 1, gërma nj dhe iv. Inspektorëve që kanë kryer inspektimin e lartpërmendur ju është tërhequr vëmendje për rastin në fjalë dhe është vijuar me trajnimin për zbatimin me rigorozitet të kuadrit ligjor në fuqi gjatë procedurave inspektuese. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM Nr. 407, datë 16.7.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit" komisioni i gjobave mblidhet në Inspektoratin e Përgjithshëm".

Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 12	Referuar observacionit të paraqitur, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Konstatimi i grupit të auditimit është pranuar, në observacion janë shprehur që ndaj inspektorëve që kanë kryer inspektime ju është tërhequr vëmendje, por nuk kanë paraqitur asnjë dokumentacion bashkëlidhur observacioneve. Sa sipër, grupi i auditimit e merr në konsideratë observacionin e paraqitur nga ISHTI në lidhje me gjetjen për Komisionin e Ankimit duke mos e pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Lidhur me pjesën tjetër të gjetjes, opinioni mbetet i pa ndryshuar. Gjetja qëndron dhe do të pasqyrohet dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Kontrolli i brendshëm vlerësohet si jo efektiv në sistemin e inspektimeve, për faktin se nga ISHTI në një rast, janë kryer disa inspektime jashtë programit në të njëjtin subjekt, të pa argumentuar për domosdoshmërinë e tyre, brenda një periudhe shumë të shkurtër, me trupë inspektuese me përbërje më shumë se gjysma e tyre të njëjtët persona, me përfundim inspektimi me të njëjtën shkelje por me masa administrative të ndryshme, duke ekspozuar institucionin ndaj risqeve të integritetit dhe atyre etike – profesionele. Kjo dhe për faktin se Inspektimi i mëvonshën nga i pari është kryer brenda afatit të lënë nga inspektimi i parë për rregullimin e shkeljeve.
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pandryshuar

Titulli i Gjetjes: *Mungesë miratimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për përbërjen e Komisionit të Ankimit pranë ISHTI-t.*

Observacioni i Gjetjes nr. 13	Në observacionin e paraqitur, për gjetjen nr.10, "Mungesë miratimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për përbërjen e Komisionit të Ankimit pranë ISHTI-t; ndërmjet të tjerash shënohet se: Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqiperisë" dhe VKM Nr.407, datë 16.7.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit", komisioni i gjobave mblidhet në Inspektoratin e Përgjithshëm.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 13	Sa sipër grupi i auditimit e merr në konsideratë observacionin e paraqitur nga ISHTI. Gjetja nuk do të pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Nuk do pasqyrohet në raportin përfundimtar
Rishikimi i nivelit të riskut	Nuk do pasqyrohet në raportin përfundimtar

Titulli i Gjetjes14: *Parregullsi e raportimit të strukturave përkatëse mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit*

Observacion i Gjetjes nr.14	ISHTI ka observuar se: "Pasi u njohëm me rekomandimin në Gjetjen Nr. 14 dhe verifikimit të informacionit periodik përcjellë pranë MIE, pasi u konsultuam dhe me strukturat përgjegjëse po në MIE, në vijim Pyetësori i vetëvlerësimit që është depozituar brenda afateve për çdo periudhë do të shoqërohet me Deklaratën e Cilësisë dhe Raportin Vjetor. ISHTI është strukturë varësie që konsolidohet pranë MIE ndaj dhe raportimi si Neni 18 i Ligjit nr. 10296/2010 pranë MFK bëhet nga MIE, pasi konsolidohen raportimet nga të gjitha strukturat në varësi. Gjithsesi, në vijim ne do të përcjellim bashkëlidhur Pyetësorit të Vetëvlerësimit për cdo periudhë raportuese edhe Deklaratën e Cilësisë të sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe Raportin e Planit të Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin."
Konkluzioni përfundimtar i audituesve për gjetjen	Observacioni i ISHTI nuk paraqet argumente që të ndryshojnë përmbajtjen dhe konkluzionin e gjetjes. Thelbi i konstatuar nga auditimi mbetet fakti që, për periudhën objekt auditimi, nuk janë vënë në dispozicion Deklarata e Cilësisë dhe Raporti Vjetor mbi funksionimin e sistemit të MFK-së, siç kërkohet shprehimisht nga neni 18 i Ligjit nr. 10296/2010.
Rishikimi i statusit të gjetjes	Statusi i gjetjes mbetet i pandryshuar.
Rishikimi i nivelit të riskut	Niveli i riskut mbetet i pandryshuar

Grupi i Auditimit

Merita GJOKA

Kristina DELIU

Shkurte HALILI

Ardiana ALIMERT

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT PËRFUNDIMTAR

INSPEKTORIATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL, TIRANË

Lloji i auditimit: Auditim Përputhshmërie

Periudha e Audituar : 01.01.2023 – 31.12.2024

JANAR, 2026

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Mbi auditimin e ushtruar në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është krijuar me VKM Nr.410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", i cili është institucion publik buxhetor në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
ISHTI, është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e: a) përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre; b) sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike; c) sigurisë së punës së instalimeve nën presion; ç) sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror; d) sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë joushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë;

Për periudhën objekt auditimi, evidentohet se subjekti është organizuar konform dispozitës ligjore të krijimit, ka të përcaktuar fushën e veprimtarisë, dhe organizuar me struktura që mbulojnë veprimtaritë teknike inspektuese sipas fushave të veprimtarisë, me strukturë të analizave laboratorike si dhe me strukturë mbështetëse për realizimin dhe funksionimin e aktiviteteve dhe raportimin ekonomiko financiar.

Objekti i auditimit: Auditim mbi rregullshmërinë e funksionimit të sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar, realizimi i objektivave të institucionit, rregullshmëria dhe ligjshmëria e funksionimit dhe raportimit financiar. Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve.

- ***Opinion mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit te brendshëm.***

Në përfundim të auditimit vlerësojmë se në fushat e përfshira në auditim janë konstatuar të meta dhe parregullsi që cënojnë funksionimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm si dhe arritjen e objektivave të Inspektoriatit Shtetërorë Teknik dhe Industrial, me gjetjet si më poshtë:

- Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e ISHTI-së nuk është ende i harmonizuar me ndryshimet e parashikuara në Ligjin nr.99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Në aktet nënligjore ekzistuese, marrëdhëniet e punës rregullohen në përputhje me Ligjin "Për nëpunësin civil", ndërkohë që ligji i ri përcakton se këto marrëdhënie duhet të bazohen në dispozitat e Kodit të Punës. Kjo mospërputhje krijon pasiguri ligjore dhe rrezikon cenimin e ligjshmërisë në administrimin e marrëdhënieve të punës.
- Për periudhën e audituar, janë krye shpenzime për udhëtime dhe dieta brenda vendit, për distanca mbi 100 km larg nga qendra e punës, pa pasur miratimin e Titullarit të institucionit qëndror apo të përfaqësuesit të deleguar prej tij. Kjo praktikë bie me kriteret e përcaktuara në VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar.
- Në periudhën e auditimit, për 23 raste procesi i rekrutimit të punonjësve nuk është zhvilluar në përputhje me procedurat e brendshme të miratuara, si Urdhërin e Kryeinspektorit Nr.02, datë

23.02.2022 "Për miratimin e procedurës se rekrutimit, punësimit, dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI" dhe rregulloren e Brendshme të ISHTI-t.

- Nga shqyrtimi i praktikave të ndjekura për lëvizjet e brendshme dhe largimet nga puna në ISHTI, rezulton se: Për periudhën objekt auditimi nga 199 punonjës që është struktura e miratuar, janë kryer lëvizje të brendshme në vendet e punës për 148 punonjës. Ndërsa kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me ISHTI gjithsej 84 punonjës, nga të cilët 41 punonjës kanë dhënë dorëheqjen dhe 31 punonjës janë larguar nga detyra. Nga të larguarit 4 janë rikthyer dhe 13 të tjetër kanë hapur proces gjyqësor. Këto veprime janë kryer në mungesë të një procesi të dokumentuar dhe pa respektuar procedurat ligjore dhe rregulloren e brendshme. Kjo ka sjellë pasiguri në punë dhe rritje të numrit të padive gjyqësore për rrjedhojë duke ekspozuar ISHTI-n ndaj rritjes së shpenzimeve të personelit për një vend pune.
- Nuk ka funksionuar kontrolli i brendshëm për procesin e dokumentimit të punës së pagave. Kjo për faktin se listëpagesat nuk janë kontrolluar dhe nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore.
- Për periudhën 2023–2024, procesi i ndjekjes, arkëtimit dhe administrimit të detyrimeve nga gjobat dhe shërbimet në ISHTI nuk është realizuar në mënyrë të plotë dhe efektive. Në fund të vitit 2024, vlera totale e debitorëve rezulton 1,322,181,736 lekë, nga të cilat 1,203,289,127 lekë i përkasin gjobave dhe 108,059,979 lekë detyrimeve për shërbime. Niveli i arkëtimit të këtyre detyrimeve është i ulët dhe shuma e pambledhur paraqet trend rritës nga viti në vit.
  Sa i përket gjobave, ekzistojnë vetëm analiza pjesore mbi afatet e krijimit (deri në vitin 1999), por mungon një inventarizim i plotë dhe i saktë për secilin subjekt, vlerën e gjobës, si dhe masat e ndërmarra për arkëtimin e tyre, qoftë nëpërmjet procedurave gjyqësore, përmbarimit apo vlerësimit të mundësisë së arkëtimit. Këto analiza duhet të kryhen rregullisht çdo vit, në kuadër të inventarizimit të aktiveve.
  E njëjta situatë vërehet edhe për detyrimet nga shërbimet. Përveç mangësive të evidentuara për gjobat, ISHTI nuk kryen analiza të plota lidhur me situatën e debitorëve për shërbime apo funksionimin e mekanizmave detyrues për arkëtimin e vlerës së shërbimeve.
- Nga Komisioni i Ankimit, në vitin 2023 janë shfuqizuar 23.5% e vendimeve te inspektore dhe janë ndryshuar masat për 35% te vendimeve. Ndërsa, për vitin 2024 janë shfuqizuar 26 % e vendimeve të grupit të inspektorëve. Bazuar në vendimarrjen e komisionit rezulton se në një pjesë të vendimeve fillestare të inspektorëve nuk janë respektuar plotësisht kërkesat procedurale dhe standardet ligjore të procesit të inspektimit dhe të arsyetimit administrativ.
  Për të përmirësuar këtë situatë nuk është marrë asnjë masë nga ana e ISHTI-t.
- Kontrolli i brendshëm vlerësohet si jo efektiv në sistemin e inspektimeve, për faktin se nga ISHTI në një rast, janë kryer disa inspektime jashtë programit në të njëjtin subjekt, të pa argumentuar për domosdoshmërinë e tyre, brenda një periudhe shumë të shkurtër, me trupë inspektuese me përbërje më shumë se gjysma e tyre të njëjtët persona, me përfundim inspektimi me të njëjtën shkelje por me masa administrative të ndryshme, duke ekspozuar institucionin ndaj risqeve të integritetit dhe atyre etike – profesionele. Kjo dhe për faktin se Inspektimi i mëvonshën nga i pari është kryer brenda afatit të lënë nga inspektimi i parë për rregullimin e shkeljeve.
- Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) nuk ka zbatuar një sistem të sigurt dhe të standardizuar për mbajtjen dhe administrimin e kontabilitetit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe parimet e menaxhimit financiar. Mbajtja e kontabilitetit përmes programit Excel, mosimplementimi i programit financiar të blerë "Bilanc" dhe mungesa e printimit dhe protokollimit të regjistrave kontabël përbëjnë një sërë shkeljesh që cenojnë transparencën,

kontrollin dhe besueshmërinë e të dhënave financiare. Mungesa e masave korrigjuese për implementimin e një sistemi të dedikuar, pavarësisht burimeve të shpenzuara, reflekton dobësi të menaxhimit dhe të kontrollit të brendshëm, si dhe një përdorim joefektiv të fondeve publike.

- Pasqyrat e flukseve monetare për vitet 2023 dhe 2024 nuk reflektojnë në mënyrë të plotë lëvizjet reale të fondeve, për shkak të mospërfshirjes së disa akordimeve buxhetore dhe pagesave për investime. Kjo situatë cenon saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare vjetore.
- Aktivet e njësisë të cilat në fund të vitit 2023 dhe 2024, janë në ngarkim të personave të larguar nuk janë inventarizuar duke vepruar në kundërshtim me pikën 74 të Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar. Ky veprim ndikon në krijimin e pasigurisë për ekzistencën fizike dhe gjendjen cilësore të disa aktiveve të njësisë.
- Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për planifikimin dhe miratimin e programeve vjetore të inspektimit pranë ISHTI, u konstatua se, për vitin 2024, grupit të auditimit nuk ju paraqit shkresë që vërteton se programi vjetor i inspektimeve është dërguar për miratim në MIE, në përputhje me kërkesat ligjore.
- Njësia nuk ka siguruar raportim të plotë mbi funksionimin e sistemit të MFK-së, pasi mungojnë deklarata e cilësisë dhe raporti vjetor, duke treguar për mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe transparencës institucionale.

Opinioni i përgjithshëm: Mbështetur në informacionin e disponuar në vlerësimin e funksionimit të sistemeve, realizimin e objektivave, mangësitë e konstatuara dhe të paraqitura në këtë material për periudhën e audituar, grupi i auditimit paraqet opinionin për vlerësimin e përgjithshëm të ***riskut në nivel të lartë.***
Përsa sipër, grupi i auditimit vlerëson sefunksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka qenë *jo efektiv.*

II. HYRJE

Auditimi i përputhshmërisë ka për qëllim të ndihmojë institucionin në rritjen e përgjegjshmërisë, përgjegjësisë në lidhje me administrimin e fondeve publike, veprime këto që përmirësojnë ndjeshëm transparencën, menaxhimin dhe sistemin e kontrollit të brendshëm në institucionet publike si dhe të përcaktojë nivelin e përputhshmërisë të veprimeve të njësisë publike për realizimin e objektivave, zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, rregullave të detyrueshme, standardeve, planeve dhe kontratave.

Periudha objekt auditimi: 01.01.2023 deri më 31.12.2024.

Auditimi u krye mbështetur në Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm"; Manualin për Auditimin e Brendshëm, i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar; Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Ligjin nr.10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; VKM nr.410, datë 13.05.2015 "Për krijimin, organizimin e Inspektoratit Shteteror teknik dhe Industrial"; Ligjin nr.25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Ligjin nr.9936, datë 26.06.2028

"Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik, i ndryshuar; VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; Rregulloren e brendshme të ISHTI-t, dhe akte të tjera ligjore e nënligjore, vendime e urdhëresa në fuqi.

Procedurat e kryerjes së angazhimit: Me shkresën nr.5699/3 prot., datë 25.11.2025, është dërguar Projekt Raporti i Angazhimit të Auditimit. Me shkresën nr.11796/1 prot., datë 11.12.2025 të ISHTI, janë dërguar observacionet dhe komentet mbi Projekt Raportin e Auditimit.

Auditimi u krye nga grupi i punës i përbërë nga:
Merita Gjoka, Përgjegjës Grupi.
Ardiana Alimeri, anëtar.
Kristina Deliu, anëtar.
Shkurte Halili, anëtar.

III. METODA E AUDITIMIT

Metoda e përdorur në auditim është "testimi hap pas hapi" dhe e kombinuar me metodën e ekzaminimit, për të cilën u përzgjodhën transaksione specifike brenda çdo sistemi nga fillimi deri në fund, për të vlerësuar nëse institucioni është përmbajtur procedurave të caktuara si dhe për të dhënë një gjykim profesional në lidhje me përshtatshmërinë dhe efiçencën e veprimeve të subjektit të audituar.
Teknika e përzgjedhjes në mënyrë rastësore u kombinua dhe me teknika të tjera si, shqyrtimi i dokumentave justifikues e krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimin analitik (në të gjithë sistemet e audituara sipas programit) si dhe kontrolli aritmetik (listë pagesat, përllogaritjen e pagave, faturat, ditarët analitik, etj).

Në përfundim të misionit të auditimit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, konkluzionet e nxjerra dhe vlerësimi i sistemeve të veprimtarisë, paraqiten në këtë Raport Përfundimtar.

IV. GJETJET, KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR ÇDO SISTEM

Në përfundim, grupi i auditimit pasqyron vlerësimin e sistemeve, respektivisht sipas programit të auditimit, si më poshtë vijon:

1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Veprimtaria e ISHTI është audituar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022.
Në përfundim të auditimit, është dërguar Raporti Final të Auditimit dhe plani i veprimit me rekomandimet e lëna, me shkresën nr.2695/6 datë 31.07.2023, ku janë lënë 6 rekomandime.

Evidentohet se nga ISHTI nuk është përgatitur Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna brenda periudhës 30 ditore pas dërgimit të Raportit Final të Auditimit, në kundërshtim me

nenin 12, gërma "d" të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se nga 6 rekomandime janë zbatuar 4 rekomandime dhe 2 rekomandime nuk janë zbatuar. Më poshtë po paraqesim në mënyrë të hollësishme 2 rekomandimet e pazbatuara.

Rekomandimi Nr. 1
Nuk janë marrë masat e duhura për arkëtimin e të ardhurave nga shërbimet, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:
Nga verifikimi rezulton se ISHTI nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për përmirësimin e procesit të arkëtimit të të ardhurave nga shërbimet. Në fund të vitit 2024, llogaria e debitorëve për shërbime paraqitet në vlerën 114,546,510 lekë, nga të cilat rreth 92% (105,299,162 lekë) janë detyrime të mbartura nga periudhat e mëparshme. Kjo tregon mungesë progresi real në arkëtimin e të ardhurave të prapambetura.

Nga analiza u konstatua se gjatë periudhës janë dërguar në gjykatë vetëm 8 raste, me vlerë totale 680,000 lekë, që përfaqëson një pjesë shumë të vogël të totalit të detyrimeve. Për pjesën tjetër të debitorëve nuk janë paraqitur evidenca apo dokumentacion mbështetës që të vërtetojnë ndjekjen e procedurave ligjore për rikuperimin e detyrimeve.
Kjo problematikë është trajtuar më hollësisht në vijim të këtij materiali.
Si përfundim, ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar.**

Rekomandimi Nr. 2
Të merren masat që të inventarizohen të gjitha aktivet e njësisë, përfshirë edhe aktivet të cilat kanë persona përgjegjës të larguar.

Verifikimi i zbatimit të rekomandimit:
Nga verifikimi rezulton se, megjithëse ISHTI ka kryer procesin e inventarizimit për vitet 2023 dhe 2024 me urdhrat përkatës të Kryeinspektorit, **nuk janë marrë masa për përfshirjen e të gjitha aktiveve në verifikimin fizik të tyre.**

Një pjesë e aktiveve vazhdojnë të jenë në ngarkim të 25 personave të larguar nga institucioni, për të cilët nuk është kryer kontroll sasior dhe cilësor dhe fletët kontabël përkatëse nuk janë nënshkruar nga komisioni i inventarizimit.

Kjo problematikë është trajtuar më hollësisht në vijim të materialit.

Si përfundim, ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar.**

Opinion i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Bazuar në vlerësimin e mësipërm, opinioni i përgjithshëm i auditimit është se: Sistemi i zbatimit të rekomandimeve ka funksionuar me mangësi kryesisht në respektimin e afateve për dërgimin e Planit të veprimit pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm brenda periudhës 30 ditore pas

dërgimit të Raportit Final të Auditimit si dhe në zbatimin e rekomandimeve të lëna ku nga 6 rekomandime gjithsej, katër rekomandime janë zbatuar plotësisht dhe dy janë të pazbatuar.

Për sa sipër vlerësojmë se organizimi dhe *funksionimi i kontrollit të brendshëm* për këtë sistem ka qenë *pjesërisht efektiv.* Sistemi vlerësohet me **risk të mesëm**.

2. **Sistemi i planifikimit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të buxhetit.**

Objektivi i auditimit:
Vlerësimi i rregullshmërisë së funksionimit të procedurave të planifikimit të buxhetit në përputhje me objektivat dhe nevojat e institucionit, monitorimit dhe raportimit të zbatimit të buxhetit.

- Rregullshmëria e planifikimit të fondeve buxhetore dhe mbështetja në objektivat dhe nevojat e entitetit.

Grupi i auditimit për auditimin e sistemit të programimit dhe zbatimit të buxhetit pati në konsideratë tre fazat kryesore të këtij sistemi. Pas dokumentimit të sistemit dhe vlerësimit të funksionimit të kontrolleve të vendosura për sistemin nëpërmjet testimeve të kryera rezultoi si më poshtë:

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm

Nga auditimi i procedurave të hartimit të buxhetit për periudhën e audituar, u konstatua se projekt buxheti për vitin 2023 dhe 2024, është hartuar në përputhje me ligjin organik të buxhetit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, udhëzimet përkatëse të buxhetit sipas viteve si dhe Urdhrat e Ministrit të MIE "Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeve për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe 204-2026".

Në hartimin e projekt buxhetit vjetor dhe afatmesëm, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të drejtorive dhe relacioni përmbledhës i hartuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse e cila ka bërë dhe kostimin e produkteve. Grupi i auditimit evidenton se për planifikimin e buxhetit vjetor, kryesisht është marrë si bazë realizimi i artikujve buxhetor për vitin buxhetor paraardhës.

Mbi bazën e dokumentacionit të grumbulluar, Nëpunësi Zbatues i institucionit ka plotësuar të gjitha Anekset e projekt buxhetit për programin e vetëm që menaxhohet nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial "Mbështetje për Industrinë". Këto anekse së bashku me relacionet sqaruese për zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, janë konfirmuar nga Nëpunësi Autorizues i ISHTI-t dhe i janë dërguar Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE me shkresat përkatëse sipas viteve.

Për periudhën objekt auditimi në PBA sipas viteve janë parashikuar të ardhura nga aktiviteti; përkatësisht për vitin 2023 në vlerën 211,000 mijë lekë dhe për vitin 2024 në vlerën 229,000 mijë lekë. Më hollsisht Parashikimi i të ardhurave nga aktiviteti për vitin 2023-2024 është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit.

Gjatë auditimit të procedurave të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm rezultoi se për parashikimin e të ardhurave janë marrë të dhëna kryesisht nga Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe Gazit (DINGU) si dhe të dhëna të tjera lidhur me parashikimet për gjobat, kamatvonesat dhe debitorë ndër vite.

Sa sipër, grupi i auditimit evidenton se:
Nga ISHTI parashikimi i të ardhurave për periudhën objekt auditimi është kryer i detajuar për të ardhurat që priten të realizohen nga shërbimi i kontrollit cilësor në ShA dhe në gjithë subjektet të cilat i nënshtrohen kërkesave të ligjit nr.8450, datë 24.02.1999, i ndryshuar, konkretisht:
- nëpërmjet kontrolleve cilësore me tarifë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre për subjekte tregtimi me shumicë dhe pakicë (SHA dhe SHPK).
-nëpërmjet marrjes së mostrave me pagesë parazhdoganimit në të gjitha hyrjet doganore dhe produkteve të prodhuara në vend.
Ky parashikim është evidentuar në Programin Vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Inspektimit të Naftës dhe Gazit për vitin 2023, miratuar nga titullari me shkresën nr.10335 prot, datë 15.12.2022 dhe për vitin 2024 miratuar me shkresën nr.8893 prot, datë 01.11.2023.

Të ardhurat e tjera si të ardhura nga gjobat dhe kamatvonesat, janë parashikuar bazuar në arkëtimin e tyre gjatë viteve të mëparshme.

Në përfundim grupi i auditimit vlerëson se parashikimi i të ardhurave të pritshme është argumentuar dhe mbështetur në dokumentacion justifikues.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative:

Për vitin 2023
Akordimi fillestar i buxhetit për shpenzimet korrente (Art.600,601,602 dhe 606), është dërguar me shkresën e MIE nr.861/1 prot, datë 25.01.2023, në shumën 275,267,945 lekë dhe për shpenzimet kapitale (Art.231), është dërguar me shkresën e MIE nr.1360/2 prot, datë 15.03.2023, në total në vlerën 62,950,000 lekë.

Mbi bazën e buxhetit të dërguar nga MIE është bërë detajimi i nënzërave të buxhetit të miratuar për vitin 2023.

Buxheti fillestar i miratuar nga MIE ka pësuar ndryshime me Akte Normative, shkresa të ndryshme të MIE si dhe me kërkesa nga institucioni për alokim fondesh, duke u rritur në total në vlerën 4,569,945 lekë në krahasim me planin e buxhetit të miratuar.

Ndryshimet sipas zërave paraqitet si më poshtë:
-Artikulli Buxhetor 600 "Paga" është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 203,000,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke bërë që buxheti përfundimtar i miratuar për këtë artikull të jetë në vlerën 231,630,000 lekë ose në vlerë 28,630,000 lekë më shumë se plani.
-Artikulli buxhetor 601 "Sigurime shoqërore" është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 34,000,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke bërë që buxheti përfundimtar i miratuar për këtë artikull të jetë në vlerën 39,000,000 lekë ose në vlerën 5,000,000 lekë më shumë.

Referuar testimeve të kryera rezultoi se: Planifikimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime është bërë e detajuar dhe e mbështetur në strukturën e institucionit dhe bazën ligjore në fuqi për pagat dhe sigurimet, duke respektuar tavanet e miratuara nga MIE. Kërkesat shtesë janë të argumentuara në zbatim të VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave.....", VKM 326, datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës si dhe VKM nr.834, datë 28.12.2023 "Për shpërblim për negociata me BE".

-Artikulli buxhetor 602 "Shpenzime operative" është planifikuar në PBA në vlerën 38,000,000 lekë bazuar në tavanet buxhetore të miratuara. Në planin fillestar të miratuar nga MIE shpenzimet operative janë në vlerën 38,000,000 lekë. Bazuar në kërkesat e herë pas herëshme të ISHTI-t për shtesë fondi, buxheti për këtë artikull deri në fund të vitit është miratuar në vlerën 51,000,000 lekë ose 13,000,000 lekë më shumë se plani fillestar.

Arsyet e ndryshimit janë argumentuar sipas nevojave të domosdoshme për kryerjen e aktivitetit normal të institucionit.

-Artikulli Buxhetor 606 "Fondi i Veçantë" është miratuar nga MIE me shkresën nr.1346/3 prot, datë 16.02.2023, në vlerën 267,945 lekë për 6-mujorin e parë dhe me shkresën nr. nr.7803/3, datë 25.10.2023, në shumën 651,945 lekë për 6-mujorin e dytë të vitit. Vlera totale e miratuar në fund të vitit për këtë artikull buxhetor është në shumën 919,890 lekë ose 651,945 lekë më shumë se plani fillestar.

Kërkesa për shtesë fondi është e argumentuar me listën emërore përcjellë pranë MIE për punonjësit që përfitojnë për shkak të daljes në pension dhe ndihmës për raste fatkeqësie.

-Artikulli Buxhetor 231 "Investime në proces" është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 62,950,000 lekë dhe më pas është ndryshuar gjatë vitit duke bërë që buxheti përfundimtar i miratuar në fund të vitit për këtë artikull të jetë në vlerën 20,238,000 lekë ose në vlerën 42,712,000 lekë më pak se miratimi fillestar.

Ky fond është pakësuar gjatë vitit për arsye të mosrealizimit të procedurave të prokurimit (zhvilluar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara) për Blerje aparatura të laboratorit të treguesit cilësor të naftës dhe Gazit (anulluar), Blerje të Laboratorit Lëvizës(Autolaborator (në ankimim) si dhe Blerje të Aparaturës së Laboratorit Tekstil (anulluar).

Për vitin 2024

Akordimi fillestar i buxhetit për shpenzimet korrente (Art.600,601,602), është dërguar me shkresën e MIE nr.718/1 prot, datë 24.01.2024, në total në vlerën 319,461,000 lekë dhe për shpenzimet kapitale (Art.231), është dërguar me shkresën e MIE nr. 1124/5 prot, datë 05.03.2024, në total në vlerën 57,500,000 lekë lekë.

Akordimi për shpenzime për fondin e veçantë (Art.606), është dërguar me shkresën e MIE nr.1663/3 prot, datë 08.03.2024, në vlerën 456,500 lekë.

Mbi bazën e buxhetit të dërguar nga MIE është bërë detajimi i nënzërave të buxhetit të miratuar për vitin 2024.

Buxheti fillestar i miratuar nga MIE ka pësuar ndryshime me Akte Normative, shkresa të ndryshme të MIE si dhe me kërkësa nga institucioni për alokim fondesh, duke u rritur në total në vlerën 23,000,500 lekë në krahasim me planin e buxhetit të miratuar.

Ndryshimet sipas zërave paraqiten si më poshtë:

-**Artikulli buxhetor 600 "Paga"** është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 237,966,000 lekë dhe gjatë vitit është shtuar duke bërë që vlera totale për këtë artikull të jetë në vlerën 260,566,000 lekë ose rritur në vlerë 22,600,000 lekë. Ndryshimet janë kryer në zbatim të VKM nr.421, datë 26.06.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.325, datë 31.12.2023" si dhe VKM nr.422, datë 26.06.2024 "Për pagat e punonjësve mbështetës.....".

-**Artikulli Buxhetor 601 "Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore"** është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 43,080,000 lekë dhe gjatë vitit është shtuar duke bërë që vlera totale për këtë artikull të jetë në vlerën 43,425,000 lekë ose rritur në vlerë 345,000 lekë.

-**Artikulli buxhetor 602 "Shpenzime operative"** është planifikuar në PBA në vlerën 46,915,000 lekë bazuar në tavanet buxhetore të miratuara. Në planin fillestar të miratuar nga MIE shpenzimet operative janë në vlerën 38,415,000 lekë. Bazuar në kërkesat e herë pas herëshme të ISHTI-t për shtesë fondi, buxheti për këtë artikull deri në fund të vitit është miratuar në vlerën 63,715,000 lekë ose 25,300,000 lekë më shumë se plani fillestar.

Kërkesat për këtë artikull janë argumentuar duke u bazuar në shpenzimet e detyrueshme për tu kryer gjatë vitit nga institucioni (siguracion automjetesh, sigurimi i ndërtesës, mirëmbajtje faqe Ëebi, kalibrimi i aparaturave te laboratorit, shpenzime për ujë, energji, postë, akreditimi i laboratorit, qera ambienti, qera automjetesh per inspektim, sherbim roje, etj). Gjithashtu janë parashikuar dhe shpenzime për fatura të mbetura pa likuiduar nga viti i kaluar.

-**Artikulli buxhetor 606 "Fondi i Veçantë"** është miratuar fillimisht në vlerën 456,500 lekë dhe më pas është miratuar fondi i vecantë shtësë me shkresë nr.7312/3, datë 10.10.2024, në zbatim të udhëzimit të buxhetit nr.1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024" për dheni ndihmë për fatkeqësi për 2 punonjës, shtuar në shumën 60,000 lekë.

-**Artikulli buxhetor 231 "Investime në proces"** është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 57,500,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke bërë që fondi i miratuar në fund të vitit të jetë në shumën 31,514,000 lekë duke u pakësuar në vlerë totale prej 25,986,000 lekë.

Bazuar sa sipër si dhe në testimet e kryera për funksionimin e sistemit, rezultoi se: sa i përket ndryshimeve të zërave buxhetor të ndodhura gjatë vitit ndryshimet (shtesat dhe pakësimet), janë të regjistruara e të rakorduara me Degën e Thesarit Tiranë dhe janë të raportuara periodikisht në MIE. Për çdo ndryshim të zërave të buxhetit, në shtesë apo paksim, bashkëlidhur janë shkresat e MIE për ndryshimin e buxhetit.

Për sa i përket argumentimit të kërkesave për shtesë fondi për artikujt buxhetor (600,601,602,dhe 606) rezultoi se çdo kërkesë shtesë është e argumentuar dhe e mbështetur në dokumentacion justifikues, kërkesa të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar nga MFE dhe dërguar për zbatim nga MIE në institucion.

Fondet e planifikuara, akordura dhe ndryshimet sipas zërave buxhetor, janë paraqitur më hollësisht në Projekt Raportin e auditimit.

- Realizimi i treguesve të buxhetit të miratuar për vitet 2023 dhe 2024. Analizë e shkurtër e shpenzimeve të aktivitetit sipas zërave, krahasimi i tyre me ato të programuara.

<u>Realizimi i të ardhurave për vitin 2023</u>

Për vitin 2023 të ardhurat e realizuara nga institucioni janë në shumën 211,000,000 lekë ose 15,283,180 lekë më pak se plani.

Të ardhurat nga "Taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa te ndryshme (analizat)" në krahasim me parashikimin, paraqiten me tejkalim në shumen 12,119,202 lekë. Po kështu të ardhurat e realizuara nga ky shërbim për vitin 2023, krahasuar me një vit me parë paraqitet me një rritje në shumën 450,202 lekë. Të ardhurat e planifikuara nga gjobat dhe kamatvonesat paraqiten me mosrealizim në krahasim me planin.

Realizimi i shpenzimeve 2023

Për vitin 2023, ISHTI-it i janë akorduar fonde në total në shumën 342,787,890 lekë dhe realizuar në shumën 340,736,063 lekë ose në masën 99%.

Realizimi sipas zërave paraqitet si më poshtë:

Art, 600 dhe 601 (paga+sig.shoq.) janë realizuar në shumën 270,630 mijë lekë nga 270,019 mijë lekë të programuar, me një ndryshim në vlerë absolute në shumën 611 mijë lekë ose realizuar në masën 99.7%. Fondi i pagave është planifikuar në PBA për numrin e punonjësve në strukturë 200 punonjës, realizuar në fakt 200 punonjës. Gjatë viti 2023, ka patur komunikime zyrtare ndërmjet MIE dhe ISHTI-t për fondin e pagave referuar efekte financiare si rrjedhojë e ndryshimeve ligjore për rritjen e pagave të punonjësve,

Art. 602, "Shpenzime operative" i cili është planifikuar në shumën 51 mijë lekë dhe realizuar në shumën 50 mijë lekë ose në masën 97 %. Mosrealizimi ka ardhur për arsye të mosrealizimit të procedurave të prokurimit për blerje brenda vitit 2023, pasi shtesa e fondit për këtë artikull është bërë me Akt Normativ nr.5, datë 18.10.2023, përcjellë pranë ISHTI-t me shkresë të MIE nr.8042/18, datë 09.11.2023.

Art. 606, "Shpenzime fond i veçantë" i cili është realizuar në shumën 865 mijë lekë nga 917 mijë lekë të planifikuara, me një ndryshim në vlerë apsolute në shumën 55 mijë lekë ose realizuar në masën 94%. Mosrealizimi në këtë vlerë është si rezultat i

Art. 231 "Investime", është planifikuar në shumën 20,238 mijë lekë dhe është realizuar në masën 100% të fondit të miratuar *(Blerje të aparaturës së Laboratorit Tekstil). Më hollësisht shpenzimet e planifikuara*

Realizimi i të ardhurave 2024

Për vitin 2024, të ardhurat e realizuara nga institucioni janë në shumën 195,494,258 lekë ose 33,505,742 lekë më pak se plani.

Të ardhurat e realizuara rakordojnë me të ardhurat e pasqyruar në mënyrë analitike për cdo subjekt me detyrimin përkatës, me të ardhurat e pasqyruar në Degën e Thesarit, mbështetur kjo në akt-rakordimet midis ISHTI-t dhe Degës së Thesarit Tiranë të nënshkruara midis palëve.

Të ardhurat e realizuara nga shërbimet "Taksa regjistrimi, pulle, ekzekutive dhe tarifa të ndryshme (analizat)" që zënë dhe pështën më të madhe të të ardhurave, megjithëse paraqiten më të ulta se parashikimi në vlerën 2,043,508 lekë, referuar të dhënave për faturimet ndaj të tretëve për këto shërbime, rezulton se gjatë vitit 2024 është fatururar vlera 191,616,000 lekë ose 4,616,000 lekë më shumë se planifikimi.

Për periudhën objekt auditimi, të gjitha të ardhurat e siguruara nga institucioni janë derdhur në Buxhetin e Shtetit.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2023-2024, sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit Tiranë, janë trajtuar hollësisht në Projekt Raportin e auditimit.

Realizimi i shpenzimeve 2024.

Për vitin 2024, ISHTI-it i janë akorduar fonde në total në shumën 399,961,500 lekë dhe realizuar në shumën 368,916,709 lekë ose në masën 92%.

Realizimi sipas zërave paraqitet si më poshtë:

Art, 600 dhe 601 (paga+sig.shoq.) janë realizuar në shumën 302,886 mijë lekë nga 303,991 mijë lekë të programuar, me një ndryshim në vlerë 1,104 mijë lekë ose realizuar në masën 99.6%.

Fondi i pagave është planifikuar në PBA për numrin e punonjësve në strukturë 200 punonjës, realizuar në fakt 199 punonjës. Si rezultat i ndryshimeve ligjore të pagave të disa kategorive inspektuese, nga institucioni është kërkuar shtesë në fondin e pagave për këtë kategori punonjësish. Diferenca në vlerën 1,104 mijë lekë ka ardhur nga mosplotësimi i strukturës si dhe ndryshimet efektive që kanë ndodhur në kategorinë e këtyre punonjësve si rezultat i lëvizjeve të brendshme të institucionit.

Art. 602, "Shpenzime operative" i cili është planifikuar në shumën 63,715 mijë lekë dhe realizuar në shumën 61,292 mijë lekë ose në masën 96 %.

Mosrealizimi në masën 2,422,601 leke konsiston në mosrealizimin e procedurave të prokurimit brenda vitit buxhetor, për efekt të kohës së pamjaftueshe për realizimin e tyre, pasi shtesa e fondit për artik.602 është miratuar me Aktin Normativ nr.5, datë 19.12.2024.

Art. 231 "Investime", janë planifikuar në shumën 31,514 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 4,013 mijë lekë për "*Blerje të aparaturës së Laboratorit Tekstil*" ose 27,500 mijë lekë më pak se fondi i miratuar ose në masën 13%.

Ky mosrealizim në shumën 27,500 mijë lekë, ka ardhur si rrjedhojë e anullimit të procedurës së prokurimit për *Blerje të Labioratorit Lëvizës (Autolaborator) nga* Operatori i Blerjeve të Përqëndruara (OBP).

Bazuar sa sipër si dhe në testimet e kryera për funksionimin e sistemit, rezultoi se: Situacionet e shpenzimeve mujore dhe progresive që ka kryer institucioni, janë plotësuar sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planin financiar dhe ndryshimet e kryera në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në vazhdimesi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit Tiranë. Raportimi i realizimit të buxhetit sipas pasqyrave tip është shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar ndryshimet e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023- 2024 i ndarë në shpenzime korente dhe investime dhe të krahasuara me planin, janë trajtuar hollësisht në projektraportin e auditimit.

- ***Rregullshmëria e monitorimit dhe raportimit periodik të treguesve.***

Nga auditimi i kryer, rezultoi se nga ISHT-i, janë përpiluar çdo muaj dhe në mënyrë progresive, situacionet e zbatimit të buxhetit. Këto situacione, janë përpiluar nga ana e Nëpunësit Zbatues dhe janë konfirmuar nga Nëpunësi Autorizues i ISHTI-t. Të gjitha situacionet mujore dhe progresive janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë.

Për vitin 2023, Raportet e monitorimit janë dërguar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE dhe për dijeni Drejtuesit të EMP.

Për vitin 2024, Raportet e monitorimit janë dërguar Drejtuesit të Ekipit të Menazhimit të Programit si dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, konkretisht; Për vitin 2023 me shkresën nr.1410/1 prot, datë 31.01.2024, për vitin 2024, me shkresën nr. 866/1 prot, datë 11.02.2025, Raport vjetor i monitorimit për vitin 2024 si dhe me shkresën nr.866/2 prot, datë 11.02.2025 "Relacion mbi raportin e monitorimit të buxhetit për vitin 2024".

Për periudhën objekt auditimi nuk u konstatuan parregullsi në lidhje me monitorimin e buxhetit.

Opinion i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Në përfundim të auditimit vlerësojmë se:
Për periudhën e audituar, në Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial është ngritur sistemi i kontrollit për procesin e hartimit, miratimit dhe raportimit për monitorimin e zbatimit të buxhetit në përputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjet vjetore të buxhetit dhe aktet përkatëse nënligjore.

Për sa sipër vlerësojmë se organizimi dhe *funksionimi i kontrollit të brendshëm* për këtë sistem ka qenë *efektiv*. Sistemi vlerësohet me **risk të ulët**

2. Sistemi i rregullshmërisë së transaksioneve financiare të aktivitetit.

Objektivi i auditimit:
Vlerësimi nëse janë kryer transaksionet financiare, konform ligjshmërisë per fondet buxhetore si dhe me dokumentacion mbështetës vërtetues dhe justifikues.

Rregullshmëria dhe ligjshmëria e transaksioneve financiare nëpërmjet bankës (thesarit).

Në auditimin e ushtruar për rregullshmërinë e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit për pagesat në thesar, u konstatua se pagesat e kryera nëpërmes thesarit, janë mbështetur në dokumentat justifikuese si fatura, kontrata, përmbledhëse e listë pagesave të punonjësve, etj.
Në pagesat me thesar për periudhën e audituar, rregjistrimi i veprimeve kontabël në ditar është kryer në mënyrë kronologjike dhe konform planit kontabël. Dokumentacioni është i sistemuar dhe i rregjistruar në ditarët përkatës dhe shuma e veprimeve është rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë.
Për periudhën objekt auditimi, nëpërmjet bankës janë kryer gjithsej 669 transaksione pagesash, të ndara për vitin 2023, me numër transaksionesh 354 dhe për vitin 2024 me numër transaksionesh 315.

Nga grupi i auditimit, u përdor metoda e testimit hap pas hapi dhe e ekzaminimit. U audituan me zgjedhje 40 raste, të cilat përfshijnë 71 urdhra shpenzimesh duke i përzgjedhur ato sipas vlerës së pagesës, natyrës së shpenzimit duke përfshirë kështu gjithë periudhën objekt auditimi.

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve me thesar u konstatua se transaksionet financiare të kryera nëpërmjet thesarit janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarët përkatës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat janë të nënshkruara nga nëpunësit autorizues dhe nëpunësi zbatues, të shoqëruara me dokumentacion justifikues si dhe të vulosura nga Dega e Thesarit, Tiranë.
Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Regjistrimi i transaksioneve në ditarin e bankës dhe ditarin e shpenzimeve është kryer sipas kronologjisë së veprimeve ekonomike dhe vlerat e regjistruara në llogari për çdo fund periudhe.

Kontabilizimi i veprimeve është kryer në mënyrë manuale në excel, për çdo dokument financiar dhe regjistrim kontabël janë shënuar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik dhe kontabilizimi i veprimeve është kryer në llogaritë përkatëse bazuar në planin kontabël sipas klasifikimit të shpenzimeve.

Transaksionet financiar për shpenzimet e ISHTI konsistojnë në:

-pagesa për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, tatime mbi pagë;
-pagesa për shpenzime energji elektrike, ujë, shpenzime telefonike e postare;
-pagesa për dieta brenda dhe jashtë vendit;
-pagesa për qera ambienti;
-pagesa për makina me qera;
-pagesa për vendime gjyqësore;
-pagesa për shërbimin e rojeve;
-pagesa për furnitorët për mallra dhe shërbime të kryera, etj.

Lidhur me rregullshmërinë e plotësimit dhe përpunimit të dokumentacionit të thesarit, u konstatua se pagesat e kryera janë mbështetur në dokumentet justifikuese si fatura, kontrata, përmbledhëse e listë pagesave të punonjësve, situacion punimesh, Vendime gjykate etj, konform nenit 7 të Ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Mbështetja e transaksioneve financiare me dokumetacionin urdhërues, vërtetues e justifikues (me zgjedhje në vlera).

Grupi i auditimit evidenton se pagesat e kryera janë brenda fondeve disponibël të miratuara për vitet 2023 dhe 2024, ku për të gjitha transaksionet financiare është i bashkëngjitur i gjithë dokumentacioni mbështetës justifikues të shpenzimit të kryer.
Dokumentacioni për pagesat e kryera në thesar është regjistruar me korrektësi, për çdo veprim ose ngjarje, i cili përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore.
Të gjitha transaksionet financiare janë të regjistrura në mënyrë kronologjike në ditarë e shpenzimeve dhe bankës.
Urdhër pagesat janë të përpiluara saktë dhe të plotësuara me të gjitha ekstremitetet e tyre, të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe të vulosur nga Dega e Thesarit, Tiranë.
Janë kryer rakordime periodike dhe përfundimtare me Degën e Thesarit, Tiranë të cilat përputhen me kontabilitetin e institucionit.
Grupi i auditimit vlerëson se transaksionet financiare në të gjitha rastet janë shoqëruar me dokumentacion mbështetës, vërtetues e justifikues, i cili është lidhur me praktikën e pagesës, konform Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar.
Rregullshmëria e pagesave të kryera sipas natyrës së shpenzimit është trajtuar më hollësisht në projekt raport.

Përsa sipër, grupi i auditimit lidhur me rregullshmërinë e funksionimit të sistemit të rregullshmërisë së transaksioneve financiare të aktivitetit ka konstatuar këtë gjetje:

Titulli i gjetjes: *Parregullsi në pagesat e shpenzimeve për udhëtime-dieta brenda vendit.*

Nr. i gjetjes: 1	
Subjekti i Audituar	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	ISHTI, Tiranë. MIE
Përmbledhja e bazës ligjore	-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. -Vendim Nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes:	**Situata:** Nga auditimi i rregullshmërisë së pagesave nga ISHTI rezultoi se: Për periudhën 2023-2024, ISHTI ka likuiduar, shpenzime për udhëtime - dieta për punonjësit që kanë shkuar për shërbime jashtë qendrës së punës me autorizim nga Kryeinspektori në vlerë totale 16,155,690 lekë. Grupi i auditimit përzgjodhi të auditojë dieta brenda vendit në vlerë 1,834,500 lekë. *Rezultoi se:* Për të gjitha rastet e dërgimin me shërbim të punonjësit në një largësi deri në 100 km jashtë qendrës së punës autorizimi është kryer nga Kryeinspektori konform përcaktimeve të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar, Kreu V, pika 1, ku citohet se: *"Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: 1. Titullari i njësisë shpenzuese për shërbimet me largësi deri në 100 km jashtë qendrës së punës."* Ndërsa për dërgimin me shërbim të punonjësve në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës, nuk është marrë miratim nga Titullari i Institucionit Qendror (Ministri), vepruar në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar, Kreu V, pika 2.a.i, ku citohet se: *"Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga:....Titullari i institucionit qendror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij. Titullarë institucioni qendror, në kuptim të këtij vendimi, janë: a) Për njësitë e qeverisjes qendrore: i) për ministrinë dhe çdo institucion në varësi të saj, ministri ose i deleguari i tij."* Për sa sipër, grupi i auditimit vlerëson se:

	-Miratimi dhe likuidimi i pagesave për shpenzime për udhëtim-dieta në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës është kryer pa Autorizim nga Titullari i institucionit qendror (Ministri) ose i personi i autorizuar prej tij. **Kriteri:** -Kreu V, pika 2.a.i e VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar. -neni 4, pika 9,17,18; neni 8, pika 5; neni 12, pika 3, germa a), germa e); neni 13; neni 14 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. **Ndikimi/efekti:** Moszbatimi korrekt i dispozitës ligjore ka sjellë si pasojë tejkalim kompetencash dhe shkelje të disiplinës financiare. **Shkaku:** Mosfunksionim i elementëve të sistemit të kontrollit të brendshëm.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë.
Konkluzioni:	Për periudhën e audituar, janë krye shpenzime për udhëtime dhe dieta brenda vendit, për distanca mbi 100 km larg nga qendra e punës, pa pasur miratimin e Titullarit të institucionit qëndror apo të përfaqësuesit të deleguar prej tij. Kjo praktikë bie me kriteret e përcaktuara në VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar.
Rekomandimi:	Në kuadër të miratimit të programit vjetor të inspektimeve të merren masa që të sigurohet dhe autorizimi apo miratimi përkatës në MIE për dërgimin me shërbim të punonësve për distanca mbi 100 km larg nga qendra e punës, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit", i ndryshuar.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	*Brenda muajit Janar 2026.*
Statusi i rekomandimit	*I observuar nga subjekti dhe i pa pranuar nga grupi i auditimit.*

Opinion i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:

Për sistemin e veprimeve dhe operacioneve me likuiditetet, ligjshmërisë, rregullshmërisë së firmosjes të dokumentacionit urdhërues për kryerjen e tyre, bazuar në dokumentacion vërtetues e justifikues, grupi i auditimit vlerëson se ka funksionuar me të meta në likuidimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit pa dokumentacion mbështetës justifikues. Sistemi vlerësohet me ***risk të lartë.***

Për sa sipër, grupi i auditimit vlerëson se funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm *ka qenë jo efektiv.*

3. Sistemi i pagesave për pagat e punonjësve.

Objektivi i auditimit:
Vlerësimi mbi respektimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë për pagesat e pagave të punonjësve dhe perfitimet e tjera mbi pagat.

- Realizimi i pagesave në përputhje me vendin e punës dhe strukturën e miratuar.
Për periudhën objekt auditimi në ISHTI struktura organike është e miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 105, datë 13.8.2020 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së ISHTI", i ndryshuar, struktura është miratuar me 200 punonjës. Kjo strukturë ka pësuar ndryshime me Urdhër të Kryeministrit nr. 136, datë 26.09.2023 "Një ndryshim në Urdhrin nr.105, datë 13.8.2020, dhe nr. 62, datë 19.04.2024, struktura është miratuar me 199 punonjës.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit mbështetës rregullohen në bazë të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Në zbatim të këtij Ligji Titullari i ISHTI me Urdhër nr.02, datë 23.02.2022, protokolluar me nr.1664, datë 23.02.2022, ka miratuar procedurën e rekrutimit, punësimit dhe largimit nga detyra të punonjësve në Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Për periudhën objekt auditimi ka pasur 69 emërime të reja, 84 raste largimi nga puna dhe 148 raste të lëvizje të brendshme në ISHTI. Më hollësisht është trajtuar në fund të kësaj pikë të projektit.

- Mbështetja e pagesave të kryera me dokumentacionin vërtetues justifikues të prezencës në punë.
Nga auditimi i respektimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë për pagesat e punonjësve u konstatua se është zbatuar korrekt në Lidhje nr. 6 të VKM Nr. 187, datë 8.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve në Kryeministri ...", i ndryshuar me VKM nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve në Kryeministri ...", Lidhja nr.10.

Për punonjësit me klasa në VKM nr.202, datë 15.03.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.717, datë 23.06.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucione buxhetore", i ndryshuar me VKM nr.326, datë 31.05.2023.

Nga auditimi mbi emërimet dhe përputhjen e nivelit të diplomave me kërkesat e vendit të punës, pages së miratuar konstatohet se, janë respektuar kërkesat e VKM-ve të mësipërme në lidhje me llogaritjen e të gjitha elementëve të pages së miratuar, duke përfshirë edhe nivelin e diplomës, saktësi në përcaktimin e vjetërsisë në punë të punonjësit dhe për rrjedhojë saktësi në llogaritjen e shtesës për vjetërsi në punë

U konstatua se, listëpagesat nuk janë të nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njërëzore, sipas përcaktimeve të pikës 69 të paragrafit III- të "Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, të ndryshuar.

Në lidhje me evidentimin e pjesëmarrjes në punë, saktësinë e përllogaritjes së elementëve të pagës, zbritjet/ndalesat mbi page dhe derdhja e tyre në llogari, u audituа me zgjedhje dokumentacioni për

muajt Tetor, Nëntor 2023; Mars, Prill, Maj, Qershor 2024. Pagat dhe listepagesat janë bërë në programin kompjuterik excel.

Derdhja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, në të gjitha listë pagesat e punonjësve që u përzgjodhën për periudhën objekt auditimi, u konstatua se është respektuar kufiri minimal dhe maksimal si dhe përllogaritja dhe ndalesat si për detyrimet që ka punëdhënësi ndaj organeve të sig. shoqërore shëndetësore dhe ato që ka punëmarrësi, si dhe dhe përllogaritja dhe ndalesat të tatimin mbi të ardhurat. Për çdo muaj detyrimet tatimore dhe sigurimeve shoqërore shëndetësore janë raportuar saktësisht dhe brenda afateve ligjore pranë institucioneve përkatëse.

Sa më sipër u konstatua se:
-Listëpagesat e punonjësve që shërbejnë për pagesë, janë hartuar me të gjithë elementët e nevojshëm (të punësuarit, emërtesa sipas strukturës, ditë pune, kategoria/klasa, paga e grupit, paga për funksion, raportet, shtesat pagës për vjetësi në punë, shtesat për vështirësi, ndalesat për tatim page, sig. shoqërore, shëndetësore, etj). Listëpagesat janë mbështetur në listëprezencat mujore dhe në asnjë rast nuk rezulton të ketë mospërputhje. Pagesat e punonjësve bëheshin çdo muaj mbi bazën e kohëshënuesit i shoqëruar rast pas rasti me shkresat për lejet vjetore, me raporte për paaftësi të përkohshme në punë etj, për emërime të reja, për lëvizje nga një pozicion pune në tjetrin, etj.
-Pagesat e kryera rakordohen me pagesat e paraqitura në sistemin e llogarisë (librin e përgjithshëm të llogarive) dhe janë pasqyruar në rregjistrin e pagave, i cili mbahet në mënyrë elektronike dhe i printuar;
-Çdo punonjës ka numrin e tij të identifikimit;
-Në listë pagesat që u përzgjodhën për auditim janë përllogaritur, ndaluar dhe xhiruar, detyrimet për tatimet mbi të ardhurat personale si dhe kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore, për të cilat janë mbajtur, periodikisht, akt rakordimet përkatëse.
-Listëpagesat nuk janë të nënshkruar sipas përcaktimeve të pikës 69, të paragrafit III- të "Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, pasi nuk janë kontrolluar dhe nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njërëzore.
-Derdhja e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, në të gjitha listë pagesat e punonjësve që u përzgjodhën është respektuar kufiri minimal dhe maksimal për detyrimet tatimore dhe sigurimeve shoqërore shëndetësore.

- ***Rregullshmëria e pagesave për trajtime të vecanta dhe ndihma për punonjësit, dokumentacioni mbështetës.***

Për periudhën objekt auditimi fondi i veçantë është akorduar nga MIE në vlerën totale 1,661,322 lekë.
Për vitin 2023, fondi i vecantë i përdorur është në vlerë 864,758 lekë nga 919,890 lekë të planifikuar, të cilat janë paguar 7 raste për dalje në pension dhe 1 rast fakteqësie.
Për vitin 2024, fondi i veçantë i përdorur është në vlerë 724,572 lekë nga 741,500 lekë dhe është përdorur për 6 raste nga të cilat: 4 raste për dalje në pension në vlerë 664,572 lekë, 2 rast fatkeqësie në vlerë 60,000 lekë.

Për sa më sipër, në të gjitha rastet masa e shpërblimit nga fondi i vecantë është dhënë sipas VKM nr.929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë" i ndryshuar dhe pika 55-

62 të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1, datë 17.01.2019 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019*", i ndryshuar.

Për sa sipër Grupi i auditimit lidhur me rregullshmërinë e funksionimit të sistemit të pagesave për pagat e punonjësve ka konstatuar këto gjetje:

Titulli i Gjetjes: *Mosrespektimi i procedurave gjatë punësimit të punonjësve të rinj.*

Nr. i gjetjes: 2	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse; ISHTI.
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	ISHTI, Tiranë. MIE.
Përmbledhja e bazës ligjore	-Rregullorja e Brendshme e ISHTI të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s nr.288, datë 13.10.2020. -Rregullorja e Brendshme e ISHTI të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s nr.297, datë 25.11.2024. -Urdhër i Kryeinspektori Nr.02, datë 23.02.2022 "Për miratimin e procedurës se rekrutimit, punësimit, dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI".
Përshkrimi i gjetjes:	**Situata:** Për periudhën objekt auditimi ka pasur 69 emërime të reja, të analizuar si më poshtë:

Emërime të reja	**Viti 2023**	**Viti 2024**
Emërime me procedurë	28	18
Emërime pa procedurë	1	22
Totali	**29**	**40**

(të dhënat janë marrë nga Drejtoria e B.Nj.SH.M)

Nga auditimi i procesit të rekrutimit të punonjësve të rinj për periudhën objekt auditimi, u konstatua se:

- Për 46 raste, procedurat e emërimit janë kryer në përputhje me Urdhrin nr. 02, datë 23.02.2022 të Kryeinspektorit, "Për miratimin e procedurës së rekrutimit, punësimit dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI", si dhe në përputhje me dispozitat e Rregullores së Brendshme.
- Ndërsa për 23 raste të tjera, emërimet janë kryer pa ndjekur procedurat e përcaktuara në urdhrin dhe rregulloren në fjalë.

Grupi i auditimit zgjodhi në mënyrë rastësore një rast rekrutimi për pozicionin "Përgjegjës në Sektorin e Trajtimit të Aksidenteve" në Drejtorinë e TAM. Më datë 24.04.2024, Komisioni i Vlerësimit dhe Kryeinspektori shpallën fituesin për këtë pozicion dhe plotësuan formularin përkatës të vlerësimit të kandidatëve. Po në të njëjtën datë, me shkresën nr. 6134 prot., datë 24.02.2024 u nxor urdhri i Kryeinspektorit

	për emërimin e z. J.P. në këtë detyrë. Pas emërimit, janë lidhur kontratat përkatëse: fillimisht një kontratë individuale pune 3-mujore (si periudhë prove) me nr. 6134/1 prot., datë 25.04.2024, dhe më pas aneks-kontrata me afat të pacaktuar me nr. 6134/2 prot., datë 25.07.2024. E njëjta procedurë është ndjekur edhe në 22 raste të tjera të emërimeve pa ndjekur procedurat e rregullta të rekrutimit sipas Urdhërit të Kryeinspektorit Nr.02, datë 23.02.2022. Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument që të argumentojë arsyet përse në këto 23 raste nuk është zbatuar procedura e miratuar me Urdhër të Kryeinspektorit nr. 02, datë 23.02.2022 si dhe Regullores së Brendshme të ISHTI të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s nr.288, datë 13.10.2020, **neni 5** "Kryeinspektori", **pika 9**, ku citohet se: *"bashkepunon për përgatitjen e strukturës e të organikës, si dhe për ndryshimet përkatëse të tyre, që i propozohet ministrit për tu miratuar nga Kryeminitri. Emëron dhe shkarkon personelin nëpërputhje me ligjin e zbatuar për rekrutimin në ISHTI."*, të ndryshuar me Rregulloren e Brendshme të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s nr.297, datë 25.11.2024, **neni 20, pika 1**, ku citohet se: *"Rekrutimi, punësimi dhe largimi nga detyra i punonjësve të ISHTI-t bëhen në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi në fushën e marrëdhënieve të punës, si dhe sipas procedurave të miratuara me urdhër të Kryeinspektorit."* Në përfundim, rezulton se mënyra e ndjekur nga ISHTI për rekrutimin e këtyre punonjësve nuk ka qenë transparente dhe nuk ka respektuar kuadrin rregullator të brendshëm në fuqi. **Kriteri:** -Neni 5, pika 9 e Rregullores së Brendshme të ISHTI të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s nr.288, datë 13.10.2020. -Neni 20, pika 1 e Rregullores së Brendshme e ISHTI të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s nr.297, datë 25.11.2024. -Urdhër i Kryeinspektori Nr.02, datë 23.02.2022 "Për miratimin e procedurës se rekrutimit, punësimit, dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI". **Ndikimi/efekti:** Mosrespektimi i procedurës ligjore për emërim sjell pasiguri dhe mungesë transparence në rekrutim. **Shkaku:** Mosfunksionim i elementëve të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë.
Konkluzioni:	Në periudhën e auditimit, për 23 raste procesi i rekrutimit të punonjësve nuk është zhvilluar në përputhje me procedurat e brendshme të miratuara, si Urdhërin e Kryeinspektorit Nr.02, datë 23.02.2022 "Për miratimin e procedurës se rekrutimit, punësimit, dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI" dhe rregulloren e Brendshme të ISHTI-t.
Rekomandimi:	Nga Kryeinspektori të ndërmarren masat e menjëhershme për ndërprerjen e procesit të rekrutimit pa procedurë. Të rivlerësohen të gjitha emërimet në përputhje me kriteret e miratuara të punësimit. për të siguruar kompletimin e strukturës me staf profesional dhe të kualifikuar.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	*Brenda muajit Mars 2026.*
Statusi i rekomandimit	*I observuar nga subjekti dhe i pa pranuar nga grupi i auditimit.*

Titulli i Gjetjes: *Rregullshmëria e lëvizjeve të brendshme dhe largimi i punonjësve.*

Nr. i gjetjes: 3	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse; ISHTI.
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	ISHTI, Tiranë. MIE.
Përmbledhja e bazës ligjore	-Rregullorja e Brendshme e ISHTI të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s nr.297, datë 25.11.2024. -Urdhër i Kryeinspektori Nr.02, datë 23.02.2022 "Për miratimin e procedurës se rekrutimit, punësimit, dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI".
Përshkrimi i gjetjes:	**Situata:** Për periudhën objekt auditimi ka pasur lëvizje të brendshme dhe largime stafi 232 raste, të analizuar si më poshtë:

• **Lëvizje e Brendshme**	**Viti 2023**	**Viti 2024**
Lëvizjet brenda institucionit	56	52
Lëvizje brenda institucinint nga ristrukturimi	-	40
Totali	**56**	**92**

• **Largimet**	**Viti 2023**	**Viti 2024**
Lirim nga detyra	8	16
Dorëheqje me kërkesë	23	18
Dalje në pension	7	4
Largim nga ristrukturimi		7

Ndarje nga jeta	1	-
Totali	**39**	**45**

Për periudhën objekt auditimi rezultoi se:
Në ISHTI ka pasur 148 lëvizje të brendshme.
Grupi i auditimit përzgjodhi të auditojë 2 dosje personeli të lëvizje të brendshme znj.E.J dhe Z.E.Sh.

- Znj.E.J ka filluar punë për herë të parë në ISHTI me Urdhër emërimi të Kryeinspektorit nr.2822 prot., datë 21.02.2024 në pozicionin Inspektor në Sektorin e Rajonit Jugor-Fier, Vlorë, Berat dhe Gjirokastër në Drejtorinë e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre.
Më shkresën nr.4341 prot., datë 20.03.2024 me Urdhër të Kryeinspektorit është liruar nga detyra Inspektor në Sektorin e Rajonit Jugor-Fier, Vlorë, Berat dhe Gjirokastër në Drejtorinë e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre dhe është emëruar në Drejtorinë e Laboratorit Qendror, pranë ISHTI.
- Z.E.Sh ka filluar punë për herë të parë në ISHTI me Urdhër emërimi të Kryeinspektorit nr.292 prot., datë 15.01.2020 në pozicionin specialist në sektorin e prokurimeve dhe shërbimeve të brendshme, në drejtorinë e BNJSHB.
Ky pozicion është mbajtur prej datës së emërimit deri më 01.03.2024, kur me Urdhrin nr. 3321 prot., të Kryeinspektorit është liruar nga kjo detyrë dhe është emëruar në pozicionin "Inspektor" pranë Sektorit të Rajonit Verior – Shkodër, Lezhë, Kukës dhe Dibër, në Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre.
Vetëm pak ditë më vonë, me me urdhër të Kryeinspektorit nr.4393 prot., datë 21.03.2024, ai është rikthyer në pozicionin e mëparshëm si Specialist në Sektorin e Prokurimeve dhe Shërbimeve të Brendshme në DBNJSHB.
E njëjta procedurë është ndjekur edhe për rastet e tjera të lëvizjeve të brendshme.

Për këto ndryshime grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokument që justifikon arsyet apo nevojën për lëvizje.
Gjithashtu, mungon një vlerësim i strukturuar mbi përputhshmërinë e punonjësve me pozicionet e reja të punës, duke mos u marrë në konsideratë përgatitja profesionale dhe kualifikimet e tyre.
Lëvizjet janë kryer në mënyrë të shpeshtë dhe të paarsyetuar, në disa raste brenda një harku kohor shumë të shkurtër (madje edhe dy herë brenda muajit).

	Kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me ISHTI, gjithsej 84 punonjës, përkatësisht: -Plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë 11 punonjës, -Kërkesë për dorëheqje 41 punonjës, -Ndarë nga jeta 1 punonjës -Largim nga ristrukturimi 7 punonjës, nga të cilët 4 punonjës janë rikthyer në pune. Nga 3 punonjësit e larguar 2 nga këto punonjës kanë hapur proces gjyqësor ndaj ISHTI. -Lirim nga detyra 24 punonjës, nga të cilët 13 punonjës kanë hapur proces gjyqësor ndaj ISHTI. Grupi i auditimit shqyrtoi, në mënyrë përzgjedhore, një dosje të punonjësve të larguar për shkak të procesit të ristrukturimit në ISHTI. Konkretisht, u analizua dosja e Z. F.K., i cili ka mbajtur më parë pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Mbikëqyrjes dhe Ekspertizës Teknike në Drejtorinë e Inspektimit të Instalimeve Elektrike dhe Makinerive Ngritëse (DIPIEMN). Më datë 23.04.2024, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme i ka dërguar një njoftim me e-mail punonjësit Z.F.K, duke e informuar se, për shkak të ristrukturimit, i propozohej ndryshimi i pozicionit në "Inspektor" në Sektorin e Trajtimit të Aksidenteve, në Drejtorinë e Trajtimit të Aksidenteve dhe Mbikëqyrjes. Më datë 24.04.2024, punonjësi është shprehur me e-mail se nuk e pranonte propozimin, duke theksuar ndër të tjera, se: Ka një eksperiencë mbi 30 vjet në profesion, më shumë se çdo punonjës aktual i DIPIEMN; Propozimi përfshinte ulje të konsiderueshme në pagë, çka do të sillte vështirësi financiare për familjen, pasi kishte fëmijë në proces shkollimi; Ndryshimi përbënte ulje në detyrë dhe nuk i përputhej përvojës e kualifikimeve të tij. Më datë 25.04.2024, me shkresën nr. 6353 prot., punonjësi është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si pasojë e riorganizimit të institucionit dhe shkurtimit të pozicionit të punës që ai mbante. Po në datën 25.04.2024, me shkresën nr. 6353/1 prot., ai është liruar zyrtarisht nga detyra. Aktualisht, largimi nga puna është duke u ndjekur në rrugë gjyqësore nga punonjësi. Në lidhje me largimet e stafit për shkak të ristrukturimit, nuk janë paraqitur dokumente që të argumentojnë arsyet e ndryshimeve dhe nuk është evidentuar një proces transparent i përshtatjes së stafit me pozicionet e reja.

	Gjatë periudhës objekt auditimi, në kuadër të procesit të ristrukturimit në ISHTI, janë larguar nga puna 7 punonjës, nga të cilët: - 4 punonjës janë rikthyer në punë - 3 punonjës mbeten të larguar, nga të cilët 2 kanë iniciuar procese gjyqësore kundër ISHTI. Nga të dhënat e marra, rezulton se gjatë kësaj periudhe ISHTI ka paguar vendime gjyqësore në favor të punonjësve në një shumë totale prej 4,039,798 lekë, që i përket 3 punonjësve të tjerë, të cilët kanë fituar çështje gjyqësore për largim të padrejtë apo të parregullt nga puna. Në rast të fitimit të çështjeve gjyqësore nga punonjësit që aktualisht ndjekin proceset ndaj ISHTI, institucionit do t'i nevojiten fonde shtesë për dëmshpërblime, si dhe do të krijojë vështirësi në mbulimin e shpenzimeve buxhetore. *Lirim nga detyra* 24 punonjës, nga të cilët 11 punonjës kanë hapur proces gjyqësor ndaj ISHTI. Lirimet nga detyra janë bërë pa procedurë thjeshtë me urdhët të Kryeinspektorit. Grupi i auditimit përzgjodhi të auditojë 1 dosje të punonjësve të larguar nga detyra, konkretisht dosjen e Z.I.V. Z.I.V është me detyrë përgjegjës në Sektorin e Rajonit Verior-Shkodër, Lezhë, Kukës dhe Dibër në Drejtorinë e Inspektimit të Paisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe Makineritë Ngritëse. Me Urdhër nr.11082 prot., datë 22.12.2023 është transferuar nga pozicioni i mëparshëm në një pozicion tjetër si inspektor në Sektorin e Rajonit Qëndror-Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korcë në të njëjtën drejtori. Me urdhrin nr. 11082, datë 22.12.2023, është transferuar nga pozicioni i mëparshëm në një pozicion tjetër si inspektor në rajonin qëndror. Më datë 22.12.2023 u njoftua me e-mail dhe iu kërkua paraqitja për firmosje kontrate më datë 26.12.2023 pranë Zyrës së B.Njerëzore. Punonjësi nuk e ka firmosur kontratën. Më pas, me urdhrin të Kryeinspektorit nr. 969, datë 22.01.2024, është liruar nga detyra nga Kryeinspektori. Ky punonjës është duke e ndjekur në rrugë gjyqësore largimin nga puna. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për rastet e tjera të lirimit nga detyra. Edhe për këtë punonjës grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokument që të argumentojë arsyjen e lëvizjes apo largimin nga puna të këtij punonjësi.

	Në 13 raste, punonjësit e larguar kanë iniciuar procese gjyqësore kundër ISHTI-së. Gjithashtu, largimet nga detyra janë kryer pa ndjekur procedura të qarta dhe pa dokumentacion të plotë. Lirimi është bërë me urdhër të drejtpërdrejtë të Kryeinspektorit. Për sa sipër vërehet mungesë e një sistemi të mirëfilltë menaxhimi të lëvizjeve të stafit dhe largimeve, mungesën e transparencës dhe dokumentacionit përkatës, si dhe vepruar në kundërshtim me Urdhrin nr. 02, datë 23.02.2022 të Kryeinspektorit si dhe neni 20, pika 1 dhe 3 të Rregullores së Brendshme, i cili përcakton se: *1. "Rekrutimi, punësimi dhe largimi nga detyra i punonjësve të ISHTI-t bëhen në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi në fushën e marrëdhënieve të punës, si dhe sipas procedurave të miratuara me urdhër të Kryeinspektorit."* *3. "Vlerësimi i përmbushjes së kritereve dhe aftësive profesionale të kandidatëve bëhet në përputhje me procedurën e miratuar nga Kryeinspektori."* Në përfundim, rezulton se mënyra e ndjekur nga ISHTI për lëvizjen e stafit dhe lirimin nga detyra nuk ka një procedurë që duhet ndjekur pasi këto raste nuk janë parashikuar as në urdhërin e Kryeinspektorit nr. 02, datë 23.02.2022, si dhe në rregulloren e brendshme. **Kriteri:** -Neni 20, pika 1 dhe 3 të Rregullores së Brendshme e ISHTI të miratuar me Urdhër të Ministrit të MIE-s nr.297, datë 25.11.2024. -Urdhër i Kryeinspektori Nr.02, datë 23.02.2022 "Për miratimin e procedurës se rekrutimit, punësimit, dhe largimit nga detyra të punonjësve në ISHTI". **Ndikimi/efekti:** Lëvizjet dhe largimet e pa argumentuara krijojnë pasiguri, frikë për vendin e punës, dhe demotivim të punonjësve. **Shkaku:** Mosfunksionim i elementëve të sistemit të kontrollit të brendshëm duke cuar në mungesë transparencë dhe mosrespektimi i procedurave ligjore.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë.
Konkluzioni:	Nga shqyrtimi i praktikave të ndjekura për lëvizjet e brendshme dhe largimet nga puna në ISHTI, rezulton se: Për periudhën objekt auditimi nga 199 punonjës që është struktura e miratuar, janë kryer lëvizje të brendshme në vendet e punës për 148 punonjës. Ndërsa kanë përfunduar marrëdhëniet e punës me ISHTI gjithsej 84 punonjës, nga të cilët 41 punonjës kanë dhënë dorëheqjen dhe 31 punonjës janë larguar nga detyra. Nga të

	larguarit 4 janë rikthyer dhe 13 të tjetër kanë hapur proces gjyqësor. Këto veprime janë kryer në mungesë të një procesi të dokumentuar dhe pa respektuar procedurat ligjore dhe rregulloren e brendshme. Kjo ka sjellë pasiguri në punë dhe rritje të numrit të padive gjyqësore për rrjedhojë duke ekspozuar ISHTI-n ndaj rritjes së shpenzimeve të personelit për një vend pune.
Rekomandimi:	Kryeinspektori të ndërmarrë masat e nevojshme për përmirësimin e punës për dokumentimin e veprimeve për menaxhimin e lëvizjeve të brendshme dhe largimeve nga puna, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të brendshëm, si dhe të forcojë kontrollin e brendshëm përmes ndjekjes së rregullt të praktikave të burimeve njerëzore, për të siguruar transparencë dhe shmangie të risqeve të niveli të lartë për ekspozimin e ISHTI ndaj proceseve gjyqësore, si dhe pasigurise se krijuar në përbushjen e objektivave, nga lëvizja e shpeshtë dhe e padokumentuar e personelit.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	*Brenda muajit Mars 2026.*
Statusi i rekomandimit	*I observuar nga subjekti dhe i pa pranuar nga grupi i auditimit.*

Titulli i Gjetjes: *Rregullshmëria e nënshkrimit të listë pagesave.*

Nr. i gjetjes: 4	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbështetëse; ISHTI.
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	ISHTI, Tiranë. MIE
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar,
Përshkrimi i gjetjes:	**Situata:** Listëpagesat nuk janë të nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njërëzore, sipas përcaktimeve të pikës 69 të paragrafit III- të "Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, ku citohet se: "*Listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listëprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij……*"..

	Kriteri: Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, Paragrafi III, pika 69. **Ndikimi/efekti:** Krijon risk në realizimin e një pagese të parregullt. **Shkaku:** Mosnjohje e dispozitës ligjore dhe mos funksionim i kontrollit të brendshëm.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm.
Konkluzioni:	Nuk ka funksionuar kontrolli i brendshëm për procesin e dokumentimit të punës së pagave. Kjo për faktin se listëpagesat nuk janë kontrolluar dhe nënshkruar nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore.
Rekomandimi:	Të merren masat e duhura për përmirësimin e punës nga Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve te Brendshme, në drejtim të dokumentimit të kontrollit të listëpagesave, në respektim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar, Paragrafi III, pika 69.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	*Menjëherë dhe në vijimësi.*
Statusi i rekomandimit	*Pranuar nga subjekti.*

Titulli i Gjetjes: *Mospërputhje në harmonizimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon funksionimin e ISHTI-së.*

Nr. i gjetjes: 5	
Subjekti i Audituar	ISHTI.
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	ISHTI, Tiranë. MIE
Përmbledhja e bazës ligjore	VKM Nr.410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"; Ligji nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr.99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".
Përshkrimi i gjetjes:	**Situata:** Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është krijuar me VKM nr.410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", i cili është institucion publik buxhetor në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në Kreun III, pika 7 të kësaj VKM-je përcaktohet se: "*Struktura dhe organika e ISHTI-së miratohen me urdhër të Kryeministrit. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të ISHTI-së rregullohen sipas ligjit të nëpunësit civil.*" Në përputhje me Ligjin nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", neni 20, pika 1, përcaktohet se: "*Marrëdhëniet e punësimit të inspektorëve në*

	inspektoratet shtetërore dhe vendore rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësit civilë për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Kryeinspektori i inspektoratit përkatës është "eprori i drejtpërdrejtë" i inspektorëve, në kuptimin e këtyre dispozitave". Por, pas ndryshimit të këtij ligji me Ligjin nr.99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", në nenin 20, pika 1, thuhet se: *"Marrëdhëniet e punësimit për punonjësit e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe të inspektorateve qendrore rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij".* Sa sipër, kuadri ekzistues ligjor dhe nënligjor që rregullon organizimin dhe funksionimin e ISHTI-së nuk është përshtatur me kërkesat dhe ndryshimet e përcaktuara në Ligjin nr. 99/2024, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë". **Kriteri:** -KREU III, pika 7 e VKM Nr.410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial"; -Neni 20, pika 1 e Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligjin nr.99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë". **Ndikimi/efekti:** Krijon rrezik për interpretim të gabuar të statusit të punonjësve të ISHTI-së nëse janë nëpunës civilë apo punonjës sipas Kodit të Punës. **Shkaku:** Mungesë e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe koordinimit ndërmjet ISHTI-së dhe Ministrisë për përshtatjen e akteve nënligjore.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë.
Konkluzioni:	Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e ISHTI-së nuk është ende i harmonizuar me ndryshimet e parashikuara në Ligjin nr.99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Në aktet nënligjore ekzistuese, marrëdhëniet e punës rregullohen në përputhje me Ligjin "Për nëpunësin civil", ndërkohë që ligji i ri përcakton se këto marrëdhënie duhet të bazohen në dispozitat e Kodit të Punës. Kjo mospërputhje krijon pasiguri ligjore dhe rrezikon cenimin e ligjshmërisë në administrimin e marrëdhënieve të punës.
Rekomandimi:	Të ndërmerren veprimet e nevojshme për rishikimin dhe harmonizimin e akteve nënligjore që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet e punës në ISHTI me dispozitat

	e Ligjit nr.99/2024, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", me qëllim sigurimin e përputhshmërisë ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në veprimtarinë e ISHTI,
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	*Menjëherë.*
Statusi i rekomandimit	*I pranuar nga subjekti.*

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Për sistemin e pagesave për pagat e punonjësve grupi i auditimit vlerëson se organizimi dhe funksionimi i elementëve të kontrollit të brendshëm kanë funksionuar me të meta, në drejtim të përputhjes së kuadri ekzistues ligjor dhe nënligjor që rregullon organizimin dhe funksionimin e ISHTI-së, procesit të rekrutimit, lëvizjeve të stafit dhe largimet nga detyra, nënshkrimit të listëpagesave:

Sa sipër, vlerësojmë se organizimi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm për këtë sistem ka qenë jo efektiv, sistemi ***vlerësohet me Risk të lartë.***

5. Rregullshmëria e sistemit të procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore dhe monitorimi i kontratave të nenshkruara.

Objektivi i auditimit
Vlerësimi i funksionimit të sistemit të realizimit të procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore, mbështetur në aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.

Auditimi i procedurave për mallra dhe shërbime, për periudhën objekt auditimi u krye në bazë të kërkesave të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe Udhzimeve të APP.
Titullari i Autoritetit Konkraktor, çdo fillim viti ka caktuar administratorin e sistemit të prokurimeve publike për ISHTI, përkatësisht: për vitin 2023 me Urdhër nr.3, datë 12.01.2023 dhe për vitin 2024 me Urdhër nr. 03, datë 03.01.2024.
Për periudhën objekt auditimi, regjistrat e prokurimeve janë hartuar dhe publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.4, datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik". Këto regjistra janë dërguar në MIE, Degën e Thesarit, Tiranë dhe në APP me shkresë sipas viteve.

a) Rregullshmëria e procedurave të kryera për prokurimin e fondeve, për blerjet me vlera më të mëdha se 1,000,000 lekë.
Për periudhën objekt auditimi ISHTI ka realizuar gjithsej 37 procedura prokurimi, ku nga këto 3 procedura janë me vlerë mbi 1,000,000 lekë. Grupi i auditimit përzgjodhi 1 procedurë prokurimi për të audituar, duke u bazuar në vlerën e saj dhe tipin e kontratës
-Nga auditimi i dosjes së procedurës së përzgjedhur në drejtim të rregullshmërisë së përpilimit të dokumenteve të tenderit, procedurës së zgjedhur dhe realizimit të saj sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi rezulton se:

-Në Dokumentet standarde të tenderit nuk rezultoi mangësi në drejtim të informacionit të përgjithshëm dhe atij specifik që ka lidhje me objektin e kontratës si dhe llojin e procedurës së zgjedhur sipas kufirit monetar të lejuar.
-Njësia e prokurimit ka hartuar dokumentacionin e tenderit në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi.
-Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Komisioni i ngritur me urdhër nga titullari sipas objektit të prokurimit.
-Dokumentacioni i procedurës së prokurimit është konfirmuar nga të gjithë anëtarët e Njësisë së Prokurimit sipas procesverbaleve të mbajtura për këtë qëllim dhe është miratuar nga Titullari.
Sipas fondit të vënë në dispozicion dhe kufirit monetar është përcaktuar procedura e prokurimit konform VKM-s nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Më hollësisht zhvillimi i procedurës së prokurimit është paraqitur në Projekt Raportin e Auditimit.

Sa sipër vlerësojmë se, në institucion është ngritur dhe ka funksionuar sistemi i procedurave të prokurimeve publike, me vlerë më të madhe se 1,000.000 lekë.

b) Rregullshmëria e procedurave të kryera për prokurimin e fondeve, për blerjet me vlera të vogla.
Prokurimi i fondeve për mallra dhe shërbime kryhet me burim financimi nga fondet e buxhetit të shtetit. Referuar regjistrave të realizimit të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi rezultoi se nga ISHTi janë realizuar gjithsej 34 procedura prokurimi me vlerë të vogël.
Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël (KPVV), për vitin 2023 është ngritur me Urdhër nr 1, datë 12.01.2023 dhe për vitin 2024 është ngritur me Urdhër nr. 1, datë 03.01.2024 i ndryshuar me Urdhër nr. 5 datë 24.04.2024, në përbërje 3 punonjës.
Me urdhër nr.2, datë 12.01.2023 dhe urdhër nr.2, datë 03.01.2024, janë caktuar Personat përgjegjës për prokurimet me vlerë të vogël.
Për procedurat e prokurimit, të kryera gjatë periudhës objekt auditimi u audituan me përzgjedhje nëntë procedura të cilat janë trajtuar në Projekt Raportin e auditimit.

Në përfundim të auditimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të përzgjedhura nga grupi i auditimit, rezultoi se:
-Nga Autoriteti Kontraktor procedurat e blerjeve dhe të shërbimeve me vlerë të vogël nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë; janë zhvilluar me mjete elektronike, bazuar në VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar si dhe Udhëzimin e APP nr.5 datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurave me vlerë të vogël dhe zhvillimi i saj me mjete elektronike", kurse procedurat me vlerë nën 100,000 lekë, janë zhvilluar në rrugë shkresore.
-Çdo blerje apo shërbim është prokuruar vetëm pas kërkesës apo argumentimit të nevojës për mallin apo shërbimin e kryer.
-Për cdo procedurë ka dalë urdhri i prokurimit ku është përcaktuar natyra, sasia e mallrave, shërbimeve të cilat kërkohen të prokurohen.
-Në çdo rast nga komisioni janë përcaktuar specifikimet teknike, kriteret për kualifikim si dhe fondi limit. Anëtarët e komisionit të prokurimit kanë plotësuar formularin e deklarimit të konfliktit të interesit.
Komisioni i blerjeve me vlera të vogla ka përcaktuar fitues operatorin ekonomik, bazuar në kriterin e çmimit më të ulët.

- *Respektimi i procedurave për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruara.*
Në të gjitha procedurat e audituara për prokurimet me vlerë të vogël për vitet 2023 dhe 2024 rezultoi se nga Titullari i Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni i marrjes në dorëzim, në përputhje me pikën 42 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Procesi i marrjes në dorëzim është dokumentuar me procesverbal. Mallrat e blera janë bërë hyrje në magazinë.
Faturat e mallrave apo të shërbimeve, në çdo rast janë fatura elektronike të fiskalizuara.

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Në drejtim të rregullshmërisë së procedurave të kryera për prokurimin e fondeve publike për blerjet me vlerë më të madhe se 1,000,000 lekë dhe procedurave me vlera të vogla, rezulton se: procedurat e prokurimit janë kryer në përputhje me ligjin nr.162/2020, "Për prokurimin publik" i ndryshuar, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe udhëzimeve specifike të APP-së dalë në zbatim të akteve të mësipërme.

Përsa sipër vlerësojmë se organizimi dhe *funksionimi i kontrollit të brendshëm* për këtë sistem ka qenë *efektiv*. Sistemi vlerësohet me **risk të ulët**.

6. Sistemi i mbajtjes të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Objektivi i auditimit:
Vlerësimi i rregullshmërisë së funksionimit të kontrollit të brendshëm për sistemin e mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar, në përputhje me dispozitat ligjore.

Referuar strukturës së këtij Institucioni, mbajtja e kontabilitetit është organizuar brenda Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, nga Sektori i Financës, i cili funksionon me organikë prej 3 punonjës (pergjegjës sektori dhe 2 specialistë) dhe detyrat funksionale të kësaj strukture janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të ISHTI. Nëpunësi zbatues (Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës), ka varësi direkte nga Titullari Institucionit .

Struktura e ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin e pasqyrave financiare, është e njohur me dispozitat ligjore dhe nënligjore të veprimtarisë si dhe me ato të përdorimit të fondeve buxhetore dhe ushtron aktivitetin në ambiente pune dhe me infrastrukturë mbështetëse të kompletuar. Kjo njësi ka organizuar komunikimin me strukturat e tjera si dhe formën e raportimit.

Në institucion për periudhën objekt auditimi, është organizuar mbajtja e kontabilitetit dhe kryer procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore si njësi buxhetore, mbështetur në dispozitat mbi kontabilitetin për institucionet buxhetore, konkretisht në Udhëzimin nr.8, date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP".

Në këtë njësi publike (për periudhën objekt auditimi) evidentohet se mbajtja e kontabilitetit bëhet kryesisht në mënyrë manuale duke përdorur programin "Microsoft Excel" edhe pse në fakt nga ana e ISHTI është blerë programi Financiar Bilanc me faturën nr.2497/2023, datë 27.12.2023. Nepërmjet këtij programi kryheshin veprimet kontabile në ditarët e bankës, shpenzimeve, ditari i pagave në zbatim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për

kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" por nuk administroheshin të printuar. Gjithashtu, u konstatua se programi i kontabilitetit "Bilanc" është përdorur vetëm për modulin e inventarit dhe të shitjeve. Çështja lidhur me këtë problematikë është trajtuar më hollësisht në vijim të materialit.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ.
Në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit, regjistrimit të veprimeve ekonomiko-financiare, evidentohet se:
Janë regjistruar veprimet dhe transaksionet ekonomiko financiare në mënyrë të pjesshme është ruajtur vijimësia në pasqyrimin në mënyrë kronologjike të veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike; është respektuar klasifikimi kontabël i llogarive në raportimin e pasqyrave financiare për entitetet buxhetore; është ruajtur krahasushmëria e të dhënave midis dy periudhave raportuese; si dhe është mbajtur e njejta politikë kontabël për periudhën ushtrimore.

Për çeljet, përdorimin e fondeve dhe marrëdhënien me buxhetin e shtetit janë bërë rakordime periodike e vjetore me degën e thesarit.

Sipas evidencës kontabël dhe pasqyrave financiare të raportuara, në fund të periudhave 2024 dhe 2023, ISHTI ka raportuar dhe paraqitet me këtë situatë të pozicionit financiar për gjendjen pasurore, detyrimet dhe fondet e veta të institucionit:

Pasqyra e pozicionit financiar *në lekë*

Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2024	Ushtrimi i Mbyllur 2023	Ushtrimi i Mbyllur 2022
A	AKTIVET	1,465,090,099	1,460,848,470	1,434,400,693
	I.Aktivet Afat shkurtra	1,370,499,625	1,352,914,184	1,326,420,759
	1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre	-	-	-
520	Disponibilitete ne Thesar			
	2.Gjendje Inventari qarkullues	21,818,119	21,469,748	14,471,917
31	Materiale	16,216,259	15,912,714	9,462,083
32	Inventar I imet	5,601,860	5,557,034	5,009,834
	3.Llogari te Arketushme	1,348,681,506	1,331,444,436	1,311,948,842
468	Debitore te ndryshem	1,322,181,736	1,306,481,872	1,292,006,334
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	26,499,770	24,962,564	19,942,508
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	-	-	-
	II.Aktivet Afat gjata	94,590,474	107,934,286	107,979,934
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	-	-	-
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave			
202	Studime dhe kerkime			
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme			
21	2.Aktive Afatgjata materiale	94,590,474	107,934,286	107,979,934
210	Toka, T,roje, Terene			
211	Pyje, Plantacione			
212	Ndertesa e Konstruksione	22,181,179	23,348,609	24,577,483

213	Rruge, rrjete, vepra ujore			
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	61,082,146	71,837,608	67,029,260
215	Mjete Transporti	8,091,061	8,675,702	11,282,812
216	Rezerva Shteterore			
217	Kafshe pune e prodhimi			
218	Inventar ekonomik	3,236,088	4,072,367	5,090,379
24	Aktive afatgjata te demtuara			
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata			
25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	-	-	-
	4.Investime	-	-	-
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale			
231	Per Aktive Afatgjata materiale		-	-
B	**PASIVET(DETYRIMET)**	**1,348,681,506**	**1,331,444,436**	**1,311,948,842**
	I.Pasivet Afat shkurtra	**1,348,681,506**	**1,331,444,436**	**1,311,948,842**
	1. Llogari te Pagushme	**1,348,681,506**	**1,331,444,436**	**1,311,948,842**
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	156,583	265,640	1,161,714
42	Detyrime ndaj personelit	17,938,713	16,867,762	12,975,936
16,17,18	Hua Afat shkurtra			
460	Huadhenes			
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	2,131,069	1,952,073	1,316,264
432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal			
433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore			
435	Sigurime Shoqerore	6,273,405	5,877,089	4,488,594
436	Sigurime Shendetsore			
466	Kreditore per mjete ne ruajtje			
467	Kreditore te ndryshem			
4341	Operacione me shtetin(detyrime	1,322,181,736	1,306,481,872	1,292,006,334
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	-	-	-
	II.Pasivet Afat Gjata	-	-	-
Klase 4	Llogari te pagushme			
16.17.18	Huate Afat gjata			
	Provigjonet afatgjata			
Klasa 4	Te tjera			
C	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**116,408,593**	**129,404,034**	**122,451,851**
D	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**116,408,594**	**129,404,034**	**122,451,851**
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	116,060,223	122,406,203	127,705,581
12	Rezultatet e mbartura			
85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	348,371	6,997,831	(5,253,730)

Në analizën mbi rregullshmërinë e raportimit të pozicionit financiar, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe investiguar nga grupi i auditimit, rezultoi se:

Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

A. Aktivet 1,465,090,099 lekë (v.2024) dhe 1,460,848,470 lekë (v.2023);
B. Pasivet (Detyrimet) 1,348,681,506 lekë (v.2024) dhe 1,331,444,436 lekë (v.2023);
C. Aktivet neto 116,408,593 lekë (v.2024) dhe 129,404,034 lekë (v.2023).

A. Aktivet e ISHTI pëbëhen nga:

I.Aktivet Afatshkurtra

Aktivet afatshkurta paraqiten në vlerën 1,370,499,625 lekë në fund të vitit 2024 dhe 1,352,914,184 lekë në fund të vitit 2023. Këto aktive përbëhen nga:

1. Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" në shumën 0 lekë për vitin 2024 dhe vitin 2023
2. Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 21,818,119 lekë për vitin 2024 dhe 21,469,748 lekë për vitin 2023;
3. Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën shumën 1,348,681,506 lekë për vitin 2024 dhe 1,331,444,436 lekë për vitin 2023;

1. Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre", përbëhet nga:
- Llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar", sipas pasqyrave financiare të vitit 2024 dhe 2023 paraqitet në vlerën prej 0 lekë të cilat rakordojnë me rubrikën VI "Teprica e likuiditeve në fund të vitit ushtrimor" *(sipas formatit F3 "Pasqyra e flukseve monetare").*

Gjatë periudhës objekt auditimi kjo llogari ka pësuar shtesa dhe pakësime:

Përshkrimi	Viti 2024 Evidenca/ Buxheti	Viti 2024 Cash Floë	Diferenca 2024	Viti 2023 Evidenca/ Buxheti	Viti 2023 Cash Floë	Diferenca 2023
I. Të trashëguara nga Viti Paraardhës						
Te trashëguara nga Granti/Të ardhurat	-	-	-	-	-	-
Totali I	-	-	-	-	-	-
II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit						
Akordim i Fondeve nga Buxheti Shpenzime Korente	368,159,981	364,433,500	3,726,481	322,549,890	302,311,890	20,238,000
Akordim i Fondeve nga Buxheti Shpenzime Kapitale	31,514,000	4,014,000	27,500,000	20,238,000	20,238,000	-
Te hyra nga te ardhurat	195,494,259	195,494,259	-	195,716,820	195,716,820	-
Të hyra nga mjetet në ruajtje			-			-
Totali II	**595,168,240**	**563,941,759**	**31,226,481**	**538,504,710**	**518,266,710**	**20,238,000**
Totali i lëvizjes debitore (I+II)	**595,168,240**	**563,941,759**	**31,226,481**	**538,504,710**	**518,266,710**	**20,238,000**
III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520						
Pagesa për shpenzime Korente	364,903,309	364,903,309	-	320,498,064	320,498,064	-
Pagesa për Investime	4,013,400		4,013,400	20,238,000		20,238,000
Kthim në buxhetin e shtetit	226,251,531	199,038,450	27,213,081	97,768,646	197,768,646	-
Totali III Totali I lëvizjes kreditore	**595,168,240**	**563,941,759**	**31,226,481**	**538,504,710**	**518,266,710**	**20,238,000**
						-

Teprica debitore (I+II) – III =	-	-	-	-	-	-

Për verifikimin e shumave të mësipërme u shqyrtuan ditari i bankës, akt-rakordimet me Degën e Thesarit Tiranë dhe Formati 3: "Paqyra e Flukseve Monetare (Cash Floë)". Nga krahasimi i akt-rakordimeve me Thesarin rezultoi se, për vitin 2023, në pasqyrën e Cash Floë nuk është përfshirë pagesa për investime në vlerën 20,238,000 lekë, e evidentuar në ditarin e shpenzimeve dhe akt-rakordime, si dhe nuk është regjistruar akordimi i fondeve nga buxheti për shpenzime korente në shumën 20,238,000 lekë. Ndërsa për vitin 2024, në pasqyrën e flukseve monetare mungon pasqyrimi i akordimit të fondeve nga buxheti për shpenzime korente në vlerën 3,726,481 lekë dhe për shpenzime kapitale në vlerën 27,500,000 lekë; gjithashtu nuk është pasqyruar pagesa për investime në shumën 4,013,400 lekë.

2. Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
31	Materiale	16,216,259	15,912,714	9,462,083
32	Inventar i imet	5,601,860	5,557,034	5,009,834
Totali		**21,818,119**	**21,469,748**	**14,471,917**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të ISHTI paraqiten në shumën 21,818,119 lekë në fund 2024, në shumën 21,469,748 lekë në fund të vitit 2023 dhe në vlerën 14,471,917 lekë në fund të vitit 2022.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 348,371 lekë për vitin 2024 dhe në shumën 6,997,831 lekë për vitin 2023 e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi gjendjes së inventarit" pasqyrën e performancës.
Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit".

3. Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme"&"Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Viti 2022
	Llogari të arkëtueshme			-
468	Debitorë të ndryshem	1,322,181,736	1,306,481,872	1,292,006,334
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	26,499,770	24,962,564	19,942,508
	Totali	**1,348,681,506**	**1,331,444,436**	**1,311,948,842**

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme", sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të ISHTI paraqiten në shumën 1,348,681,506 lekë lekë në fund 2024, në shumën 1,331,444,436 lekë në fund të vitit 2023 dhe në shumën 1,311,948,842 lekë në fund të vitit 2022.

- ***Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm"***, paraqitet në në vlerën 1,322,181,736 lekë në fund të vitit 2024, në vlerën 1,306,481,872 lekë në fund të vitit 2023 dhe në vlerën 1,292,006,334 lekë në fund të vitit 2022. Kjo llogari përbën elementin dominues të pozicionit të aktiveve të ISHTI-së, duke

zënë 90% të totalit për vitin 2024 dhe 89% për vitin 2023, çka tregon një ekspozim të lartë financiar ndaj debitorëve.

Për periudhën objekt auditimi, struktura e llogarisë 468 përfshin pesë kategori kryesore:

- Debitorë për gjoba;
- Debitorë për shërbime;
- Debitorë për humbje nga vjedhjet;
- Debitorë të ndryshëm;
- Debitorë të trashëguar nga ish-ISPIL.

Gjendja dhe ndryshimet e këtyre kategorive të debitorëve për periudhën e audituar paraqiten si më poshtë:

Viti 2023

Zërat	Bilanci 31.12.2022	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2023
Gjoba	1,175,418,073	32,290,000	13,632,278	1,194,075,795
Sherbime	112,242,162	185,126,020	189,308,203	108,059,979
Humje vjedhje	1,698,068			1,698,068
Deb te ndryshem	1,130,856			1,130,856
Te trsg ISPIL	1,517,175			1,517,175
Totali	**1,292,006,334**	**217,416,020**	**202,940,481**	**1,306,481,872**

Viti 2024

Zërat	Gjendja 31.12.2023	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2024
Gjoba	1,194,075,794	35,550,000	26,336,667	1,203,289,127
Sherbime	108,059,979	191,616,000	185,129,469	114,546,510
Humje vjedhje	1,698,068		-	1,698,068
Deb te ndryshem	1,130,856		-	1,130,856
Te trsg ISPIL	1,517,175		-	1,517,175
Totali	**1,306,481,871**	**227,166,000**	**211,466,136**	**1,322,181,736**

Nga analiza e kohës së krijimit të detyrimeve rezulton se debitorët për gjoba datojnë që nga viti 1999, ndërsa debitorët për shërbime nga viti 2006. Duke qenë se këto detyrime janë shumë të vjetra dhe vijojnë të mbarten në pasqyrat kontabël të institucionit, duhet të vlerësohet mundësia e parashkrimit të tyre, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", të cilat përcaktojnë afate ligjore për humbjen e së drejtës së kërkimit apo ekzekutimit të detyrimeve të papaguara.

Evidentohet se institucioni nuk ka ndërmarrë veprime për identifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve potencialisht të parashkruara, si dhe nuk ka ndërmarrë hapa administrativë për konstatimin dhe trajtimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi. Si pasojë, këto vlera vijojnë të pasqyrohen çdo vit në regjistrat kontabël si debitorë aktivë, duke shtrembëruar realisht gjendjen financiare të institucionit dhe duke mos reflektuar saktë gjendjen e të arkëtueshmeve.

E analizuar sipas kategorive situata e evidentuar nga grupi i auditimit paraqitet si vijon.

Debitorë për gjoba:

Gjatë vitit 2023 janë vendosur gjithsej 72 gjoba. Nga këto:

- 14 masa janë likuiduar plotësisht nga subjektet gjatë vitit 2023 me vlerë totale 1,280,000 lekë;
- 16 masa janë likuiduar plotësisht nga subjektet gjatë vitit 2024 me vlerë totale 2,316,667 lekë;
- 5 masa janë likuiduar plotësisht gjatë vitit 2025 me vlerë totale 1,280,000 lekë;
- 1 masë është likuiduar pjesërisht gjatë vitit 2025 me vlerë 4,083,333 lekë;
- 11 masa janë shfuqizuar nga komisioni i ankimimit në vitin 2023 me vlerë 4,010,000 lekë;

- 1 masë është shfuqizuar me vendim të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me vlerë 200,000 lekë;
- 2 masa janë objekte të vendimit të gjykatës për sigurimin e padisë;
-3 raste janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit lidhur me çeljen e titullit ekzekutiv dhe janë ende në proces gjykimi;
- 13 raste ndodhen në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për çeljen e urdhrit të ekzekutimit;
- 6 masa janë në proces ekzekutimi pranë shërbimit përmbarimor.

Gjatë vitit 2024 janë vendosur gjithsej 62 masa administrative. Nga këto:
- 12 gjoba janë likuiduar plotësisht nga subjektet gjatë vitit 2024 me vlerë totale 3,300,000 lekë;
- 7 masa janë likuiduar plotësisht gjatë vitit 2025 me vlerë totale 500,000 lekë;
- 16 masa janë shfuqizuar me vendim të Komisionit të Ankimit të ISHTI-së (11 masa janë shfuqizuar gjatë 2024 me vlerë 9,500,000 dhe 5 masa janë shfuqizuar gjatë vitit 2025 me vlerë 450,000 lekë) ;
- 2 raste janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit në lidhje me çeljen e titullit ekzekutiv dhe janë ende në proces gjykimi;
- 13 raste ndodhen në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për çeljen e urdhrit të ekzekutimit;
- 12 masa janë në proces ekzekutimi pranë shërbimit përmbarimor.

Evidentohet se niveli i arkëtimit të gjobave mbetet i ulët në raport me totalin e masave të vendosura, ndërkohë që një numër i konsiderueshëm masash ndodhen në proces gjyqësor ose ekzekutimi, duke shtuar rrezikun për mospërfitim të të ardhurave të pritshme.

Debitorë për Shërbime:
Llogaria e debitorëve për shërbime paraqitet në vlerën 108,059,979 lekë në fund të vitit 2023 dhe 114,546,510 lekë në fund të vitit 2024. Nga analiza rezulton se në fund të vitit 2024, 105,299,162 lekë ose rreth 92% e totalit përfaqësojnë detyrime të mbartura nga periudhat e mëparshme, 1,899,817 lekë i përkasin vitit 2023 dhe 7,347,531 lekë vitit 2024.

Në lidhje me ndjekjen e këtyre detyrimeve, nga verifikimi i kryer rezulton se ISHTI ka dërguar në gjykatë 8 raste, me vlerë totale 680,000 lekë, prej të cilave 3 raste i përkasin vitit 2022 (255,000 lekë), 3 raste vitit 2023 (255,000 lekë) dhe 2 raste vitit 2024 (170,000 lekë) . Për pjesën tjetër të debitorëve, nuk janë paraqitur evidenca ose dokumentacion mbështetës që të vërtetojnë ndjekjen e procedurave të arkëtimit apo masat e ndërmarra për rikuperimin e detyrimeve.

Në mungesë të një procedure të qartë dhe transparente për përzgjedhjen e rasteve që dërgohen për ndjekje gjyqësore, si dhe të një mekanizmi efektiv monitorimi për debitorët e shërbimeve, grupi i auditimit konstaton mangësi në zbatimin e detyrimeve institucionale për ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave, gjë që rrit rrezikun për mospërfitim të fondeve publike dhe përkeqëson cilësinë e aktiveve qarkulluese të institucionit.

Debitorë për humbje nga vjedhjet; Debitorë të ndryshëm dhe Debitorë të trashëguar nga ish-ISPIL.
Për të dy vitet objekt auditimi, debitorët për humbje nga vjedhjet paraqiten në vlerën 1,698,068 lekë, debitorët e ndryshëm në vlerën 1,130,856 lekë, dhe debitorët e trashëguar nga ish-ISPIL në

vlerën 1,517,175 lekë. Të gjitha këto vlera janë të mbartura nga periudhat paraardhëse, pa pasur ndryshime në strukturë apo në vlerë gjatë viteve të audituara.

Nga verifikimi i kryer, grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion evidenca apo dokumentacion mbështetës që të dëshmojnë masat e ndërmarra për ndjekjen dhe arkëtimin e këtyre detyrimeve, si dhe nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime administrative apo ligjore për rikuperimin e shumave përkatëse.

Problematikat lidhur me këtë llogari janë përshkruar në mënyrë më të hollësishme në vijim të materialit.

II.Aktivet Afatgjata

Aktivet Afatgjata paraqiten në vlerën 94,590,474 lekë në fund të vitit 2024, 107,934,286 lekë në fund të vitit 2023 dhe 107,979,934 lekë në fund të vitit 2022. Aktivet Afatgjata të ISHTI përbëhen nga:

- Aktive Afatgjata Materiale të cilat janë raportuar klasifikuar ne 4 grupime kontabël, respektivisht ne llog 212 "Ndertesa e Konstruksione"; ne llog 214 "Instalime teknike, makineri e paisje"; ne llog 215 "Mjete Transporti"; ne llog 218 "Inventar Ekonomik".

Në mënyrë më të hollësishme janë të paraqitura në projektraport.

B. Pasivet (Detyrimet), janë raportuar të klasifikuara në grupin "Detyrime afatshkurtra". Entiteti nuk ka "detyrime të pagueshme" apo "hua te marra", afatgjata.
Gjendja detyrime afatshkurtra, në fund të vitit 2024 paraqitet për vlerën totale 1,348,681,506 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 1,331,444,436 lekë, e raportuar me analizë sipas llogarive:

-Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to",
-Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit",
-Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa",
-Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore"
- Llogaria 4341 "Të tjera operacione me shtetin (detyrime)".

C. Aktivet Neto, fondet e entitetit, ne fund te vitit 2024 paraqiten për 116,408,593 lekë nga 129,404,034 lekë në fund të vitit 2023.
Nga njesia aktivet neto janë raportuar te klasifikuara në:

- ***Llogaria 101 "teprica fondi i akumuluar"*** në fund të vitit 2024 për 116,060,223 lekë dhe në fund të vitit 2023 për 122,406,203 lekë.

***-Llogaria* 85** "*rezultati i veprimtarise ushtrimore*", në fund të vitit 2024 për 348,371 lekë dhe në fund të vitit 2023 për 6,997,831 lekë.

Raportimi i pasqyrave financiare dhe rakordimet me degën e thesarit.

Mbyllja dhe raportimi i pasqyrave financiare, evidentohet se është bërë mbeshtetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomise nr.8 datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësite e qeverisjes së përgjithshme".
Raportimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2024, paraqitet i plotë në drejtim të plotësimit të pasqyrave financiare dhe formateve përkatëse përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së

Financave dhe Ekonomise nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësite e qeverisjes së përgjithshme".
Janë raportuar pasqyrat financiare vjetore për periudhën ushtrimore 2024 pranë Degës së Thesarit Tiranë si dhe në Organin Qendror të Vartësisë, MIE me shkresën nr.2287, datë 20.03.2025 si dhe për periudhën ushtrimore 2023 me shkresën nr.3254, datë 29.02.2024.
Evidentohet se midis strukturës të financës të ISHTI dhe sektorit të shpenzimeve në Degën e Thesarit Tiranë, është rakorduar për shpenzimet, me situacionet e shpenzimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2024 dhe Janar – Dhjetor 2023, firmosur rregullisht nga palët.

Rregullshmëria e kryerjes së inventarizimit fizik të aktiveve
Inventarizimi është kryer në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
Titullari i institucionit për periudhën objekt auditimi ka lëshuar Urdhrat për kryerjen e inventarizimit të vlerave monetare e materiale.
Përbërja e komisionit të inventarizimit të aktiveve të njësisë është e ndryshme në të dy vitet objekt auditimi, veprim ky në përputhje me pikën 84 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011, të ndryshuar, ku citohet *"inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision"*.
Lista e aktiveve për inventarizim është hartuar nga nëpunësi zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë, në përputhje me pikën 81 të udhëzimit, ku shprehimisht citohet se: *"Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga nëpunësi zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë"*.

Në zbatim të detyrave të përcaktuara në aktet ligjore të sipërcituara nga komisionet e inventarizimit është kryer inventarizimi fizik për asetet e ISHTI me përgjegjës material dhe për gjithë aktivet në magazinë e në përdorim per vitet 2023 e 2024. Ky proces është dokumentuar me shkresën nr.9442/1, datë 05.12.2023 drejtuar Kryeinspektorit për vitin 2023 dhe shkresën nr.14314/1, datë 16.12.2024, për vitin 2024.
Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të shkresave të sipërcituara dhe fletëve të inventarizimit evidentoi parregullsi në proçesin e inventarizimit, të cilat përshkruhen në vijim të këtij materiali.

Titulli gjetjes: *Mos mbajtja e regjistrimeve kontabël me bartës informatik dhe mos administrimi si duhet i të dhënave kontabile.*

Nr. i gjetjes: 6	
Subjekti i audituar	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përmbledhja e bazës ligjore	-Ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". -Ligji nr.10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Gjatë auditimit të kryer për periudhën objekt shqyrtimi, u konstatua se Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) nuk ka siguruar funksionimin e një sistemi të rregullt, të sigurt dhe

	ligjërisht të përshtatshëm për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare. Në praktikë, mbajtja e kontabilitetit është realizuar në mënyrë manuale, duke përdorur programin "Microsoft Excel". Ky program, ndonëse i përhapur për përdorime të përgjithshme, nuk është i certifikuar për mbajtjen e regjistrave financiarë, nuk garanton integritetin e të dhënave, lejon ndryshime të pakontrolluara dhe nuk mund të konsiderohet si "bartës informatik", sipas përkufizimit të dhënë në nenin 3, pika 15 të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Sipas këtij neni, një bartës informatik duhet të jetë një program i autorizuar, që siguron pamanipulueshmëri dhe mundësi printimi të menjëhershëm të informacionit kontabël. Përdorimi i Excel-it për qëllime kontabël përbën mosrespektim të kërkesave ligjore dhe teknike, dhe rrit ndjeshëm rrezikun për gabime, mospërputhje të të dhënave, si dhe për manipulim të paidentifikueshëm të informacionit financiar. Kjo situatë dëmton funksionimin normal të sistemit të raportimit financiar dhe bie ndesh me parimet e transparencës, gjurmueshmërisë dhe kontrollit të brendshëm. Megjithëse ISHTI ka ndërmarrë masa për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit përmes abonimit vjetor të një programi të specializuar financiar – konkretisht "Bilanc", me faturë tatimore faturën nr.2497/2023, datë 27.12.2023 me vlerë 496,800 lekë – rezulton se ky program nuk është vënë në funksion të plotë gjatë periudhës së auditimit. Evidentohet se ky program gjatë periudhës së auditimit është përdorur vetëm për dy module: modulin e shitjes dhe modulin e inventarit nga 8 moduke të kontraktuara. Mosaktivizimi i plotë i programit "Bilanc" ka sjellë një efekt negativ të dyfishtë në financat e institucionit: - Së pari, është kryer një shpenzim buxhetor pa kthim në vlerë të shtuar duke cënuar edhe parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit të përcaktuar në nenin 5 të Ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". - Së dyti, është humbur një mundësi reale për të përmirësuar dhe modernizuar sistemin financiar të institucionit, në një kohë kur një sistem i tillë është i domosdoshëm për të përmbushur detyrimet ligjore dhe për të garantuar raportim të saktë e të kontrollueshëm financiar. Për më tepër, nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se ditarët dhe regjistrat kontabël nuk janë printuar dhe protokolluar,

	në kundërshtim me nenin 8 të Ligjit nr. 25/2018, i cili përcakton se çdo dokument kontabël, përfshirë edhe ato në formë elektronike, duhet të ruhet për një periudhë prej të paktën 10 vjet në selinë ku zhvillohet aktiviteti ekonomik i njësisë ekonomike. Ky nen thekson gjithashtu se kjo kërkesë vlen edhe për printimet e bartësve informatikë, për të siguruar gjurmueshmëri, transparencë dhe kontroll të veprimeve ekonomike të regjistruara. Mungesa e printimit dhe protokollimit të regjistrave kontabël përbën një cenim të drejtpërdrejtë të arkivimit financiar, e cila vështirëson ndjeshëm verifikimin dhe auditimin në të ardhmen dhe rrit ekspozimin ndaj rreziqeve të pasaktësisë dhe mospërputhshmërisë në pasqyrat financiare. Kjo situatë dëmton besueshmërinë, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e informacionit financiar të institucionit, duke cenuar parimet e mirëqeverisjes financiare dhe detyrimet ligjore për mbajtjen e kontabilitetit të saktë, të verifikueshëm dhe të qëndrueshëm. **Kriteri:** Neni 3 pika 8 dhe neni 8 i Ligjit nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Neni 5 i Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, **Ndikimi/Efekti:** - Mungesa e një sistemi të sigurt dhe të standardizuar për mbajtjen e kontabilitetit rrit rrezikun e gabimeve, manipulimeve dhe humbjes së të dhënave financiare. - Mosprintimi dhe mosprotokollimi i ditarëve kontabël cenon ruajtjen dhe vërtetësinë e informacionit financiar, si dhe përbën shkelje të procedurave ligjore për administrimin e dokumentacionit kontabël. **Shkaku:** Moszbatim i kërkesave dhe mungesa e kontrolleve të brendëshme efektive ligjore lidhur me mbajtjen e evidencave kontabile.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) nuk ka zbatuar një sistem të sigurt dhe të standardizuar për mbajtjen dhe administrimin e kontabilitetit, në përputhje me kuadrin ligjor dhe parimet e menaxhimit financiar. Mbajtja e kontabilitetit përmes programit Excel, mosimplementimi i programit financiar të blerë "Bilanc" dhe mungesa e printimit dhe protokollimit të regjistrave kontabël përbëjnë një sërë shkeljesh që cenojnë transparencën, kontrollin dhe besueshmërinë e të dhënave financiare. Mungesa e masave korrigjuese për implementimin e një sistemi të dedikuar, pavarësisht burimeve të shpenzuara, reflekton dobësi të

	menaxhimit dhe të kontrollit të brendshëm, si dhe një përdorim joefektiv të fondeve publike.
Rekomandime	Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa konkrete për vendosjen në funksion të programit financiar, i cili është blerë nga institucioni me fonde publike. Përdorimi i këtij programi të certifikuar duhet të shërbejë si bazë zyrtare për regjistrimet kontabël dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare, ndërsa përdorimi i "Microsoft Excel" mund të vijojë si mjet ndihmës për analiza dhe përpunim të brendshëm të të dhënave. Po ashtu, kjo drejtori duhet të sigurojë që të gjithë ditarët dhe regjistrat kontabël të printohen, protokollohen dhe ruhen në përputhje me nenin 8 të Ligjit nr. 25/2018, për të garantuar gjurmueshmërinë, transparencën dhe integritetin e informacionit financiar.
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Brenda muajit Mars 2026.*
Statusi i rekomandimit	*Observuar/ I papranuar nga Grupi i Audtimit*

Titulli gjetjes: *Pasaktësi në pasqyrimin e flukseve monetare në pasqyrën "Cash Flow"*

Nr. i gjetjes: 7	
Subjekti i audituar	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përmbledhja e bazës ligjore	-Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes publike"
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Gjatë verifikimit të shumave të pasqyruara në "Formatin 3 – Paqyra e Flukseve Monetare (Cash Flow)" u shqyrtuan ditari i bankës, akt-rakordimet me Degën e Thesarit Tiranë dhe dokumentacioni mbështetës i lidhur me lëvizjet e fondeve. Nga krahasimi i të dhënave rezultoi se: - Për vitin 2023, në pasqyrën e flukseve monetare nuk është përfshirë pagesa për investime në vlerën 20,238,000 lekë, e cila është evidentuar si në ditarin e shpenzimeve ashtu edhe në akt-rakordimet me Thesarin. Po ashtu, nuk është pasqyruar akordimi i fondeve nga buxheti për shpenzime korente në të njëjtën shumë prej 20,238,000 lekë. - Për vitin 2024, në pasqyrën e Cash Floë mungon pasqyrimi i akordimit të fondeve nga buxheti për shpenzime korente në vlerën 3,726,481 lekë dhe për shpenzime kapitale në vlerën 27,500,000 lekë. Gjithashtu, nuk është përfshirë pagesa për investime në shumën 4,013,400 lekë, e dokumentuar në ditarin e shpenzimeve dhe në akt-rakordimet me Thesarin. **Kriteri:**

	Pika 3.5, paragrafi 72 i Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të qeverisjes publike" **Ndikimi/Efekti:** Cenimi i besueshmërisë dhe integritetit të pasqyrave financiare vjetore. **Shkaku:** Mospasja në funksion të plotë e një sistemi të certifikuar financiar dhe mosmbajtja e kontabilitetit të plotë e të sigurt.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Pasqyrat e flukseve monetare për vitet 2023 dhe 2024 nuk reflektojnë në mënyrë të plotë lëvizjet reale të fondeve, për shkak të mospërfshirjes së disa akordimeve buxhetore dhe pagesave për investime. Kjo situatë cenon saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare vjetore.
Rekomandime	Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të bëhet rishikimi dhe përditësimi i pasqyrave të flukseve monetare në përputhje me akt-rakordimet dhe regjistrat kontabël, si dhe të forcohen kontrollet e brendshme për garantimin e raportimit financiar të saktë dhe të plotë.
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Brenda muajit Mars 2026.*
Statusi i rekomandimit	*Observuar/ I papranuar nga Grupi i Auditimit*

Titulli gjetjes: *Mungesë efektiviteti në ndjekjen dhe arkëtimin e debitorëve*

Nr. i gjetjes: 8	
Subjekti i audituar	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Nga analiza e të dhënave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se procesi i ndjekjes dhe arkëtimit të detyrimeve të prapambetura nga gjobat dhe shërbimet në Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) nuk është zhvilluar në mënyrë të plotë dhe efektive, duke reflektuar mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në zbatimin e procedurave të përcaktuara ligjore. 1. Gjobat Gjatë viteve 2023–2024 janë vendosur gjithsej 134 masa administrative (72 në vitin 2023 dhe 62 në vitin 2024). Nga shqyrtimi rezulton se: - Nga gjobat e vendosura në vitin 2023, janë likuiduar plotësisht 35 masa (14 gjatë 2023, 16 gjatë 2024 dhe 5 gjatë 2025) me vlerë totale 4,876,667 lekë, ndërsa një masë është likuiduar pjesërisht

gjatë 2025 në vlerën 4,083,333 lekë. Gjithashtu në këtë vit janë shfuqizuar 12 masa nga komisionet dhe gjykatat përkatëse me vlerë 4,210,000 lekë, ndërsa 24 raste ndodhen në proces gjyqësor ose ekzekutimi.

- Nga gjobat e vendosura në vitin 2024, janë likuiduar 19 masa me vlerë 3,800,000 lekë, ndërsa 16 masa janë shfuqizuar (me vlerë totale 9,950,000 lekë). Pjesa tjetër përbëhet nga 27 raste në proces gjyqësor ose ekzekutimi.

Evidentohet se niveli i arkëtimit të gjobave është i ulët në raport me totalin e masave të vendosura, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e tyre mbeten në proces gjyqësor apo përmbarimor, duke krijuar vonesa të ndjeshme në realizimin e të ardhurave dhe duke rritur rrezikun për mospërfitim të fondeve publike.

2. Debitorët për shërbime

Llogaria "Debitorë për shërbime" paraqitet në vlerën 108,059,979 lekë në fund të vitit 2023 dhe 114,546,510 lekë në fund të vitit 2024. Nga analiza rezulton se në fund të vitit 2024, 92% e totalit (105,299,162 lekë) përfaqësojnë detyrime të mbartura nga periudhat e mëparshme, ndërsa pjesa e mbetur i përket viteve 2023 dhe 2024.

Nga verifikimet u konstatua se ISHTI ka dërguar në gjykatë vetëm 8 raste, me vlerë totale 680,000 lekë, ndërkohë që për pjesën tjetër të debitorëve nuk janë paraqitur evidenca ose dokumentacion mbështetës që të vërtetojnë ndjekjen e procedurave të arkëtimit apo masat e ndërmarra për rikuperimin e detyrimeve.

Në mungesë të një procedure të qartë për përzgjedhjen e rasteve që dërgohen për ndjekje gjyqësore, si dhe të një mekanizmi monitorues efektiv, konstatohet se institucioni nuk ka siguruar një proces të strukturuar dhe të qëndrueshëm për administrimin dhe arkëtimin e të ardhurave nga shërbimet.

3. Debitorët për humbje, të ndryshëm dhe të trashëguar

Për të dy vitet objekt auditimi, debitorët për humbje nga vjedhjet (1,698,068 lekë), debitorët e ndryshëm (1,130,856 lekë) dhe debitorët e trashëguar nga ish-ISPIL (1,517,175 lekë) paraqiten të pandryshuar, pa asnjë lëvizje ose veprim për arkëtimin e tyre.

Grupit të auditimit nuk i janë vënë në dispozicion evidenca mbi masat e ndërmarra administrative ose ligjore për rikuperimin e këtyre detyrimeve, duke treguar se llogaritë e debitorëve mbeten pasive dhe të pambuluara me veprime konkrete.

Nga analiza e kohës së krijimit të detyrimeve rezulton se debitorët për gjoba datojnë që nga viti 1999, ndërsa debitorët për shërbime nga viti 2006. Duke qenë se këto detyrime janë shumë të vjetra dhe

	vijojnë të mbarten në pasqyrat kontabël të institucionit, duhet të vlerësohet mundësia e parashkrimit të tyre, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit nr. 10 279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", të cilat përcaktojnë afate ligjore për humbjen e së drejtës së kërkimit apo ekzekutimit të detyrimeve të papaguara. Evidentohet se institucioni nuk ka ndërmarrë veprime për identifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve potencialisht të parashkruara, as ka nisur procedurat për konstatimin dhe trajtimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi. Si pasojë, këto vlera vijojnë të pasqyrohen çdo vit në regjistrat kontabël si debitorë aktivë, duke shtrembëruar realisht gjendjen financiare të institucionit dhe duke mos reflektuar saktë gjendjen e të arkëtueshmeve. **Kriteri:** - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin", nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 27; - Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 114 e vijues, që parashikon afatet e parashkrimit të detyrimeve civile; - Ligji nr. 10 279, datë 20.05.2010, "Për kundërvajtjet administrative", neni 46, që përcakton afatin e parashkrimit të dënimeve administrative të paekzekutuara; - Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", që rregullon mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe nxjerrjes së vendimeve administrative; - Instruksioni Standard (IS) dhe Manuali mbi MFK, miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave, i ndryshuar – Kreu II, paragrafët 2.2.6, 2.2.7, 2.2.8 dhe 2.2.9; - Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016, "Për nëpunësin zbatues të të gjitha niveleve"; - Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike". **Ndikimi/Efekti:** Risk për mosarkëtimin e të ardhurave publike dhe mospasqyrim të saktë të situatës financiare. **Shkaku:** Mungesa e një procedure të qartë dhe të standardizuar për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve, si dhe mosvlerësimi në kohë i detyrimeve të vjetra për efekt parashkrimi.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë
Konkluzioni	Për periudhën 2023–2024, procesi i ndjekjes, arkëtimit dhe administrimit të detyrimeve nga gjobat dhe shërbimet në ISHTI nuk është realizuar në mënyrë të plotë dhe efektive. Në fund të vitit 2024, vlera totale e debitorëve rezulton 1,322,181,736 lekë, nga të

	cilat 1,203,289,127 lekë i përkasin gjobave dhe 108,059,979 lekë detyrimeve për shërbime. Niveli i arkëtimit të këtyre detyrimeve është i ulët dhe shuma e pambledhur paraqet trend rritës nga viti në vit. Sa i përket gjobave, ekzistojnë vetëm analiza pjesore mbi afatet e krijimit (deri në vitin 1999), por mungon një inventarizim i plotë dhe i saktë për secilin subjekt, vlerën e gjobës, si dhe masat e ndërmarra për arkëtimin e tyre, qoftë nëpërmjet procedurave gjyqësore, përmbarimit apo vlerësimit të mundësisë së arkëtimit. Këto analiza duhet të kryhen rregullisht çdo vit, në kuadër të inventarizimit të aktiveve. E njëjta situatë vërehet edhe për detyrimet nga shërbimet. Përveç mangësive të evidentuara për gjobat, ISHTI nuk kryen analiza të plota lidhur me situatën e debitorëve për shërbime apo funksionimin e mekanizmave detyrues për arkëtimin e vlerës së shërbimeve.
Rekomandime	Të merren masa për përmirësimin e punës në drejtim të analizës së hollësishme të gjendjes së debitorëve të ndryshëm për gjoba dhe shërbime, analizë e cila të përqendrohet në klasifikimin e tyre sipas afatit të krijimit, ndjekjes në proces gjyqësor apo zyrë përmbarimi, si dhe vlerësimin e mundësive të arkëtimit të tyre, bazuar në kriteret përkatëse ligjore. Gjithashtu, të merren masa për vlerësimin e funksionimit të mekanizmave detyrues për arkëtimin, si të gjobave ashtu edhe të vlerave të shërbimeve, si dhe të hartohen propozime për përmirësimin dhe forcimin e funksionimit të këtyre mekanizmave.
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Brenda muajit Mars 2026.*
Statusi i rekomandimit	*Observuar/ I papranuar nga Grupi i Auditimit*

Titulli gjetjes: *Parregullsi në procesin e inventarizimit të pasurisë*

Nr. i gjetjes: 9	
Subjekti i audituar	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimi Nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" I ndryshuar;
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Bazuar në raportet e inventarizmit të audituara, komisioni është shprehur se ka bërë verifikimin e aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra të institucionit, gjendjen e tyre sasiore dhe cilësore. Pavarsisht se komisioni është shprehur se nuk ka diferenca midis gjendjes fizike dhe kontabile, rezulton se jo për të gjithë aktivet është bërë verifikimi sasior dhe cilësor i aktiveve, konkretisht:

	Një pjesë e aktiveve materiale afatgjata dhe afatshkurtra të njësisë, për periudhën objekt auditimi janë në ngarkim të personave të larguar nga institucioni. Në fund të vitit 2023 rezultojnë 25 raste të personave të larguar të cilët figurojnë si përgjegjës material të aktiveve të njësisë. Aktivet në ngarkim të këtyre personave nuk janë verfikuar nga komisioni i inventarizimit për gjendjen e tyre sasiore dhe cilësore. Fletët kontabël të personave të larguar nga institucioni nuk janë nënshkruar nga Komisioni i Inventarizimit. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë dokumentacion i cili provon verifikimin sasior dhe cilësor nga komisioni i inventarizimit të aktiveve të cilat janë në ngarkim të personave të larguar. Për sa sipër grupi i auditimit evidenton: -Vlerat pasurore të institucionit, aktivet e qendrueshme të trupezuara dhe gjendjet e inventarit të pasqyruara në fund të vitit 2023 dhe 2024 nuk janë të gjitha të mbështetura me verifikime fizike gjatë procesit të inventarizimit, organizuar dhe urdhëruar nga Kryeinspektori me Urdhrat respektiv nr.40, datë 15.11.2023 dhe nr.100 datë 20.11.2024. **Kriteri:** Pika 74 e Udhëzimit të MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar. **Ndikimi/Efekti:** Pasiguri për ekzistencën fizike dhe gjendjen cilësore të disa aktiveve të njësisë. **Shkaku:** Moszbatim i disa kërkesave ligjore për inventarizimin fizik të aktiveve të njësisë.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Aktivet e njësisë të cilat në fund të vitit 2023 dhe 2024 janë në ngarkim të personave të larguar nuk janë inventarizuar duke vepruar në kundërshtim me pikën 74 të Udhëzimit Nr.30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" i ndryshuar. Ky veprim ndikon në krijimin e pasigurisë për ekzistencën fizike dhe gjendjen cilësore të disa aktiveve të njësisë.
Rekomandime	Të merren masat që të inventarizohen të gjitha aktivet e njësisë, përfshirë edhe aktivet të cilat kanë persona përgjegjës të larguar.
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Brenda muajit Mars 2026.*
Statusi i rekomandimit	*Observuar/ I papranuar nga Grupi i Audtimit*

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Entiteti, ka krijuar pjesërisht sistemin e evidences kontabile dhe raportimit te paqyrave financiare, mbeshtetur ne Ligjin nr.25/2018 dt.10.05.2018, dhe Udhëzimit të MFE Nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore në njësite e qeverisjes së përgjithëshme".

Sistemi ka shfaqur mangesi lidhur me mbajtjen e regjistrave kontabël dhe administrimin e të dhënave kontabël, pasqyrimin e saktë dhe të plotë të flukseve monetare, ndjekjen dhe arkëtimin e debitorëve dhe procesin e inventarizimit të pasurive të ISHTI-t.

Auditimi vlerëson se kontrolli i brendshëm për sistemin e mbajtjes të kontabilitetit dhe raportimit financiar, nuk ka funksionuar në nivelin e duhur dhe nuk ka bërë të mundur evidentimin, përmirësimin në kohë dhe shmangien e parregullsive.
Risku në këtë sistem vlerësohet **në nivel të lartë.**
Përsa sipër, grupi i auditimit vlerëson se *funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm ka **qenë jo efektiv***

7. Sistemi i procedurave të inspektimit dhe kontrollit në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Objektivi i auditimit
-Vlerësimi nëse janë zbatuar kërkesat e dispozitave ligjore në fushën e inspektimit e të kontrollit për respektimin e standarteve në veprimtarinë e naftës dhe nënprodukteve të tyre.

- Rregullshmëria e hartimit, miratimit dhe realizimi i programeve mujore dhe vjetore të inspektimit dhe kontrollit të cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të tyre. Hartimi dhe përditësimi i të dhënave të rregjistrit të subjekteve që i nënshtrohen inspektimit.

Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre (DINGN), është strukturë përbërëse e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), për kontrollin e veprimtarisë së personave juridik që ushtrojnë veprimtarinë e saj në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Programet vjetore të inspektimit për DINGN janë miratuar nga Kryeinspektori përkatësisht për vitin 2023 me nr.9534, datë 10.11.2022 dhe për vitin 2024 janë miratuar me nr.7869 prot., datë 16.10.2023.

Programet vjetore për institucionin janë dërguar në IQ/IP për vitin 2023 me shkresën nr.8869 prot., datë 13.10.2022 dhe për vitin 2024 me shkresën nr.7769 prot., datë 12.10.2023, në përputhje me VKM nr. 696, datë 16.8.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "*e*-inspektimi" **kreu** IV, pika 1 "Bashkërendimi dhe mbështetja për programet e inspektimit".

Programet vjetore për institucionin janë dërguar në MIE për vitin 2023 me shkresën nr.9553 prot., datë 14.11.2022, ndërsa për vitin 2024 grupit të auditimit nuk ju paraqit shkresa e dërgimit të planit vjetor për të gjitha drejtoritë që kryejnë inspektim pranë ISHTI. Mosdërgimi i programit vjetor në MIE është në mospërputhje me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", kreu iv "Rregulla të përgjithshme për programimin dhe autorizimin e inspektimit" Neni 24, pika 3 "*Programi i inspektimit të inspektoratit shtetëror miratohet nga **ministri përgjegjës** pas marrjes së mendimit këshillimor nga Inspektorati Qendror*".

Për vitin 2023, bazuar në programin me nr.9534, datë 10.11.2022, janë planifikuar për t'u kryer 1151 inspektime dhe janë kryer 807 inspektime të programuara dhe 47 inspektime jashtë programit, ndërsa për vitin 2024, bazuar në programin me nr.7869 prot., datë 16.10.2023 janë planifikuar të kryhen 1108 dhe janë realizuar 922 inspektime nga të cilat 167 jashtë programit.

Për zbatimin e programit vjetor të inspektimeve nga DINGN janë hartuar programet mujore, ku janë përcaktuar niveli i riskut për çdo subjekt (i lartë), subjekti, aktiviteti si dhe adresa.
Grupi i auditimit përzgjodhi 6 muaj të cilat u përkasin muajve të procedurave të inspektimit të përzgjedhur për auditim, për të vlerësuar rregullshmërinë e hartimit, miratimit dhe dërgimit të raporteve mujore, përkatësisht: Maj, Korrik dhe Tetor të viti 2023 dhe Prill, Shtator, Nëntor të vitit 2024. Nga auditimi i këtyre praktikave rezulton se, nga DINGN janë hartuar programet mujore mbi bazë subjektesh në përputhje me Vendimit nr. 696, datë 16.8.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "*e*-inspektimi".

Nga auditimi i 6 planeve mujore vetëm në një rast plani është dërguar pas datës 15 të muajit paraardhës, ky plan është protokolluar me nr.4194/3, datë 19.03.2024.

ISHTI ka hartuar raportet vjetore të inspektimeve dhe i ka dërguar në IQ/IP brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës, përkatësisht, me shkresën nr.1573/1, datë 19.02.2024 është dërguar analiza vjetore e punës për vitin 2024 dhe me shkresën nr.719/1, datë 10.02.2025 është dërguar analiza vjetore e punës për vitin 2024, në përputhje me VKM nr. 696, datë 16.8.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "*e*-inspektimi" kreu IX, pika 3 "Raporti vjetor i përgjithshëm i inspektimeve" ku shënohet se: *"Inspektoriatet shtetërore dërgojnë pranë Inspektoratit Qendror, brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës, raportet vjetore përkatëse të inspektimeve".*

Sa sipër, grupi i auditimit evidenton se nga DINGN nuk janë respektuar dispozitat ligjore për dërgimin e planit vjetor të inspektimeve në MIE. Më hollësisht ky konstatim është trajtuar në gjetjen në vijim të Projekt Raportit.

-Rregullshmëria e procedurave të inspektimit dhe administrimit të dokumentacionit në përputhje me aktet ligjore në fushën e inspektimit e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Procedurat e inspektimit dhe administrimit të dokumentacionit në drejtim të mbikëqyrjes së tregut përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre janë të përcaktuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i shfuqizuar me ligjin 99/2024 si dhe ligjeve të fushës specifike.
Procedurat e inspektimit dhe dokumentacioni i mbajtur, është në varësi të llojit të inspektimit të përcaktuar në nenin 24 të ligjit për inspektimin "Inspektimi i programuar" dhe në nenin 25 "Inspektimi jashtë programit".

Për vitin 2023, bazuar në programin me nr.9534, datë 10.11.2022, janë planifikuar për t'u kryer gjithsej 1151 inspektime dhe janë kryer 807 inspektime të programuara dhe 47 inspektime jashtë

programit, ndërsa për vitin 2024, bazuar në programin me nr.7869 prot., datë 16.10.2023, janë planifikuar të kryhen 1108 janë realizuar 922 inspektime nga të cilat 167 jashtë programit.

Për procedurën "Inspektim i programuar", grupi i auditimit ka shqyrtuar 6 raste Inspektimi, ku Vendimi i Inspektimit është pa masë administrative/gjobe, pasi nuk janë konstatuar shkelje.

1. Royal Trade sha, NIPT L61928503K
2. Skenderi G , shpk, NIPT K04004205V
3. Veliaj Petrol, shpk, NIPT K63124406K
4. Kastrati shpk, NIPT J6183529P
5. Ardi Petrol, NIPT K04005016G
6. Alba petrol, shpk, NIPT L48403101D

Nga auditimi i procedurave të inspektimit rezulton se është mbajtur dokumentacioni sipas parashikimeve ligjore dhe nëpërmjet sistemit elektronik e-Inspektime.

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim numrin e rasteve të subjekteve të cilat në përfundim të inspektimit për shmangie të treguesve cilësorë apo mangësi në dokumentacion tekniko-ligjor, janë sanksionuar me gjobë.

Të dhëna përmbledhëse për vendimet administrative (viti 2023-2024)

Përshkrimi	VITI 2023				Viti 2024			
	Numri i rasteve	% në nr. e rasteve	Vlera në lekë	% në vlerë	Numri i rasteve	%	Vlera në lekë	%
Totali i masave administrative	**17**	**100**	**29,230,000**	**100**	**19**	**100**	**31,850,000**	**100**
Vendime të shfuqizuara nga Komisioni i Ankimit	4	23,5	3,200,000	10,9	**5**	**26,3**	**9,000,000**	**28,3**
Vendime me ulje gjobe nga Komisioni i Ankimit	**6**	35,3	4,250,000	14,5	**0**	**0**	**0**	**0**
Vendime të mbetura në fuqi nga Komisioni i Ankimit	**7**	41,2	21,780,000	74,6	**14**	**73,4**	22,850,000	**71,7**

Nga tabela e mësiperme rezulton se:
Për vitin 2023, rreth **58,8 %** e vendimeve të ISHTI-t (10 nga 17) janë ndryshuar nga Komisioni i Ankimit (ose shfuqizuar, ose me ulje gjobe), çka tregon një përqindje të konsiderueshme të vendimeve të korrigjuara pas ankimimit. Vetëm **41,2 %** e vendimeve janë konfirmuar plotësisht në formën fillestare, ndërsa për vitin 2024, janë shfuqizuar 26,3 % e rasteve (5 nga 19 raste).
Për vitin 2023, rreth **58,8 %** e vendimeve të ISHTI-t (10 nga 17) janë ndryshuar nga Komisioni i Ankimit (ose shfuqizuar, ose me ulje gjobe), çka tregon një përqindje të konsiderueshme të vendimeve të korrigjuara pas ankimimit. Vetëm **41,2 %** e vendimeve janë konfirmuar plotësisht në formën fillestare.
Për vitin 2024, janë shfuqizuar 26,3 % të rasteve (5 nga 19 raste).

Për të vlerësuar respektimin e procedurave ligjore dhe administrative gjatë trajtimit të ankimeve, si dhe për të verifikuar bazën ligjore të vendimmarrjes nga Komisioni i Ankimit pranë ISHTI-t, nga grupi i auditimit u përzgjodhën për testim 8 raste ankimimi bazuar në: natyrën, shkallën dhe

rëndësin e shkeljes së konstatuar gjatë inspektimit. Ankimimet janë kryer nga subjekte ndaj të cilave, në përfundim të procesit të inspektimit, janë vendosur masa administrative me gjobë.
Nga 8 rastet e përzgjedhura për auditim janë: 4 raste kur gjoba është shfuqizuar nga Komisioni i Ankimimit dhe 4 raste kur gjoba është lënë në fuqi nga Komisioni i Ankimimit.

Rastet e audituara:

1. "Europetrol Durres", Vendim me gjobë i shfuqizuar (2023)
2. "Bujari Group",shpk Vendim me gjobë i shfuqizuar (2023)
3. "Dase Alba" shpk, Vendim me gjobë lënë në fuqi (2023)
4. "Delvina Gas Company" sha,Vendim me gjobë lënë në fuqi, por rishikuar masa e penalitetit (2023)
5. "Luna Group" shpk, Vendim me gjobë i shfuqizuar (2024)
6. "Gega group" sha, Vendim me gjobë i shfuqizuar (2024)
7. "Dori-Gas" shpk, Vendim me gjobë lënë në fuqi (2024)
8. "Al Marti », Lezhe shpk, vendim me gjobë lënë në fuqi (2024)

Nga auditimi i këtyre praktikave janë konstatuar mangësi të trajtuara në gjetjen në vijim të Raportit përfundimtar.

Komisioni i ankimit është ngritur me Urdhër të Ministrit të MIE nr.287, datë 09.10.2020 "Për krijimin e Komisionit të Ankimit" bazuar në VKM nr. 410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial". pika III/5, "Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të ISHTI-t"

Nga auditimi i rregullshmërisë së ngritjes dhe ndryshimit të Komisionit të Ankimit për periudhën objekt auditimi (2023-2024) rezulton, se:
- Grupit të auditimit i janë dorëzuar vetëm shkresat që ISHTI ka dërguar në MIE për ndryshim urdhër në lidhje me ndryshime të anëtarëve të Komisionit të Ankimit, por nuk i janë vënë në dispozicion Miratimi nga MIE i urdhërave të ndryshuar, si;

- Shkresa e ISHTI-t nr.574 prot., datë 27.01.2023 "Mbi një ndryshim në urdhrin 'Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ankimit në Inspektoriatin Shtetëror Teknik "
- Shkresa e ISHTI-t nr.5171 prot., datë 06.04.2024 "Mbi një ndryshim ne urdhërin nr.287, datë 09.10.2020 "Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Ankimit në Inspektoriatin Shtetëror Teknik".

- Në vendimin me nr.10800, datë 20.12.2023 "Vendim i Komisionit të Ankimit" për subjektin Bujari group shpk, në fund është firmosur nga anëtarët të cilët nuk janë miratuar me urdhër Ministri (bazuar në shkresat e mësipërme dhe dorëzuar grupit të auditimit).
- Për periudhën 28.09.2023, datë në të cilën është emëruar Kyreinspektori i ISHTI-t (Urdhër nr.152, datë 28.09.2023) deri më 06.04.2024 kur është dërguar shkresa për ndryshim urdhëri (Shkresa nr.5171 prot., datë 06.04.2024), grupit të auditmit nuk i është dorëzuar Miratimi nga Ministri i MIE i Komisionit të Ankimit pranë këtij Institucioni.
Më hollësisht të gjitha këto konstatime janë trajtuar në gjetjen në vijim të Raportit Përfundimtar.

- Rregullshmëria e procedurave të vlerësimit të standardeve për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr.6, datë 09.01.2015 "Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse", të akteve ligjore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj, të procedurave të marrjes së mostrës dhe të metodikave të testimit të standardeve përkatëse në fuqi, nga ISHTI kryhet marrja e mostrës për naftën bruto dhe nënproduktet e saj për:

- sasitë e prodhuara në vend,
- sasitë e importuara para zhdoganimit,
- sasitë në proces transportimi, depozitimi dhe tregtimi si kontroll periodik të detyrueshëm të subjekteve që kryejnë veprimtari në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar. Në Urdhër është përcaktuar edhe procedura për marrjen e mostrës dhe dokumentacioni i nevojshëm.

Për të audituar rregullshmërinë e procedurave të vlerësimit të standardeve për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj, grupi i auditimit përzgjodhi për testim 8 procedura, ku në përfundim nuk u konstatuan mangësi.

-Rregullshmëria e ndjekjes dhe likuidimit nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Të ardhurat kryesore të ISHTI-t realizohen nga DINGN, nëpërmjet shërbimeve të cilat përfshijnë marrje mostre si detyrim ligjor për kontrollet cilësore të respektimit e standardeve teknike të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe gjobave për mosrespektim të cilësisë së naftës dhe nënprodukteve apo moszbatimin e kushteve të parashikuara në lejet/licencat përkatëse që u janë dhënë personave juridik, në instalimet, impianet dhe pajisjet e përdorura në mënyrë që ato të zbatojnë normat teknike dhe masat për mbrotjen kundra zjarrit.

Në tabelën e mëposhtme po paraqesim të ardhurat e realizuara dhe likujdimet për periudhën ushtrimore, nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre

Viti 2023/në lekë

Zërat	Detyrim	Likujdim	Shfuqizime K/Ankimit	Debi
Gjoba	29,230,000	580,000	7,450,000	21,200,000
Sherbime	181,698,000	179,022,000	0	2,676,000
Totali	**210,928,000**	**179,602,000**	**7,450,000**	**23,876,000**

Viti 2024/në lekë

Zërat	Detyrim	Likujdim	Shfuqizime K/Ankimit	Shfuqizime nga vendimet gjyqësore	Debi
Gjoba	31,850,000	2,450,000	9,000,000	8,000,000	12,400,000
Sherbime	189,469,000	181,842,000	0	0	7,627,000
Totali	**221,319,000**	**184,292,000**	**9,000,000**	**8,000,000**	**20,027,000**

Sic konstatohet nga tabelat e mësipërme, cdo vit ka subjekte të cilat nuk i shlyejnë detyrimet si, nga shërbimet të cilat ofrohen nga ISHTI (në këtë rast nga DINGN) si një detyrim ligjor për kontrollin cilësor të naftës dhe nënprodukteve të saj ashtu edhe nga gjobat e vendosura.

Në lidhje me arkëtimin nga shërbimet, megjithëse ka patur raste që është dërguar në proces gjyqësor (si në rastin e subjektit "Defrimi oil" shpk), nga gjykata nuk është marrë parasysh kërkesa e ISHTI dhe ka vendosur "Refuzimin e kërkesës së kërkuesit ISHTI për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, "faturë tatimore elektronike të shitjes, me nr.faturë...".
Për arkëtimin e detyrimeve nga ana e DINGN është ndjekur praktika që në inspektimet e planifikuara të vendoset edhe si objekt në Autorizime, njoftimi i subjekteve për shlyerjen e detyrimeve, kryesisht të detyrimeve për shërbimet e ofruara (analize mostre).

Megjithëse çdo vit ka subjekte që nuk kryejnë shlyerjen e detyrimeve për shërbimin e marrjes së mostrave, ekzistojnë dy arsye kryesore që nuk varen nga veprimtaria e ISHTI-t.
Së pari, marrja periodike e mostrave për subjektet që janë sh.a. dhe SPK përbën një detyrim ligjor që duhet të ushtrohet nga ISHTI, me qëllim garantimin e cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj.
Së dyti, në aktet ligjore në fuqi nuk parashikohen masa shtrënguese për subjektet që nuk kryejnë pagesën për këtë shërbim.

Në lidhje me arkëtimet nga gjobat e vendosura ndaj subjekteve, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ka ndjekur praktikën e ndjekjes së procedurës gjyqësore për realizimin e të ardhurave përkatëse. Pas përfundimit të procedurave gjyqësore, janë lidhur kontrata me subjektet përmbaruese, me qëllim ekzekutimin e vendimeve për arkëtimin e gjobave.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet gjendja debitore e krijuar ndër vite për Drejtorinë e Inspektimit të Naftës dhe Gazit Natyror (DINGN).

Viti 2023/në lekë

Përshkrimi	Gjendja debitore në fund 2022	Detyrime /Faturime	Pagesa	Shfuqizime K/Ankimit	Shfuqizime nga vendimet gjyqësore	Gjendja debitore në fund 2023
Gjoba	1,117,649,051	29,230,000	4,321,678	7,450,000	0	1,135,107,373
Shërbime	101,627,570	181,698,000	185,701,000	0	0	97,624,570
Totali	**1,219,276,621**	**220,928,000**	**190,022,678**	**7,450,000**	**0**	**1,232,731,943**

Viti 2024/në lekë

Përshkrimi	Gjendja debitore në fund 2023	Detyrime /Faturime	Pagesa	Shfuqizime K/Ankimit	Shfuqizime nga vendimet gjyqësore	Gjendja debitore në fund 2024
Gjoba	1,135,107,373	31,850,000	6,656,667	9,000,000	8,000,000	1,143,300,705
Shërbime	97,624,570	189,469,000	182,938,000			104,155,570
Totali	**1,232,731,943**	**221,319,000**	**189,594,667**	**9,000,000**	**8,000,000**	**1,247,456,275**

Për sa më sipër, konstatohet se gjendja debitore e DINGN është rritur në mënyrë të vazhdueshme nga viti në vit, ku pjesën më të madhe të vlerës e përbëjnë subjektet që nuk kryejnë pagesat për shërbimet e ofruara.

Në përfundim të vitit 2023, vetëm për DINGN, vlera e detyrimeve të subjekteve që nuk kanë likuiduar tarifat për shërbimin e marrjes së mostrave apo penalitetet/gjobat, rezulton në shumën **1,232,731,943 lekë**. Ndërsa në fund të vitit 2024 kjo vlerë është rritur në **1,247,456,275 lekë**.

Këto detyrime janë akumuluar duke filluar nga viti **2006**.

Nga analiza e strukturës së detyrimeve të pambledhura, konstatohet se **në vitin 2023**, gjobat përbëjnë **80%** të vlerës totale të detyrimeve të palikuiduara nga subjektet, ndërsa **në vitin 2024** kjo përqindje është rritur në **83%**, duke treguar një tendencë në rritje të detyrimeve që lidhen me penalitetet.

Titulli i Gjetjes: *Mospërputhje në dokumentimin dhe dërgimin e planit vjetor të inspektimeve për vitin 2024 pranë Ministrisë Përgjegjëse (MIE).*

Nr. i gjetjes: 10	
Subjekti i Audituar	DINGN
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	ISHTI MIE
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjit 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" VKM nr. 410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial", Rregulloret e miratuara në vitin 2020 dhe 2024.
Përshkrimi i gjetjes:	**Situata:** Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për planifikimin dhe miratimin e programeve vjetore të inspektimit pranë ISHTI, u konstatua se: • Për vitin 2023, programi vjetor është dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 9553 prot., datë 14.11.2022. • Për vitin 2024, nuk u paraqit nga ana e institucionit ndonjë shkresë që vërteton se programi vjetor i inspektimeve është dërguar për miratim tek ministri përgjegjës, në përputhje me kërkesat ligjore. **Kriteri:** Nenin 24, pika 2 dhe 3 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili kërkon që: *"Programimi i inspektimit hartohet nga vetë inspektorati (...) dhe miratohet nga ministri përgjegjës pas marrjes së mendimit këshillimor nga Inspektorati Qendror."* Si dhe Ligji nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"

	• Neni 32 – Programi i inspektimeve Pika 1: "Programi i inspektimeve hartohet nga organi inspektues në përputhje me rregullat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave..." Pika 4: "Programi i inspektimeve të organit inspektues miratohet nga ministri përgjegjës." **Ndikimi/efekti:** Krijon mungesë transparence dhe llogaridhënieje, duke e bërë të vështirë gjurmimin e planifikimit dhe kontrollin e veprimtarisë inspektuese nga autoritetet mbikëqyrëse. Rrit mundësinë e inspektimeve të paautorizuara ose jashtë programit, që mund të cënojnë sigurinë juridike të subjekteve të kontrolluara. **Shkaku:** Mosfunksionim të elementëve të kontrollit të brendshëm.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm.
Konkluzioni:	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për planifikimin dhe miratimin e programeve vjetore të inspektimit pranë ISHTI, u konstatua se, për vitin 2024, grupit të auditimit nuk ju paraqit shkresë që vërteton se programi vjetor i inspektimeve është dërguar për miratim në MIE, në përputhje me kërkesat ligjore.
Rekomandimi:	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) duhet të dërgojë programin e inspektimit për miratim pranë MIE në përputhje me kërkesat ligjore të nenit 32, pika 4, për të siguruar vlefshmërinë ligjore të veprimtarisë inspektuese si dhe të ruajë dokumentacionin zyrtar të dërgimit dhe miratimit për efekt gjurmueshmërie dhe transparence në rast auditimi apo shqyrtimi institucional.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	*Menjëherë dhe në vijimësi.*
Statusi i rekomandimit	*I pranuar nga Subjekti*

Titulli i Gjetjes: *Pasaktësi në referimet ligjore në aktet e inspektimit që ndikojnë në procesin e ankimit"*

Nr. i gjetjes: 11	
Subjekti i Audituar	DINGN/Komisioni i Ankimit
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	ISHTI MIE
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjit 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Ligji nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". VKM nr. 410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial", Urdhëri nr. 25, datë 10.8.2018 "Për miratimin e rregullores

	'Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ". Rregulloret e miratuara në vitin 2020 dhe 2024.
Përshkrimi i gjetjes:	**Situata:** Në përmbushje të planit vjetor të inspektimeve, ISHTI ka zhvilluar inspektime në subjekte që ushtrojnë veprimtari në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, duke konstatuar raste të mospërputhjes me kërkesat ligjore dhe teknike. Si rezultat, gjatë vitit 2023 janë vendosur gjithsej 17 masa administrative me gjobë ndaj subjekteve të kontrolluara për shkelje të ndryshme të legjislacionit teknik dhe të cilësisë, ku 10 vendime (ose 58.8% e totalit) janë ndryshuar nga Komisioni i Ankimit, përkatësisht: • 4 vendime (23.5%) janë shfuqizuar plotësisht, dhe • 6 vendime (35.3%) janë korrigjuar me ulje të gjobës. Ndërsa, për vitin 2024 janë vendosur gjithsej 19 masa administrative me gjobë, ku 5 vendime janë shfuqizuar plotësisht. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe analizimi i procedurave të ndjekura nga Komisioni i Ankimit pranë ISHTI-së, u konstatua se në pjesën më të madhe të rasteve janë respektuar procedurat ligjore dhe administrative të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi. Vendimet janë shoqëruar me argumentim ligjor dhe faktik që mbështet arsyetimin e Komisionit dhe përputhet me dokumentacionin e paraqitur nga palët. Nga auditimit u vunë re edhe disa mangësi, të cilat lidhen kryesisht me: Përqindje relativisht e lartë e ndërhyrjeve nga Komisioni i Ankimit (në vecanti në vitin 2023) tregon se, në një pjesë të vendimeve, nuk janë respektuar plotësisht kërkesat procedurale dhe standardet ligjore të procesit të inspektimit dhe arsyetimit administrativ, si: Mungesë dokumentacioni mbështetës të mjaftueshëm për disa konstatime të bëra në aktet e inspektimit, si foto. • *(Rasti "Bujari Group")* Formulim i paqartë ose i paplotë i arsyetimit ligjor në vendimet e trupës inspektuese • *(Rasti "Delvina Gas Company" sh.a.)* Shqyrtim jo i plotë i dokumentacionit të subjektit përpara marrjes së vendimit administrativ • *(Rasti "Eropetrol" Durrës sh.a.)* Formulim i përgjithshëm dhe jo i matshëm i shkeljes në listën e verifikimit

	• *(Rasti "Dori Gas" sh.p.k.) — në listën e verifikimit datë 27.03.2024, është shënuar se subjekti "nuk plotëson distancat e sigurisë", pa përcaktuar apo matur distancat aktuale midis rezervuarit, distributorit dhe banesës.* **Kriteri: Neni 4 Neni 6** neni 41 të Ligjit 10433, datë 16.6.2011 "Per inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Pika III/5 VKM nr. 410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial". **Ndikimi/efekti:** Vendimmarrja administrative e paarsyetuar dhe e pambështetur mund të çojë në mungesë transparence, deformim të procesit të ankimimit, si dhe në cenim të autoritetit të trupës inspektuese. **Shkaku:** Njohuri të pjesshme e të inspektorëve për interpretimin e dispozitave ligjore specifike dhe mungesë kontrolli paraprak nga strukturat e mbikëqyrjes mbi saktësinë ligjore të akteve para dërgimit në Komisionin e Ankimit.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë.
Konkluzioni:	Nga Komisioni i Ankimit, në vitin 2023 janë shfuqizuar 23.5% e vendimeve të inspektorëve dhe janë ndryshuar masat për 35% të vendimeve. Ndërsa, për vitin 2024 janë shfuqizuar 26 % e vendimeve të grupit të inspektorëve. Bazuar në vendimarrjen e komisionit rezulton se në një pjesë të vendimeve fillestare të inspektorëve nuk janë respektuar plotësisht kërkesat procedurale dhe standardet ligjore të procesit të inspektimit dhe të arsyetimit administrativ. Për të përmirësuar këtë situatë nuk është marrë asnjë masë nga ana e ISHTI-t.
Rekomandimi:	Nga Kryeinspektori të merren masa për përmirësimin e punës në drejtim të forcimit të kontrollit të brendshëm në kryerjen e inspektimeve, vencanërisht në cilësinë e dokumentimit të ketij procesi, bazuar ne analizën e faktorëve ndikues dhe riskut përkatës, me qëllim përmbushjen e objektivave në drejtim të rritjes së cilësisë së inspektimeve dhe eleminimin e te metave të veprimtarisë së trupave inspektuese të dokumentuara gjatë shqyrtimit të ankimimeve.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Brenda muajit Janar 2026.
Statusi i rekomandimit	I pranuar nga Subjekti

Titulli i Gjetjes: *Kryerje disa inspektimeve jashtë programit në të njëjtin subjekt, të pa argumentuar për domosdoshmërinë e tyre, brenda një periudhe shumë të shkurtër, me trupë inspektuese me përbërje më shumë se gjysma e tyre të njëjtët persona, me përfundim inspektimi*

me të njëjtën shkelje por me masa administrative të ndryshme, duke ekspozuar institucionin ndaj risqeve të integritetit dhe atyre etike – profesionale. Kjo dhe për faktin se Inspektimi i mëvonshën nga i pari është kryer brenda afatit të lënë nga inspektimi i parë për rregullimin e situatës.

Nr. i gjetjes: 12	
Subjekti i Audituar	DINGN
Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja	ISHTI MIE
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjit 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". VKM nr. 410, datë 13.5.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial", Rregulloret e miratuara në vitin 2010 dhe 2020.
Përshkrimi i gjetjes:	**Situata:** Nga ISHTI me shkresën nr. 9384, datë 13.11.2023 janë dërguar subjektit "Bujar Group"shpk përnfudimet për inspektimin e kryer i rregjistruar në sistemin me nr. të sistemit ISHTI-DQ-2023-005720. Shkresa ka dalë nga Drejtoria e Inspektimit të Pasisjeve nën Presion. Sipas kësaj shkrese, theksohet se inspektimi është kryer me datë 26.10.2023, por pa shënuar autorizimin përkatës. Dokumentacioni që referon shkresa e mësipëme, mbajnë datën 13.11.2023 (shih doc. ISHTI-DQ-2023-005720-1,2,4,5). Sipas këtyre dokumentave të raportuara në sistem më datë 13.11.2023, trupa e inspektimit ka qenë e përbërë nga: Hader Mulla Armando Melaj Eduard Vocaj Fatjon Cenoimeri Indrit Ceni Sipas dokumentave te inspektimit, konkretisht doc. ISHTI-DQ-2023-005720-4, datë 13.11.2023 nga inspektimi janë konstatuar shkelje dhe janë marrë masa si më poshtë: **Urdhëruar:** *"Ndalim i menjëhershme dhe heqja nga puna e paisjes nën presion..."* . **Masa ligjore** "Nërprerja e kryerjes së veprimit ..... në bashkëpunim me inspektorët e DINGN u vendos që subjektit ti bllokohen pistoletat i shitjes se GLN, të heqë rezervuarin aktual dhe pasi të vendosë rezervuarë që plotëson normat dhe kushtet teknike të ricertifikojë subjektin pasi vërtetimi teknik aktual bie poshtë, pai është certifikuar rezervuar i GLN në kundërshtim me normat dhe kushtet e sigurisë teknike". **Kohëzgjatja e afatit të masës urgjente**: 13.11.2023 (data e fillimit) -20.11.2023 (data e përfundimit)

	Me vendimin përfundimtar të inspektimit është vendosur gjobitja e subjektit me 50,000 lekë, dhe korigjimin e shkeljeve deri më datë 20/11/2023. Më hollësisht shih doc. ISHTI-DQ-2023-005720-5 I gjithë kjo procedurë është konfirmuar nga Kryeinspektori dhe i është dërguar subjektit me shkresën e mësipërme me nr. 9384, datë 13.11.2023. **2.** Po më datë 13.11.2023 është nxjerrë autorizimi jashtë programi me Nr. 9344 Prot, datë 13.11.2023 për të kryer inspektim në të njëjtin subjekt si më sipër "Bujari Group"sh.p.k me NIPT: L71907003O .... Në autorizim si objekt inspektimi ka qenë respetimi i kërkesave .të ligjeve të enëve nën presion...". Autorizimi ka dalë nga Drejtoria e Inspektimit të Pasisjeve nën Presion. Trupa inspektuese është me këtë përbërje:H.M; A.M; E.V; F.C; I.C. Kjo trupë është e njëjtë si në inspektimin e kryer më parë dhe përfunduar më datë 13.11.2023 por me renditje të ndryshme përvec të parit. Për këtë grupi të auditimit nuk ju vu në dispozicion asnjë praktikë se cfarë ka bërë kjo trupë inspektuese. 3. Një ditë më vonë, po për këtë subjekt, më datë 14.11.2023 del autorizimi inspektimi jashtë programit për inspektim me nr. 9384/1, datë 14.11.2024. Ky autorizim ka dalë nga Drejtoria e Inspektimit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre. Trupa inspektuese është me përbërje prej 3 inspektorësh të cilët kanë qenë në përbërje të dy trupave të tjera si më sipër. Këto janë, F.C A.M; E.V. **Në procesverbalin ISHTI-DQ-2023-005739-2,të kësaj trupe inspektuese ka këto gjetje e masa:** **4. Detyra të parealizuara nga Inspektimi i mëparshëm:** "Nuk ka" . **7.Gjetjet e konstatuara** "Ka shkelje të kërkesave ligjore, '*Po*" *Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuaranë nenin e ligjit* *Neni 15, ligjit 8450, i ndryshuar Pika 2.Komente Në vijim të inspektimit të mbajtur më datë 13.11.2023, sipas Autorizim Ispektimi nr.9344, prot... Në bazë të cheklistës së DIPNP ju vendos akt konstatimi për shkelje të konstatuara nga kjo*

	drejtori dhe ***<u>nga Inspektorët e DINGN u morrën masa urgjente të bllokimit të pistoletave, heqjes së rezervuarit dhe revokim i vërtetimit teknik i</u>*** *cili është dhënë në kundërshtim me distancat e sigurisë për rezervuarin e GLN"* **dhe në vendimin përfundimtar ISHTI-DQ-2023-005739-5** është shënuar: Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezualtuan këto shkelje të kërkesave ligjore: "Nuk ka" Me vendimin përfundimtar të inspektimit është vendosur gjobitja e subjektit me 700,000 lekë, afatat për korigjimin e shkeljes nuk ka. Më hollësisht shih doc. ISHTI-DQ-2023-005739-2,dhe dhe 5, datë 14.11.2023 I gjithë kjo procedurë është konfirmuar nga Kryeinspektori dhe i është dërguar subjektit me shkresën e mësipërme më nr. 9416, datë 15.11.2023. Në proces verbalin e kësaj trupe inspektuese, e cila ka qenë pjesë e trupës së inspektimit sipas dokumenteve ISHTI-DQ-2023-005720-1,2,4,5, është kontatuar e njëjta shkelje si më parë, por ka vënë një gjobë prej 700,000 lekë, dhe nuk ka lenë afat për rregullimin e shkeljes së konstatuar për arsye se subjekti duhet ti ketë bërë detyrat pasi këtë e konfirmon kjo trupë inspektuese në pikën 4 , faqe 2. të PV (shih PV me nr. ISHTI-DQ-2023-005739-2, datë 14.11.2023) Subjekti "Bujari Group" shpk ka ushtruar ankim ndaj vendimit administrativ, duke pretenduar se në momentin e inspektimit aparati i gazit ishte bllokuar dhe rezervuari ishte hequr një ditë më parë. Komisioni i Ankimimit, me vendimin nr. 10800, datë 20.12.2023, ka vendosur pranimin e ankimimit dhe shfuqizimin e masës administrative, se trupa inspektuese kishte gabuar në cilësimin e kundërvajtjes administrative. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe procedurës së ndjekur, u konstatuan një sërë problematikash në vendimmarrjen e Komisionit të Ankimimit, si mungesë e vlerësimit të plotë të gjendjes faktike në momentin e inspektimit, mungesë transparence në dëgjimin e palëve. Vendimi i Komisionit nuk adreson qartësisht nëse shkelja ekzistonte në momentin e konstatimit nga grupi i inspektimit dhe nuk dokumenton me prova të verifikueshme deklarimet e subjektit. Në këto kushte, praktika e ndjekur nga Komisioni përbën një mangësi në trajtimin e drejtë dhe objektiv të ankesës. Sa sipër Grupi i auditimit vlerëson se:

	1. Autorizohet kryerja e Inspektimeve jashtë programit për të njëtje cështje dhe me të njëjtë trupë inspektuese, që ka kryer inspektimin e parë, pa dhënë shkaqet e kryerje së një inspektimit dhe pa kryer vlerësimin e inspektimit të parë. 2. Autorizohet kryerja e inspektimeve jashtë programit brenda një afati shumë të shkurtër kur kanë shkuar përfundimet e inspektimit të mëparshëm, dhe më shqetëesuesja pa përfunduar afatet e pranuara për rregullimin e shkeljeve nga inspektimi i parë. 3. Nga komisioni i ankimimit vlerësohet falja e gjobës si shkak gabimin e inspektorëve por pa analizuar e marrë masat përkatësi për parregullsitë e rregullimin e gabimeve. **Kriteri:** Neni 5, 14, 47 80 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", Neni 4, 5, 6 dhe 51 të Ligjit nr. 10433/2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", **Ndikimi/efekti:** Rrezik për precedente të gabuar në praktikat administrative, që mund të përdoren nga subjekte të tjera për të shmangur masat ndëshkimore. si dhe në cenim të autoritetit të trupës inspektuese. **Shkaku:** Mungesa e udhëzimeve të brendshme që përcaktojnë mënyrën e verifikimit të dokumentacionit dhe të fakteve përpara marrjes së vendimit të ankimit. Mosfunksionim të elementëve të kontrollit të brendshëm.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë.
Konkluzioni:	Kontrolli i brendshëm vlerësohet si jo efektiv në sistemin e inspektimeve, për faktin se nga ISHTI në një rast, janë kryer disa inspektime jashtë programit në të njëjtin subjekt, të pa argumentuar për domosdoshmërinë e tyre, brenda një periudhe shumë të shkurtër, me trupë inspektuese me përbërje më shumë se gjysma e tyre të njëjtët persona, me përfundim inspektimi me të njëjtën shkelje por me masa administrative të ndryshme, duke ekspozuar institucionin ndaj risqeve të integritetit dhe atyre etike – profesionele. Kjo dhe për faktin se Inspektimi i mëvonshën nga i pari është kryer brenda afatit të lënë nga inspektimi i parë për rregullimin e shkeljeve.
Rekomandimi:	Të ndërpritet dhënia e autorizime për inspektimeve të njëpasnjështe në të njëjtin subjekt ndërkohë kur nuk ka përfunduar afati i zbatimit të detyra të lëna, apo pa vlerësuar cështjet e patrajtuara nga inspektimi i mëparshëm.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	*Menjëherë dhe në vijimësi.*
Statusi i rekomandimit	*I pranuar nga Subjekti*

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Në drejtim të rregullshmërisë së procedurave të inspektimit dhe kontrollit në fushën e përpunimit, transportit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, rezulton se: është ngritur dhe funksionon sistemi i kontrolli dhe inspektimit të subjektëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" si dhe ligjeve në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe gazit si dhe nënprodukteve të tyre, por janë konstatuar mangësi në drejtim të shqyrtimit të gjobave, mungesën e dokumentacionit të mjaftueshëm mbështetës për disa konstatime të evidentuara në aktet e inspektimi, etj. Sistemi vlerësohet me **risk të lartë.**
Përsa sipër vlerësojmë se, organizimi dhe *funksionimi i kontrollit të brendshëm* për këtë sistem ka qenë *jo efektiv.*

8. <u>Sistemi i funksionimit te menaxhimit financiar dhe kontrollit brendshëm</u>.

Objektivi i auditimit:
Vlerësimi nëse menaxhimi financiar dhe kontrolli është ngritur në të gjithë komponentët bazë dhe ka funksionuar rregullisht.

- Evidentimi i risqeve te aktivitetit si dhe monitorimi e trajtimi i tyre, nga njëra periudhë në tjetrën.
Në kuadër të auditimit të komponentit "Menaxhimi i Riskut dhe Raportimit", është konstatuar se ISHTI ka ndërmarrë disa veprime për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të miratuar me urdhërin nr. 4, datë 26.01.2024 dhe në ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ndryshuar.
Nga ana e ISHTI janë vendosur objektivat afatmesme ne dokumentin e PBA dhe objektivat operacionale në planet vjetore të institucionit të cilat janë hartuar nga çdo drejtori gjatë muajit Janar të çdo viti.
Njësia ka krijuar Grupin e Menaxhimit të Riskut (GMR), me urdhër nr. 5827/1, datë 19.04.2024 për vitin 2024. Ky grup është përgjegjës për koordinimin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve në nivel institucional.
Në zbatim të këtij procesi, janë identifikuar risqet që mund të ndikojnë në përmbushjen e objektivave strategjike dhe operacionale të njësisë. Për këtë qëllim, është përgatitur dhe miratuar Regjistri i Risqeve, me shkresën nr.142/3, datë 06.02.2023 për vitin 2023 dhe shkresën nr.1326/1, datë 09.02.2024, ku janë përcaktuar risku para kontrollit, kontrollet ekzistuese, risku pas kontrolleve ekzistuese, nevoja për kontrolle shtesë, veprime për të adresuar mangësitë, mbajtësi i riskut, ndryshimet në risk nga detyra e fundit..
Për risqet me prioritet të lartë, njësia ka hartuar Planin e masave për minimizimin e riskut (me shkresën nr.142/3, datë 06.02.2023 për vitin 2023 dhe shkresën nr.1326/1, datë 09.02.2024), në të cilin janë përcaktuar masat për trajtim, afatet kohore dhe përgjegjësit për zbatim. Procesi i vlerësimit është kryer duke përdorur matricën e riskut, sipas shkallës së miratuar nga manuali institucional (1–3 ose 1–5), për të përcaktuar nivelin e përgjithshëm të riskut dhe masat për minimizimin e tij.

- Rregullshmëria e raportimit të strukturave përkatëse mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga njësia përkatëse, rezulton se raportimi periodik mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit është kryer pjesërisht, duke mos respektuar plotësisht kërkesat ligjore dhe udhëzimet metodologjike përkatëse.
Në drejtim të raportimit, referuar kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si dhe pikës 3.5.1 "Raportimi mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit" të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024 të Ministrit të Financave, njësitë publike kanë detyrimin të përgatisin dhe të paraqesin Deklaratën e cilësisë të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe raportet vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e këtyre sistemeve.
Këto dokumente përbëjnë elementë thelbësorë për garantimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale në raport me zbatimin e parimeve të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe vlerësimin e funksionalitetit të kontrollit të brendshëm.
Megjithatë, për periudhën objekt auditimi, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion Deklarata e cilësisë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporti vjetor mbi funksionimin e këtij sistemi, veprim ky që përbën mospërputhje me kërkesat e nenit 18, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Ky nen përcakton qartë se nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të depozitojë deri në fund të muajit shkurt të vitit pasardhës deklaratën dhe raportin për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke u mbështetur në vetëvlerësimet e njësisë dhe në informacionin e siguruar nga strukturat vartëse.
Ndërkohë, është konstatuar se ISHTI ka dorëzuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë pyetësorët e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, me shkresën nr. 1211 prot., datë 24.01.2024, për vitin 2023, dhe shkresën nr. 11/1, datë 28.01.2025, për vitin 2024.
Kjo tregon se procesi i vetëvlerësimit është kryer në mënyrë të rregullt, por pa u shoqëruar me dokumentet përmbyllëse të detyrueshme ligjore, siç janë Deklarata e cilësisë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Titulli gjetjes: *Parregullsi e raportimit të strukturave përkatëse mbi sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit*

Nr. i gjetjes: 13	
Subjekti i audituar	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"
Përshkrimi i gjetjes	**Situata:** Për periudhën objekt auditimi, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion Deklarata e cilësisë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporti vjetor mbi funksionimin e këtij sistemi, duke përbërë mospërputhje me kërkesat e nenit 18, pika 1 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010. Ky nen përcakton qartë se nëpunësi autorizues i njësisë publike ka detyrimin të depozitojë deri në fund të muajit shkurt të vitit pasardhës deklaratën dhe raportin për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të

	kontrollit të brendshëm, të mbështetur në procesin e vetëvlerësimit dhe raportimit nga njësitë vartëse. **Kriteri:** Neni 18, pika 1, e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". **Ndikimi/Efekti:** Risk për mosvlerësim të saktë të funksionimit të sistemit të MFK-së, si dhe për dobësim të transparencës, përgjegjshmërisë dhe monitorimit institucional. **Shkaku:** Moszbatim i disa kërkesave ligjore për inventarizimin fizik të aktiveve të njësisë.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm
Konkluzioni	Njësia nuk ka siguruar raportim të plotë mbi funksionimin e sistemit të MFK-së, pasi mungojnë deklarata e cilësisë dhe raporti vjetor, duke treguar për mangësi në përmbushjen e kërkesave ligjore dhe transparencës institucionale.
Rekomandime	Të merren masa nga nëpunësi autorizues dhe struktura përgjegjëse për MFK-në për përgatitjen dhe dorëzimin brenda afateve ligjore të deklaratës së cilësisë dhe raportit vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në përputhje me nenin 18 të Ligjit nr. 10296/2010 dhe Manualin e MFK-së.
Afati për zbatimin e rekomandimit	*Brenda muajit Shkurt 2026.*
Statusi i rekomandimit	*Observuar/ I papranuar nga Grupi i Audtimit*

Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:
Entiteti ka ndërtuar pjesërisht sistemin e raportimit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin nr. 4, datë 26.01.2024.
Sistemi ka funksionuar në mënyrë të pjesshme, pasi janë kryer vetëvlerësimet për komponentët e MFK-së, por nuk janë përgatitur dhe dorëzuar deklarata e cilësisë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
Auditimi vlerëson se kontrolli i brendshëm në procesin e raportimit të MFK-së nuk ka funksionuar në nivelin e kërkuar, duke kufizuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe vlerësimin objektiv të sistemit.
Rreziku në këtë sistem vlerësohet në nivel **të mesëm.**

V.Rekomandimet e auditimit

Në përfundim të punës në teren, grupi i auditimit përgatiti Projekt Raport Auditimit në të cilën janë përfshirë gjetje dhe rekomandimet.

Zbatimi me rigorizitet i këtyre rekomandimeve do të bëjë të mundur vendosjen e kontrolleve të duhura si dhe do t'i japë siguri menaxhimit se këto kontrolle po funksionojnë për përmbushjen e objektivave me kosto efektive dhe në mënyrë efiçente.

VI.Komentet e subjektit te audituar.

Subjekti i audituar, ka dërguar komente mbi Projekt Raportin e Auditimit me shkresën nr.11796/1 prot., datë 11.12.2025, protolkolluar në MIE me nr.5699/4, datë 15.12.2025. Shqyrtimi i observacioneve është kryer nga grupi i auditimit sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.

VII. Falenderime.

Grupi i punës falenderon stafin e ISHTI-t, për gadishmërinë që treguan për vënien në dispozicion të dokumentacionit dhe bashkëpunimit gjatë gjithë kohës së kryerjes së angazhimit të auditimit.

GRUPI I AUDITIMIT

Merita GJOKA

Ardiana ALIMERI

Shkurte HALILI

Kristina DELIU